


949.65

C 12

EQREM ÇABEJ

**NË BOTËN
E ARBËRESHËVE
TË ITALISË**



94P.65

12.

EQREM ÇABEJ

NË BOTËN
E ARBËRESHËVE
TË ITALISË

(Përmbledhje studimesh)



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

PARATHËNIE

1. Gjuhëtari ynë i shquar prof. Eqrem Çabej, gjatë veprimtarisë së tij aq të frytshme kërkimore shfaqti interes të përhershëm për problematikën arbëreshe, në radhë të parë për materialin gjuhësor e për folklorin arbëresh, por edhe për letërsinë e kulturën arbëreshe, për historinë e shpërnguljeve arbëreshe në Itali dhe të ngulimeve të krijuara prej tyre atje. **Ky horizont i gjerë vështrimi është i lidhur me mendimin e theksuar më se një herë nga Eqrem Çabej se shfaqjet e jetës mendore nuk duhen parë të veçuara, por në bashkëlidhjet e tyre, më një studim shumëdisiplinor, duke u ndriçuar të dhënat e një fushe nga ato të fushave të afërta, duke mos u shikëputur asnjëherë të dhënat gjuhësore nga kushtet shoqërore, nga kuadri historik në të cilin dalin.**

Ky interesim i shumanshëm nisi që në periudhën e studimeve universitare të tij dhe vijoi gjer në vitet e fundit të jetës: më 1933 mbrohej në Universitetin e Vjenës prej humtuesit të ri si disertacion për gradën e doktorit të shkencave monografia «Studime arbëreshe» (në origjinal: «Italo-albanische Studien»); më 1976 botohej në revistën arbëreshe «Zjarri» 1-2, punimi «Arbëreshët dhe e folmja e tyre», më 1977 në revistën «Ylli» artikulli «Tek arbëreshët e Italisë».

Prof. Eqrem Çabej ia kushtoi veprimtarinë e tij studimore themelore historisë së gjuhës shqipe, aspekteve dhe problemeve të ndryshme të saj. Për historinë e një gjuhe si gjuha jonë, të dokumentuar me shkrim relativisht vonë, që nga shekulli XV, të dhënat dialektore marrin një vlerë të veçantë. Rëndësi të madhe kanë këtu të folmet e diasporës, në radhë të parë të arbëreshëve të Greqisë, të ikur nga Shqipëria në shekujt XIII-XIV, dhe të folmet e arbëreshëve të Italisë, që kaluan në bregun tjetër të Adriatikut pas pushtimit

osman, në valë të ndryshme, që nga mesi i shekullit XV e gjer në mesin e shekullit XVIII, të folme që, për pasojë, ruajnë materiale me interes të shqipes mesjetare e të dhëna të vlefshme për përcaktimin kronologjik të mjaft dukurive e të shndërrimeve gjuhësore. Rëndësia e materialit gjuhësor arbëresh e shtyu historianin e shquar të gjuhësisë sonë të meritet me studimin e shumanshëm të problematikës arbëreshe, ta njohë mirë e gjerë atë, duke u bërë një nga njohësit më kompetentë, më të thelluar e më seriozë të saj.

Prof. Eqrem Çabej i përdori gjerësisht njohuritë e tij për problemet letrare, folkloristike-etnografike, kulturore arbëreshe dhe të dhënat gjuhësore arbëreshe në vepra të ndryshme, të përgjithshme a të veçanta, në radhë të parë në studimet etimologjike, por edhe në studimin e disa temave të folklorit tonë, në hartimin e ndonjë teksti mësimor e në ndonjë studim të përgjithshëm të problemeve të zhvillimit të kulturës e të letërsisë shqiptare.

Në tekstin për shkollat e mesme «Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe» (1936) ai u linte një vend të mirë autorëve arbëreshë dhe folklorit arbëresh. Përfshihen aty skica biografiko-letrare dhe pjesë të zgjedhura, me komente e me shënime filologjike-gjuhësore, të një numri të mirë autorësh arbëreshë, ndër të cilët Lekë Matranga, Jul Variboba, Jeronim de Rada, Gavril Dara, Zef Serembe. Po ashtu edhe 5 këngë popullore, të mbledhura nga vetë autori ose të nxjerra nga përmbledhje të ndryshme të botuara më parë. Me këtë jo vetëm iu bënë të njohur publikut tonë e u popullarizuan autorë e vepra të letërsisë arbëreshe, por edhe u vunë në dukje vlera letrare artistike të krijimeve më të shquara të saj, në atë mënyrë si nuk ishte bërë ndonjëherë në tekstet analoge të mëparshme. Meritojnë të ripërmenden këtu disa gjykime e vlerësime të tij. Për Varibobën shprehet kështu: «Por duhet thënë përfundimisht se Variboba është më i vjetri poet i vërtetë i literaturës shqipe. Sa për gjuhën e tij, duhet vërejtur se Variboba në frymë e në formë është poet popullor» (f. 35). Në analizën e De Radës vë në dukje notën romantike të subjektivizmit të tij, lidhjen e ngushtë të krijimtarisë së tij me poezinë popullore. «Lavdërimi i së shkruarës nacionale-thotë-dhe aktiviteti nacionalist (d.m.th. patriotik, në shërbim të çështjes nacionale — M.D.) në jetë kanë qenë një nevojë shpirtërore për poetët romantikë. Me këto ideale ka qenë plot shpirti i De Radës. Dhe plot janë veprat e tij me lavdinë e kohës epike shqiptare, shekullit të XV të Skënder-

beut». Dhe përfundon: «Por De Rada i ka ngrehur vetes një përmendore të pavdekshme në letërsinë shqipe e në historinë e nacionalizmit shqiptar. Ai është i pari i poetëve shqiptarë të Italisë dhe idealisti më i madh i tyre». Për Seremben tërheq vëmendjen mbi pasurimin e gjuhës së tij me fjalë të marrura jo vetëm nga katunde të tjera arbëreshe, por edhe nga Shqipëria: e quan improvizator gjenial, mjeshtër të sonetit dhe të oktavës, «një nga figurat më markante të letërsisë shqipe», fuqia krijuese e të cilit «që sigurisht e fortë dhe spontane». Krijimtarinë poetike të Gavril Darës e vlerëson shumë: «... Ndihet në të, nga goja e plakut Bala, vaji për lirinë e humbur, mallëngjimi i mërgimit, kujtimi për madhështinë e perënduar dhe dashuria e nxehtë për Shqipërinë e largët... Është një nga veprat më të bukura të letërsisë sonë».

Në veprën «Për gjenezën e literaturës shqipe» (1939), në 30 faqe kushtuar folklorit shqiptar, vështrohen mjaft motive të folklorit arbëresh në planin krahasues, të brendshëm e të jashtëm, ashtu siç e kishte bërë në artikujt «Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare» (1934), «Konstandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut» (1937). Autori vë re se kthimi i Odiseut dhe rinjohja e tij ka disa paralele specifike me brendinë e këngës shqiptare: flet për karakterin akritik të disa këngëve arbëreshe. «Këto këngë epike te shqiptarët e Italisë — thotë ai — grumbullohen rreth Skënderbeut. Shpata damaskine dhe vera e Malvazisë e këngës akritike greke na dalin përpara në këngën serbe dhe italo-shqiptare. Atmosfera e këngëve shqiptare të Italisë është për një pjesë të madhe akritike. Kënga e Leonorës e përhapur në gjithë popujt ballkanikë, ka ngjyrë akritike. Po kështu përcaktohen edhe kënga «Konstandini i vogëlith», disa hollësi të këngës «Skënderbeu e Milo Shini» etj.

2. Përveç trajtimit në vepra të karakterit pak a shumë të përgjithshëm si këto, prof. Eqrem Cabej tematikës arbëreshe i kushtoi edhe studime, kontribute e artikuj të veçantë, që u botuan në të përkohshme e në përmbledhje të ndrushme. Është për t'u përhëndetur nisma e Shtëpisë botuese «8 Nëntori» për t'i përmbledhur ato në një vëllim më vete si ku, që po i paraqitet publikut tonë. Me këtë botim u vihet në dorë lexuesve një tufë studimesh me interes, jo lehtësisht të shfrytëzueshme të shpërndara siç kanë qenë gjer tani gjithandej, dhe del më në pah ndihmesa me vlerë e shkencë-

tarit tonë të shquar në një fushë studimore me aq interes, siç është problematika arbëreshe.

Përmbledhja karakterizohet nga pasuria e nga larmia e tematikës, gjë që tregon horizontin e hapët dhe gamën e gjerë të interesave studimore të prof. Eqrem Çabejt.

Vendin e parë e zënë aty studimet gjuhësore. Disa prej tyre u kushtohen çështjeve me karakter të përgjithshëm, si e folmja arbëreshe në strukturën e saj dialektore e në lidhjet e saj me dialektet e të folmet e Shqipërisë, zhvillimi historik i arbërishtes e rëndësia e të dhënave të saj për përcaktimin kronologjik të disa dukurive e fakteve gjuhësore, siç është rasti i shtresëzimit e kronologjisë së turqizimave etj., për historinë e gjuhës shqipe, për leksikun arbëresh e antroponiminë arbëreshe etj. Në disa prej tyre gërshetohen trajtimet gjuhësore me vështrimet historike dhe me gjendjen e sotme të ngulimeve arbëreshe.

Në punimin «Çështja e prejardhjes së ngulimeve arbëreshe të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave vetjakë», pas të dhënave historike e gojore për valët e shpërnguljeve të ndryshme, autori shtron problemin e përkatësisë dialektore të arbërishtes dhe të qendeve të prejardhjes së stërgjyshërve të folësve të sotëm të saj. Ai vë re se «Me konstatimin e përgjithshëm që këto ligjërime në thelb hyjnë në dialektin jugor të shqipes, në toskërisht, dhe që kështu folësit e tyre rrjedhin nga pjesa jugore e truallit gjuhësor të shqipes, problemi nuk është zgjidhur, sepse mbetet detyra që të përcaktohet më saktë vatra e shpërnguljes përbrenda atdheut mëmë prej të cilit ata kanë dalë». Lidhur me këtë çështje prof. Eqrem Çabej, me njohjen e tij të gjerë dhe me gjykimin e tij të peshuar, tërheq vëmendjen në faktin që «konceptet dialekt dhe prejardhje gjeografike vërtet shpesh herë puthiten, por nuk janë përherë e njëjta gjë», pohon se «arbërishtja në thelb nuk paraqet një trevë dialektore të një-pjesë grupe prej trevash të ndryshme të Shqipërisë...». Ai ato kanë ruajtur disa tipare më të mocme që i lidhnin ngushtë me ligjërimet arbëreshe të Greqisë dhe me toskërishten jug-perëndimore e jugore, me ligjërimet e Himarës, të Labërisë e të Çamërisë, po njëkohësisht, pas shkëputjes nga të folmet e atdheut-mëmë, ato kanë pasur zhvillimin e mëvetësishëm të tyre, me risime të ndryshme; duke i përkultur përgjithësisht

toskërishtes; në disa prej tyre vërehen elemente geqe që shpjen më fort në Shqipërinë e Mesme.

Këto çështje trajtohen edhe në punimet «Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre», «Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes». Në to, përveç që jepet një pasqyrë e plotë e përhapjes së ngulimeve arbëreshe në Itali dhe e gjendjes së sotme të tyre, shtrohen problemet e vendit që zënë të folmet arbëreshe në ndarjen dialektore të shqipes, të lidhjeve me ligjërimet e ndryshme të shqipes, si edhe të zhvillimit të mëtejshëm të tyre. Ka njësi e ndryshmëri, ngulime homogjene, po edhe heterogjene, duke mbizotëruar një-sia. Analizohen një sërë faktesh e dukurish gjuhësore, karakteristike të ligjëtimeve arbëreshe, vihen në dukje ruajtje e zhvillime, përkime e lidhje, duke u theksuar rëndësia që ka kjo degë dialektore për studimin e shqipes e për historinë e saj, si edhe interesi që paraqet për gjuhësinë e përgjithshme e për problemet e saj.

Në të njëjtën mënyrë bashkohen e përgjithshmeja dhe e veçanta, vëzhgimet e imëta dhe përfundimet përgjithësuese në artikullin «Nga leksiku i dialekteve arbëreshe të Kalabrisë», ku analizohen në planet përshkruese, krahasuese, historike një numër i mirë fjalësh të arbërishtes.

Njohja e saktë dhe e thelluar e arbërishtes dhe e letërsisë shqiptare, përgatitja e shëndoshë filologjike dalin edhe në artikullin «Mbi disa tekste italo-shqiptare», me vërejtje kritike për botimin e disa pjesëve të zgjedhura të Lekë Matrangës, Jul Varibobës, Jeronim de Radës, Anton Santorit në një libër destinuar nxënësve të shkollës së mesme. Aty ndreqen pasaktësi transkriptimi, shpjegime të gabuara, trajtohen çështje leksikologjike e gramatikore me interes për historinë e dialektologjinë e gjuhës shqipe, për pasurinë e saj, për metodën e drejtë shkencore që duhet ndjekur në të tilla raste.

Prof. Eqrem Çabej ka pasur kujdes të nxjerrë nga vëzhgimi i materialit gjuhësor arbëresh të dhëna dhe përfundime me vlerë për historinë e gjuhës shqipe, të përdorë faktet gjuhësore arbëreshe në trajtimin e mjaft çështjeve të veçanta të kësaj historie. Një të tillë e kemi edhe në studimin «Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes». Fjalët e ligjëtimeve arbëreshe i japin mundësi të hedhë dritë mbi shtresën më të vjetër të turqizimeve të shqipes, e ato të së folmes së Villa Badessa-s mbi shtresën më të re të tyre, po para vitit 1744.

Me një njohje të mirë të varianteve arbëreshe trajtohen

dy motive e tema të epikës sonë legjendare, duke u dhënë mendime e përfundime përgjithësuere me vlerë. Me «Konstantini i vogëlith e kthimi i Odiseut», «Kënga e Leonorës në poezinë popullore shqiptare» dhe me trajtimin e bërë folklorit tonë në veprën «Për gjenezën e literaturës shqipe», prof. Eqrem Çabej është i pari studiues shqiptar në planin krahasues, të brendshëm e të jashtëm, i motiveve të krijimeve tona folklorike, që vuri në dukje unitetin shqiptar e takimet e tyre me folklorin e popujve të tjerë. Në «Poezia popullore e arbëreshëve të Italisë», hartuar për një tekst shkollor, botuar së pari në këtë tekst (1949), pa emër autori, e shumë vjet më pas në një revistë, me emrin e autorit, kemi një vështrim tërësor, të përgjithshëm, të thukët të folklorit të bukur arbëresh.

Përmbledhja përfshin edhe punimin «Vatra dhe bota në poezinë e De Radës», kushtuar poetit të madh arbëresh Jeronim de Radës. Në këtë shkrim këndi i veçantë i vështrimit, i ka krijuar autorit mundësi që të bëjë vëzhgime, të cilat vënë në dukje aspekte me interes të tregimtarisë aq të pasur deradiane. Theksohet lidhja e ngushtë e saj me poezinë popullore, duke treguar njëkohësisht edhe motivet e frymëzuara nga poezia klasike. «Burimet e poezisë popullore shqiptare e të letërsisë botërore — përfundon prof. Eqrem Çabej — e pasuruan krijimin poetik të De Radës, po ky në qenësi mbetet pjella e frymëzimit të tij».

Prof. Eqrem Çabej në gjurmimet e tij u ka kushtuar vëmendje edhe ngulimeve arbëreshe që gjatë kohës kanë humbur gjuhën e tyre, veçoritë e tyre kulturore dhe janë asimiluar. Një faqe e kësaj historie trajtohet edhe në ndonjë artikull të veçantë si «Shqiptarët në Itali të Mesme dhe në Napoli».

Për figurat e shquara të letërsisë e të kulturës arbëreshe ai shkroi në ndonjë rast portrete të shkurtra biografike. I kë-tij lloji është artikulli «Disa burra të shquar të arbëreshëve studiues të gjuhës, të letërsisë e të folklorit, si Nikollë Keta, Dhimitër Kamarda, Vinçens Dorsa, Mikele Markiano, Pal Skiroi, Nilo Borgia, Marko la Piana».

Botimi i kësaj përmbledhjeje do t'i shërbejë shumë jetës sonë shkencore e kulturore, do të bëjë të njohura në rrethe të gjera aspekte me interes të historisë së kulturës shqiptare, të pasurive shpirtërore të popullit tonë, studime këto me vlerë të një figure të shquar të shkencës sonë.

MAHIR DOMI

ÇËSHTJA E PREJARDHJES SË NGULIMEVET ARBËRESHE TË ITALISË NË DRITËN KRYESISHT TË GJUHËS E TË EMRAVE VETJAKE¹⁾

Shkakun e pandërmjëmë të shpërnguljes shqiptare për në Itali e kanë dhënë, sikundër dihet, luftërat me turqit. Pas luftimeve që u bënë nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit (Skënderbeut) dhe pas pushtimit të vendit nga osmanët, shumë njerëz u gjetën të shtrënguar të linin atdheun e tyre dhe të kërkonin një atdhe të ri në dhe të huaj.

Nuk është vendi këtu të hyhet në rrethanat historike të kësaj shpërnguljeje popullore. Do të shënohet vetëm që kjo u krye me disa valë, të cilat me ndërprerje kanë zgjatur afërsisht për tre shekuj, prej mesit të shekullit XV gjer aty nga mesi i shekullit XVIII. Krahas me kolonistët që u ngulën e zunë vend të përhershëm, duan përmendur trupat lëvizëse të stratiotëve, të cilët rekrutoheshin pjesërisht në Shqipëri, pjesërisht në gadishull të Moresë, pjesërisht edhe vetë në Itali, dhe dalin në fushat e betejave të Evropës Perëndimore si kalori e lehtë, si Epirotarum equites të asaj kohe.

Elementi shqiptar (arbëresh) në Itali me kohë është rruddhur shumë, ai sidomos nëpër qytete dhe në vise fushore si Apulia u asimilua që herët. Në katundet më fort malore përkundrazi ai, bashkë me gjuhën, ka ruajtur edhe kostumet, meloditë e vjetra popullore, doket e zakonet dhe për një pjesë edhe besimin ortodoks. Max Lambertzi, i cili njihet si një nga njohësit më të shquar të dialekteve arbëreshe që fliten në Itali, në vitin 1915 gjeti 49 lokalitete arbëreshe, të cilat

1) Kumtesë e mbajtur në Kongresin VIII Ndërkombëtar të Studimeve Onomastike në Amsterdam, 28 gusht 1963, dhe botuar së pari gjer-manisht në «Proceedings of the Eighth International Congress of Onomastic Sciences», The Hague-Paris 1966, f. 70-81.

janë të përderdhura në treva të ndryshme të Italisë Jugore e të Sicelisë¹⁾.

Çështja e prejardhjes së këtyre ngulimeve dhe e përkatësisë së veçantë të ligjëriemeve të tyre në strukturën dialektore të shqipes, edhe sot vazhdon të përbëjë një problem shkencor. Jo se s'ka pasur disa përpjekje serioze për t'i zgjidhur këto çështje, veçse ato nuk arrijnë të ngrihen mbi shkallën e supozimeve ose të një gjykimi me karakter të përgjithshëm. Me konstatimin e përgjithshëm që këto ligjërieme në thelb hyjnë në dialektin jugor të gjuhës shqipe, në toskërishten, dhe që kështu folësit e tyre rrjedhin nga pjesa jugore e truallit gjuhësor të shqipes, problemi nuk është zgjidhur, sepse mbetet detyra që të përcaktohet më saktë vatra e shpërnguljes përbrenda dheut mëmë prej të cilit ato kanë dalë.

Është për të vënë re që një arbëresh i Sicelisë, prifti Kolë Keta (Niccolò Chetta) prej katundit Contessa Entellina në krahinë të Palermos, para gati dyqind vjetëve, shtiu në punë dëshmitë e etnografisë, të historisë, të gjuhës dhe të onomastikës në një mënyrë thuajse moderne në studimin e prejardhjes së bashkatdhetarëve të tij më të ngushtë²⁾. Në ditët tona poeti Zef Skirò nga Piana dei Greci (tani Piana degli Albanesi, arbërisht Hora e t'Arbëreshvet), duke u mbështetur në disa barazime emrash si *Giovani Caminiti*, *Teodoro Dragota*, *Giorgo Golemi*, që dalin në dokumentat e themelimit të vendlindjes së tij: *Kamenica*, *Dragoti*, *Golemi*, në Akroka-rauni (Himarë) e në hinterlandin e saj në Shqipëri Jugperëndimore, e më ndonjë tjetër, si *Pietro Bua: Merkur Bua* po në Himarë si dhe mbi dëshminë e përkimeve në punë të shenjtorëve të katundeve të veçanta, arriti në përfundimin që një pjesë e banorëve të vendlindjes së tij rrjedhin prej Himare; më anë tjetër ruajtja e grupeve të hershme *kl* dhe *gl*, sipas tij vërteton se dialekti i atij vendi afrohet më shumë me çamërishten e skanjit më jugor të truallit gjuhësor të shqipes³⁾. Të tjerë dijetarë, mbi dëshminë e ndryshimeve që ka midis ishujve gjuhësorë arbëreshë të veçantë, i janë mbajtur mendimit të prejardhjes nga vise të ndryshme të Shqipërisë. Në këta bëjnë pjesë sidomos Giuseppe de Rada, i biri i poetit të

- 1) *Dialektet shqiptare në Itali*, «Indogerm. Jahrbuch» II (1915) f. 23.
- 2) Khs. Gius. Spata, *Studi etnologici di Niccolò Chetta sulla Macedonia e l'Albania* (1870) passim.
- 3) *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia* (1923) LXXI vv.

njohur Jeronim prej katundit Maqi në Kalabri¹⁾, gjuhëtari Dhimitër Kamarda²⁾, etnografi italian G. A. Andriulli³⁾, dhe në kohët e fundit Domenico Zangari⁴⁾. Sipas Lambertzit (në vendin e cituar f. 6 v.), tradita që jeton në kolonitë e Molizes, së bashku me disa emra të vjetër familjesh si *Muricchio*, *Muzacchie*, *Toskves*, *Likursi*, çojnë në krahina të ndryshme të Shqipërisë së Mesme e Jugore si vatra shpërnguljesh të këtyre kolonistëve, të cilët, me jetesën e re grumbull e së bashku në dhe të huaj, lentuan (krijuan) për vete, një gjuhë të re të përbashkët, e cila nuk ishte krejt identike me asnjë nga dialektet e vendit të nisjes, Shqipërisë.

Në qoftë se ne, duke qenë marrë vjete me radhë me gjuhën dhe historinë e këtyre ngulimeve, mund të japim një gjykim tonin në këtë çështje të vështirë, jemi të mendimit se vetëm me një vështrim të gjithanshëm të problemeve mund të shpresohet që t'i afrohemi zgjidhjes së tyre. Sidomos shtrohet detyra që të vlerësohen në mënyrë kritike të dhënat e etnografisë, të traditës gojore, po sidomos dhe të historisë, të gjuhës edhe të emrave vetiake në kuptimin më të hapët të kësaj fjale, dhe këto të kombinohen midis tyre. Në studimin e materialit është me rëndësi në këtë mes që të dallohet ajo që është specifike nga e përgjithshmja, dhe që ajo të merret në shqyrtim në një shkallë të veçantë e më të gjerë, si një element që çon peshë në problemin e prejardhjes. Është e qartë që në përmasat e një ligjërate siç është kjo, nuk ka si të preken të gjitha çështjet që hyjnë në këtë temë; disa vetëm do të çeken kalimthi, të tjerat do të trajtohen vetëm për summa capita, pra në vijat më kryesore.

Prej fushës së etnografisë, nga objektet e kulturës materiale, siç janë orenditë shtëpiake dhe kostumet e grave, nga sa e njohim ne materialin, nuk ka gjë që mund të shtihej me dobi në punë për çështjen që po na shtrohet përpara. Kështu qëndron puna edhe me doket e zakonet — të cilat përndryshe janë ruajtur mirë —, me figurat e besimeve popullore e të përrallave dhe me emrat e tyre, meqë ndikimi roman më njërin krah, e ndikimi turk më tjetrin, kanë këputur shumëkund fijet e lidhjeve që sigurisht dikur kanë ekzistuar. Më

1) *Grammatica della lingua albanese* (1870), f. 5.

2) Te G. Papanti, *I parlari italiani in Certaldo* (1875), f. 662.

3) *Le colonie albanesi d'Italia*, «Atti del primo Congresso di etnografia italiana» (Perugia, 1912) f. 183 vv.

4) *Le colonie italo-albanesi di Calabria; Storia e demografia, Secoli XV-XIX* (1941) f. 70, 77.

konservative është treguar poezia popullore. Kështu, bie fjalla, motivi i shndërrimit të gurit të varrit të vëllait të vdekur në një kalë at dhe i unazës së këtij guri në fretë e atit, ky model del dhe në variantet arbëreshe të këngës së Lenorës dhe në variantet e Toskërisë Jugore, duket pra se shpie në Jug të Shqipërisë. Gjithashtu dhe një këngë që sjell Lambertzi (K. Z. 53, f. 77. Nr 58) prej katundit Villa Badessa në Abrucet, këndohet gati me të njëjtat vargje dhe në qytet të Gjirokastrës. E toskërishtes jugore, e arbërishtes së Italisë dhe e asaj të Greqisë është kënga *Durò zëmër, e durò, Sa duron mali me borë*. Dy distikë që jepen në të përkohshmen greke Laographia (I, 1909, f. f. 83, 92) për shqipen e Atikës, na dalin po me atë ritëm e po me ato fjalë dhe në Shqipërinë Jugore. Përshëndetja *Falem, zot «Të falem zotni»* që përdoret në Çamëri dhe në anët e Prevezës në Epir, ndihet si *Falem* edhe në Itali Prej proverbeve ose prej këngëve popullore, laike e fetare, dhe melodive të tyre, nuk duket se mund të nxirret ndonjë gjë që të jetë specifike. Edhe besimi ortodoks bashkë me meloditë kishtarë bizantine vetëm në një mënyrë të përgjithshme çojnë në Shqipërinë e Mesme e Jugore.

Në gjykimin historik të këtij elementi etnik, kryesisht për arsye të shfrytëzimit të pakë të arkivave, kryesorë e krahinorë, të Italisë edhe në rrethet dijetare është formuar një traditë e ngulët me frymë shpeshherë romantike, e cila e bën të domosdoshme që me një kritikë sistematike të burimeve të ndahet gruri nga egjëra. Kësaj rrethane, në lidhje me çështjen se ku duhet kërkuar atdheu më i ngushtë i këtyre kolonistëve, duhet t'i shtohet edhe kjo, që edhe lajmet që do të merren si më të besueshme, duke përfshirë aty dhe dokumentet italiane, zakonisht nuk japin ndonjë sqarim më të saktë, sepse më të shumtën e herëve mjaftohen me ndonjë të dhënë të përgjithshme si «Albania» ose «Epiro». Njoftime më të sakta janë në gjendje të japin në këtë mes regjistrat kishtarë që ruhen nëpër lokalitetet e ndryshme. Ashtu mund të bëjnë dhe dokumentet e vllamive e të esnafeve qytetare ndër to, sidomos ato të Venetikut. Shumë më mirë se këto burime ndërkaq, për vatrat nga u nisën valat e ndryshme të shtektit, na sqarojnë kumtet me burim prej Shqipërie. Kështu të qytetit të Durrësit për në Apuli.¹⁾ Prej Shqipërisë së Mes-

1) *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia* II (1918) Nr. 506, M. v. Sufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters* (1924) f. 43.

me e Veriore u shkulën edhe ata, të cilët pas rënies së qyteve të Krujës e të Shkodrës (1478, 1479) pas një rezistence të fortë, ikën në masë e shkuan në Itali. Këta të fundit zunë vend në Venetik vetë, si dhe në qytetet Treviso, Gradisca e Ravenna. Nga të parët, shumë nga ata që kishin shkuar pas Gjon Kastriotit, të birit të Skënderbeut, ngulën në feudet që u dhanë këtij në Apuli. Nuk dihet se nga ç'krahinë e Shqipërisë ishin grupet që shfaqen në qytetet Rekanati (1437), Ankona (1458) e më në jug (Ariano afër Avellinos, Matera, Castelluccio dei Sauri, Giovinazzo etj.) e që zhduken që herët; veçse nga shfaqja e tyre së bashku me të shpërngulur sllavë, si dhe nga ndonjë emër vetjak i tyre, do të mendohet se rridhnin pjesërisht prej Shqipërisë Veriore. Prej Gegërie duhet të jenë arratisur edhe ata, të cilët pas F. Babingerit¹⁾ kishin dalë në Brindisi në korrik të vitit 1467 dhe sollën atje kumtin e daljes së Sulltan Mehmetit II në afërsi të lumit të Erzenit, i cili rrjedh nëpër trevat²⁾ e Shqipërisë Qendrore.

Tradita gojore e vijuar brez pas brezi, e cila përbën një burim me rëndësi në çështjen e hetimit të prejardhjes, në pajtim me lajmet historike, jep dëshmi për vala shtektimi prej krahinash të ndryshme të Shqipërisë. Kështu, bie fjala, banorët e Vilës në krahinë të Lumës dhe banorët e Rremëllit në Mat kallëzojnë për shpërngulje lagjesh të tëra ose grupesh familjare në kohët e para. Ashtu tregojnë dhe banorët e Virjonit dhe të Zgërdheshit në rreth të Krujës në lidhje me gërmadhat që gjinden aty pranë²⁾, si dhe banorët e Çetajt, Lekajt e Domënit afër Kavajës. Më shumë të dhëna ka nga pjesa jugperëndimore e vendit, nga Bregu i Detit midis Vlorës e Sarandës, që gjindet përballë Italisë, e nga hinterlandi i tij. Në ato anë tregojnë për shpërngulje banorësh të Luzatit të Tepelenës e të Tatzatit, Kalasë e Palavlisë të Delvinës për në Itali. Gjithashtu dhe banorët e dy fshatrave — sot të shkreta — Vakaj e Sopot të asaj ane, për shkak të grindjeve me ata të Borshit për punë kufijsh, e gjetën më me udhë e shkuan në Itali. Banorët e dikurshëm të Buzuqit u shkulën e shkuan një pjesë në katundin e afërm të Sopikut, një pjesë në Itali. Burimi i banorëve të Villa Badessës në Abrucet prej Piqerasit të Bregut të Detit, burim i dokumentuar historikisht, vërtetohet dhe me traditën gojore që vazhdon të jetë e

1) *Maometto il Conquistatore e il suo tempo* (1957), f. 333.

2) Pas H. Cekës, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore XIII 1 (1959), f. 148 shën. 4.

gjallë në këtë katund të Shqipërisë. Sipas kësaj tradite, atë katund të Italisë e kanë themeluar pjesërisht ata të Piqerasit, pjesërisht ata të fshatit të afërm të Vilës, që sot ka mbetur shkretë e me gërmadha. Në Itali vetë janë të rralla gjurmët që kanë mbetur nga kujtimi i një prejardhjeje nga një krahinë e caktuar e Shqipërisë. Pas traditës gojore që ruhet në familjen Kandreva të katundit Spezzano Albanese në Kalabri, të parët e kësaj familjeje janë të ardhur prej Vlore. Në Genazzano jo fort larg prej Romës lusin një fytyrë të Mërisë, për të cilën gojëdhana lokale tregon se u soll atje prej shtegtarësh të ikur nga Shkodra¹⁾.

Nga ç'u shtjellua gjer këtu rezulton se në formimin e ngulimeve në Itali kanë marrë pjesë grupe etnike prej trevash të ndryshme të Shqipërisë, ndër to ato që i shpëtuan asimilimit të valëve të para. Për sa i përket çështjes se cila krahinë dha masën kryesore të njerëzve në këtë mes, të dhënat etnografike e historike bashkë me traditën gojore vetëm në disa pak rase mund të japin një përgjigje të prerë. Le të shohim tani se gjer në ç'masë është gjuha në gjendje të plotësojë dëshmitë e burimeve të tjera.

Nga pikëpamja gjuhësore është puna të dihet se me cilin dialekt (ose me cilat dialekte) të vendit mëmë afrohet më shumë arbërishtja e Italisë. Kësaj pyetjeje nuk mund t'i jepet lehtë një përgjigje, edhe vetë për arsye se arbërishtja në thelb nuk paraqet një trevë dialektore të njësishme. Vetë ligjërimet që fliten në Siqeli, ndryshojnë mjaft njëri nga tjetri; një pjesë e tyre në disa tipare shkon me ato të Molizës, një pjesë tjetër me ato të Kalabrisë, të cilat edhe ato ndryshojnë në mes tyre. Këto dallime kanë arsyet e tyre historike, të cilat nga ana e vet kanë lidhje me rrethanat e veçanta të imigrimit dhe të zënit vend në vise të ndryshme. Duhet të kemi parasysh në këtë mes që lëvizja e shtektimit shqiptar u krye kryesisht në kohë luftrash. Aq të shpeshta sa grupet homogjene me burim prej një krahine të vetme, kanë qenë edhe grupet shtektare të përbëra prej gjindsh nga krahina, shtresa, mjeshtëri e zanate të ndryshme, të cilat u bënë tok nga shtrëngimi i çastit dhe si e pruri dhe hera. Kështu pra qysh në atdheun e vjetër u nis puna që njerëz burimesh e visesh të ndryshme, në dhe të Italisë zunë vend së bashku në një

1) Për këtë gojëdhanë khs. Mons. G. F. Dillon, D. D., *La vergine Madre del Buon Consiglio in Genazzano* (1893) ff. 93 vv., 459 vv., 475 vv.

truall. Përveç kësaj pati bashkim e grumbullim elementesh të ndryshme, heterogjene, në atdheun e ri, e m'anë tjetër vendosje veç e veç për grupe kolonistësh që në krye të herës kishin qenë të një trangu. Ngulimet e themeluara me këto rrugë pësuan me kohë dhe të tjera ndryshime. Në disa sosh vërtetohet se vanë e zunë vend ardhës të rinj prej Shqipërie ose prej gadishullit të Moresë. Në ngulimet sidomos të kontinentit italian ka pasur dhe shtektime të brendshme, për shkak tërmetesh ose epidemish, ose sepse njërin ngulim e tërhoqi e e thithi një tjetër, dhe jo pak ishuj gjuhësorë u tretën në elementin roman që i rrethonte. Kuptohet mirëfilli që këto lëvizje patën pasoja edhe në punë të gjuhës. Në ligjërimet që u formuan nga elemente burimi të ndryshëm, pati me kohë një mbishtresim, vendosje të një shtrese dialektore mbi një tjetër, dhe një përzjerje dialektesh, një lloj koineje gojore. Në këtë rrafshim e barazim që u krye në atë mes, mënyra e të folurit e masës më të shëndoshë në numër (ose mbase e shtresës më të parë, më të moçme të banorëve) mbizotëroi mbi atë të elementeve heterogjene të ardhësve më të vonë etj., të cilët vetvetiu u shkrinë me shumicën.

Këto kritere parimore duhet të kihen parasysh kur merret në shqyrtim çështja se ç'vend zënë përbrenda shqipes dialektet arbëreshe t'Italisë, të formuara gjatë shekujve XV e XVI, dhe cili është burimi i bartësve të tyre. Kur shtrohet pastaj puna — e domosdoshme — e krahasimit me dialektet e dheut mëmë, aty do pasur parasysh që këto dialekte të fundit, gjatë kohës së kaluar që nga shkëputja e atyre të parave, kanë kryer zhvillimin e vet, me disa rejime (inovacione) pjesërisht mjaft të forta. Në këto rrethana, në pikëpamje metodologjike shtrohet kërkesa që bëhet me synim për caktimin e vatrës së shpërnguljes, të kihet parasysh parimi diakronik, pra zhvillimi gjuhësor në kohë, në të dyja brigjet detare, në anën e këndejme e të andejmen.

Duke qëndruar mbi këtë bazë parimore, do vënë re që arbërishtja e Italisë, sikundër u tha edhe më lart, i përket përgjithësisht toskërishtes, duke paraqitur qartë tiparet karakteristike të këtij dialekti. Për historinë e gjuhës shqipe ndërkaq është me rëndësi kryesore, që ajo degë e dialektit në fjalë, së bashku me shqipen që flitet në Greqi, nga puna e shkëputjes së hershme prej këtij trangu, ka ruajtur disa tipare më të moçme, të cilat ligjërimet toske të atdheut i kanë bjerë në pjesën më të madhe. Kjo rrethanë ndërkaq, për çështjen e vendit nga burojnë këto dialekte, është pa rëndësi

ose me rëndësi të pakë, sepse ato tipare janë më fort të karakterit historik të gjuhës se sa të karakterit dialekt-gjeografik: ato vetëm na çojnë në një shkallë gjuhësore, ku bigëzimi në gegërisht e toskërisht vërtet kishte marrë formë, por nuk u kish zhvilluar gjer në gjendjen e sotme. Në çështjen e vendit të burimit, më fort se dukuritë e ruajtjes, vijnë në vështrim ato të rejimit (inovacionit) dialektor, e përgjithësisht elemente specifike të tilla që të lejojnë një lokalizim të prerë. Aty, nga sistemi fonetik hyn palatalizimi i *y*-së në *i* në toskërishten jugore (me çamërishten) e në arbërishten e Italisë e të Greqisë; shqiptimi i zanores së mesme *ë* me timbër *o*-je ose *i*-je në këto dialekte, kurse në toskërishten veriore, të mesme e lindorë mbizotëron timbri me *e*; zhdukja e *v*-së në grupet *xv xhv sv shv zhv* në trajta të tilla si *xerk, xhesh*; asimilimi i shpeshtë i konsonanteve sidomos para një *n*-je, si në *ju flini* për *ju flitni*, *vrini* për *vrinri*. Në këtë mes mund të vlerësohet si një konkordancë specifike edhe ruajtja e spirantit palatal të pazëshëm (ich-Laut, X) si dhe ruajtja e tingullit *l*, si kur ndodhet vetëm si kur ndodhet para ose pas një okluzivi gutural (*lk, lg, kl, gl*), megjithëse aty në të vërtetë kemi të bëjmë me dukuri ruajtjeje, konservimi. Veçanërisht në Himarë (Qeparó) na shpie shurdhimi i *j*-së fundore në një spirant palatal të pazëshëm (ich-Laut) në Piana degli Albanesi (Hora e t'Arbreshvet) të Siqelisë. Në Himarë e Labëri e ka vatrën e vet labializimi i *ë*-së së theksuar në *o*, i cili na del dhe në katundet S. Nicola dell'Alto e Pallagorio të krahinës së Katanxaros në Kalabri Jugore, dhe që Gerhard Rohlfsi e pat vënë re dhe në Acquafredda në krahinë të Kozencës. Nga sistemi morfologjik mund të përmenden formimi i shpeshtë i shumësit të emrave e mbiemrave me metafoini *a : e* dhe me zgjerim teme me *-ër-ëra* në toskërishten jugore e në arbërishten e Italisë e të Greqisë, ruajtja mjaft e fortë e asnjansit dhe rrjedhorja e shumësit më *-shit*; në fleksionin foljor e tanishmja e vetës së parë shumës më *-mi* në Kalabri e në Molize, e cila gjen përgjegjësen e saj në trajtën *shomi* «shohim» të çamërishtes; aoristet dhe pjesoret e zgjeruara me *-t-*, *erhtin*, *muartim*, *thertur*; e ardhmja (me habeo) *kam të dërgoj*, kontraksioni në urdhëroren *vré* (nga *vrae*), ndërhyrja e përemrit enklitik në urdhëroren, në rasta si *mërrie* «merreni, merrnie». Nga përkimet edhe më të shumta në fushë të leksikut le të përmendim p.sh. *dihet* «gdhiet», *menatë* «mëngjes» (në thelb «me natë»), *dej* «pasnesër», *kosdëj* «tjetërpasnesër», *njëditës* «parëdje», *njënatëz* «parëmbremë»,

pastaj *delmér* «bari dhensh, dhenar», *dirk derk* «këlysh derri, gic», *mbloj* «mbush», *përderës* «lypës», *rah* «bregore, kodër», stihî «kulshedër», *shajtòj* «vras keq një pjesë të trupit», *shirk* «rrëshek», *shtuara* «(duke ndenjur) në këmbë, jo ulur», *tëtim* «të ftohtë, ftomë», *virúa* «rrjedhë uji, përrua»; si trajta fjalësh, *pishk* «peshk» (një shumës i singularizuar), *kulish* «këlysh», *ehënj* për *preh*, *pref*, *zborë* për *borë*; si kuptime fjalësh, *çoj* «gjej», *pra* «pastaj», parmëndë edhe «Harusha e madhe».

Me këto përkime, të cilat nuk e shterojnë kurrsesi materialin, vërtetohet një lidhje më e ngushtë e arbërishtes së Italisë dhe e arbërishtes së Greqisë si ndërmjet tyre si dhe me toskërishten jugperëndimore e jugore, pra me ligjërimet e Himarës, të Labërisë e të Çamërisë. Edhe kur njëri ose tjetri tipar i përbashkët i ka rrënjët në një shkallë më të lashtë të gjuhës, edhe kur ai del dhe në të tjera ligjërimet të toskërishtes ose edhe në gegërishten, ai së bashku me numrin e madh të barazimeve specifike do të vendohet si një hallkë në këtë varg përkimesh. Që ndërkaq në këtë fushë dialektore gjinden dhe elemente gege, kjo, me situatën historike që u ravizua më lart, është një gjë që pritet a priori. Aty hyjnë trajta si *ásht* për *është*, *mám* për *mëmë* në katundin Vaccarico (Vaccarizzo) të Kalabrisë (Gius. de Rada, në vendin e cituar, f. 7), në Kalabri gjithashtu edhe *opangë* për *opingë*, *mbase* edhe *katerdjét* në S. Marzano afër Tarentit (Tarantos) në Apuli, në vend të *dizét*. Po sidomos zbutimi i *l*-së pas një *p*, *b*, *f*, *v*-je, në forma fjalësh si *pjak*, *fjetë*, në ligjërimet e luginës së lumit Krati në Kalabri të Mesme, na shpie në anët e Gegërisë, veçse aty më fort në Shqipëri të Mesme se sa në viset më në lindje, të Dibrës e të Maqedonisë.

Tani le të shikojmë me një vështrim të shpejtë gjer ku dëshmia e emrave vetiakë është në gjendje të vërtetë rezultatet e arritura me anë të paralelizmave etnografike e dialektore dhe me të dhënat e historisë dhe të traditës gojore, dhe eventualisht t'i saktësojë. Aty para së gjithave është për të shënuar që konceptet dialekt edhe prejardhje gjeografike vërtet shpeshherë puthiten, po nuk janë përhera e njëjta gjë. Gjuha është diçka rezultative, përfundim dhe rezultat i fundit procesesh etnike dhe historike gjithënduarsh, i cili reflekton ato gjer në një farë shkalle, po kurrsesi nuk mund t'i pasqyrojë në shumësinë laramane të tyre. Emrat përkundrazi kanë këtë gjë të përbashkët me burimet historike, që përmajnë diçka të caktuar në vetvete, duke na dhënë shpesh-

BIBLIOTEKA E APULIA

6441-1110 17

50670

herë burimin lokal të një shpërnguljeje etnike ose të një lëvizjeje shtektare.

Parimet e emërtimit (të përdorimit të emrave) në gjuhën shqipe, përsa u përket emrave personale të individëve, në vijat kryesore dihen, dhe këtu sigurisht nuk është vendi që të hyhet në hollësitë e kësaj teme komplekse. Do të shënojmë vetëm që Norbert Jokli¹⁾ ka vënë re se mbiemrat (llagapet), të cilat me kohë arrijnë të zhvillohen në emra familjesh, afërsisht ashtu si në gjermanishten (*Lichtenberg, Brockhaus, Buchholz*), janë thjesht emra visesh, pa ndonjë zgjerim me anë sufiksi, si *Fishta, Bilishti, Katundi*, dhe me këtë ka rrokur një tipar qenësor të përdorimit të emrave vetiakë të shqipes. Me rëndësi në pikëpamje sociologjike është dhe konstatimi i Franz Seinerit²⁾ se në Shqipëri vetëm paria me një pjesë të inteligjencës qytetare kanë pasur emra familjarë të qëndrueshëm, se përkundrazi në masën më të madhe të popullsisë përdorej gati kudo një emër i vetëm, dhe se emri i aytë që i shtohet eventualisht të parit në vendlindje, gati përgjithësisht ishte emri individual i t'et. Duhet thënë ndërkaq se me këto konstatime, çështjet e ndryshme që i dalin antroponomisë shqiptare dhe punës së zhvillimit historik të saj, nuk janë shteruar gjëkund. Nëpër dokumentet mesjetare që janë botuar në «*Acta Albaniae*» I. edhe II. e në të tjera vepra përmbledhëse, krahas me emra teke si *Gjin, Gjon*, dalin dhe asosh që janë të pajisura me një patronimik (emër babe), si *Ginus Tanusius*, i cili erdhi pastaj e u bë mbiemër e më tej edhe emër familjeje, si *Progon Mira*. Ka aty dhe mbiemra ose emra familjesh disi të ndryshuara, të dala nga emra etnikë ose visesh (*Lazarus Malliocus*), nga një veprimtari sociale (*Demetrius Lallimi* «Lajmësi, Kasneci»), nga një veti fizike (*Paulus Burmád* «Burrëmadhi», *Theodorus Këshëtësi*), nga një ofiq (*Nicolaus Der, Georgius Passimada* «Paksimadhi»). I shpeshtë është sidomos formimi i mbiemrave nga emra visesh të pandryshuara, formim i vrejtur prej Joklit, si në *Guillelmus Blenisti, Paulus Bossato* (Bushati), *Damianus Dusmani, Petrus Kuç, Demetrius Chimara, Johanes Pinkernes* (Piqerasi). Për formimin e mbiemrave dhe emrave familjarë (në krye të herës ofiqe) nga emra shtazësh, si *Demë, Mazi, Dashi*, për emrat historikë të tipit *Bua, «Buall», Muzaki*

1) Zbornik A. Belič (1921) f. 56.

2) *Ergebnisse der Volkszählung in Albanien in dem von den österreichisch-ungarischen Truppen 1916-1918 besetzten Gebiete* (1922), f. 4.

«Mëzati», dhe për emrat me tri gjymtyrë si *Gjin Bua Shpata*, *Gjergj Elez Alija*, për këto kemi folur me raste të tjera¹).

Duke i vështruar së këndejmi emrat e moçëm familjarë që arbëreshët e Italisë sollën me vete prej Gadishullit Ballkanik, vihet re se këto në vijë të përgjithshme hyjnë në sistemin e shqipes së përbashkët që u ravizua këtu. Në lidhje me çështjen e prejardhjes është me rëndësi kryesore fakti që emrat më të njohura si *Baffa*, *Barbati*, *Barçi Basile*, *Becci*, *Becci*, *Bellusci*, *Cadicamo*, *Candrea*, *Carnesi*, *Cucci*, *Damis*, *Dara*, *Dorsa*, *Dramis*, *Golemi*, *Helmi*, *Lala*, *Licursi*, *Lopes*, *Lucci*, *Manesi*, *Marchianò*, *Masaracchia*, *Masi*, *Masci*, *Mates*, *Matranga*, *Mortati*, *Petta*, *Plescica*, *Rada*, *Reres*, *Ribecco*, *Schirò*, *Smilari*, *Staffa*, *Stamati*, *Suli*, *Tocci*, *Variboba*, në pjesën e tyre më të madhe na paraqiten në ngulime të ndryshme. Me këtë gjen vërtetim nga ana e onomastikës mendimi që u dha më lart, që grupe shtektarësh të njësishe, në atdheun e tyre të riun, u shpërndanë e u shkoqën dhe që m'anë tjetër aty pati edhe shtektime të brendshme, me anë të së cilave disa familje dhe bashkë me to edhe emrat e tyre u shpërngulën nga një ngulim a disa ngulime në ngulime të tjera.

Për sa i përket më tej prejardhjes prej Shqipërie, është për të vënë re se një pjesë e konsiderueshme e emrave të dyerve bujare që dihen nga historia shqiptare e mesjetës së vonë dhe e mbarimit të saj, si *Arianiti*, *Basta*, *Bua*, *Dukagjini*, *Gropa*, *Kastrioti*, *Losha*, *Matarangu*, *Muriqi*, *Muzaki*, *Skura*, *Span*, *Spata*, *Thopia*, na dalin dhe në Itali, dhe në pjesën më të madhe janë ruajtur atje gjer në ditën e sotme. Nga ato dyer dihet se Dukagjinët, Kastriotët e Spanët kanë qenë në Shqipërinë Veriore, Arianitët, Gropajt, Matarangët, Muzakët, Skurajt dhe Topiajt të Shqipërisë së Mesme, Bastët, Buat, Loshajt, Muriqet, Spatajt të Shqipërisë Jugore.²)

Kjo shtresë e vogël zotërinjsh, me burim prej trevash të ndryshme, në çështjen se nga rrjedhin kolonitë, nuk ka

- 1) «Lingua Posnaniensis» VIII (1960), f. 104, — «Hylli i Dritës» XVII (1939) f. 161 v., «Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa» 3 (1939) f. 203 v.
- 2) Khs. edhe Ch. Hopf. *Chroniques gréco-romanes* (1873) f. 270 vv. («Breve memoria de li discendenti di nostra casa Musachi») dhe f. 530 vv. («dru-rët gjenealogjikë»); J. G. v. Hahn, *Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar* (=Denkschr. d. K. K. Ak. d. Wiss. XVI, Vjenë 1869) f. 84 vv.; F. Babinger, *Das Ende der Arianiten* (Bayr. Ak. d. Wiss. Phil-hist. Kl., Sitzungsber, viti 1960, fash. 4, f. 6 vvè).

aq rëndësi në vetvete, se sa më fort nga puna se ka të ngjarë që këta feudalë morën me vete për në Itali edhe gjind të rrëthit të tyre të ngushtë, bashkë me familjet e tyre, dhe ndihmuan kështu në përzjerjen ndërkrainore në ngulimet e reja që u themeluan.

Më rëndësi ka që të shikohet dëshmia e emrave vetiake për të hetuar vendin nga u nis masa e gjerë popullore, ku hyjnë edhe misat e bujarisë së vogël dhe të bujarisë fshatare. Këtu na dëfton udhën ky fakt, që onomastika arbëreshe e Italisë bën pjesë në onomastikën e përgjithshme shqiptare, ku vihet re që familjet e ardhura rishtas, sidomos në popullsinë katundare, si emër të vetin mbajnë emrin e pandryshuar të vendburimit të tyre, ose ua ngjit këtë emër rrethi i ri ku kanë zënë vend. Nga një shoshitje e emrave familjarë arbëreshë kryer nga kjo pikëpamje, shihet se një pjesë e mirë e këtyre na shpie në trevën ç'merr prej Vlore e gjer lart në Prevezë në Epir, bashkë me hinterlandin përkatës, një trevë ku këta emra na dalin si emra vendesh. Aty hyjnë sidomos *Borscia Borgia* (Borshi), *Cacosi*, *Cameniti*, *Cravari* (Kravari në qark të Prevezës), *Cucci*, *Cudes* (Kudhës në Breg të Detit e në qark të Vlorës), *Damis* (Damës pranë Tepelenës), *Dara* (edhe fshat në qark të Prevezës), *Dirmi* (Dhërmi), *Dorsa* (Dorza), *Dragotta*, *Dramis* (Dramës në Çamëri), *Glava*, *Golemi*, *Groppa* (Gropa në Kurvelesh), *Jerbees* (Gjerbës), *Licursi*, *Lopes*, *Masaracchia* (Mazërek në Çamëri), *Pillora* (Pilur), *Reres* (Kërës në Mallakastër), *Schiadà* (Shqadhà në Çamëri), *Schirò* (Sqirò në qark të Vlorës), *Tocci*, *Variboba* (Varibopi në Mallakastër, edhe pranë Këlcyrës) *Zarobina* (Zharovina). Ka pas-taj emra familjesh arbëreshe, të cilave nga treva e përcaktuar më sipër u përgjigjen emra familjesh ose fisesh, si p.sh. *Andronico*, *Bala*, *Barbaçi*, *Bellusci*, *Granà* (Vranà), *Ghisci*, *Lucci*, *Macri*, *Masi*, *Stamati*, *Strati*, *Sciarra*, *Tanasi*, *Thani*, *Varfi*, *Zuppa* (Zhupa), edhe *Basta*, *Bua*, *Losha*, *Muriqi*, *Spata* që u përmendën më lart. Nuk mungojnë as barazimet toponomastike, si *S. Demetrio Corone* në Kalabri: *Koronë* afër Pircarit (Gjirokastër) dhe në Çamëri, *Shkëmbi* lagje në Piana degli Albanesi: *Shkëmbi* katund në qark të Prevezës. Tregues të mirë në çështjen e prejardhjes janë edhe emrat e viseve të formuara nga emra shenjtorësh, po këto do t'i kalojmë këtu pa i përmendur.

Duke i përfshirë me një vështrim përmbledhës këta emra, numri i të cilëve fare lehtë mund të shtohet, shihet se ato e përforcojnë rezultatin e arritur me mjetet e kërkimeve dia-

lektikore, që d.m.th. një pjesë bukur e madhe e elementit shqiptar që u shkui për në Itali, e ka vatrën e vendburimit e saj në trevën e përcaktuar të Shqipërisë Jugore. Vihet re ndërkaq që ndër emrat që u zunë ngoje më lart, disa (si *Barci, Dorsa, Dragotta, Golemi, Gjerbës, Cameniti, Cucci, Masaracchia, Musacchia, Pillora, Suli, Sciales*) janë të shumëkuptimshëm (ambigüe) për nga ana e burimit gjeografik, ngaqë në Shqipëri ka më se një vend që u përgjigjet; ato na shfaqen si emra visesh edhe përtej caqeve të zonës në fjalë, arrijnë bile pjesërisht gjer lart në trevat e Gegërisë. Që bartësit e parë të këtyre emrave në Itali të kenë qenë nga këto krahina më të largëta, mundësia për këtë është e dhënë pa tjetër. Ndërkaq, pas gjendjes së përgjithshme që u ravizua këtu, do të pranohet që së paku një pjesë e banorëve të parë që mbanin këta emra, kanë dalë prej visesh që gjinden përbrenda trevës së përcaktuar më sipër.

Në lidhje me çështjen e vatrave të shpërnguljes, më e vështirë paraqitet një tjetër rrethanë, ajo që mjaft emra familjesh arbëreshe të Italisë (*Bala, Basta, Borsci, Borscia, Carnesi, Dara, Dorsa, Lala, Licursi, Lopes, Manes, Masaracchia, Matranga, Petta, Schiada, Sciales, Scura, Suli, Vari-boda* etj.) na shfaqen edhe në krahina të ndryshme të Moresë, si emra vendesh që kanë qenë shqiptare dikur ose që janë dhe sot e kësaj dite. Emra qytetesh dhe katundesh të Moresë si *Nauplia, Karon, Mothon, Misistra*, na dalin dhe nëpër këngët popullore të arbëreshëve t'Italisë, dhe kujtimi i atij vendi ka gjetur jehonë edhe në këngën e Moresë së bukur (*O e bukura Moré*), që këndohej shumë dikur në ato anë. Shumica e emrave familjarë të arbëreshëve t'Italisë, sikundër mund të shihet nga një vështrim i veprave të K. Sathasit, gjinden edhe në *Moré*, veçse nuk është vendi që të përmenden këtu. Në këto rrethana shtrohet pyetja: Bartësit e këtyre emrave familjarë a erdhën në Itali prej atdheut mëmë, prej Shqipërisë, apo prej Moreje? Përgjegjja për këtë është e vështirë. Sidoqoftë, tregimet historike që flasin për shtektimë shqiptarësh prej Moreje për në Itali gjejnë një mbështesë në emrat vetiake që ruhen në ato anë. Po ndërkaq do pasur parasysh që visari i emrave topikë e familjarë që kanë të përbashkët elementi shqiptar i Greqisë dhe ai i Italisë, në thelb e ka burimin tek e njëjta vatrë, në trevën e atdheut mëmë që u përkufizua më sipër.

Më në fund, për hir të plotësisë, do të shënohet që edhe shpërngulja e disa elementeve gege në Itali, e cila vërtetohet

dhe me anë të traditës gojore si dhe me dëshmitë historike e dialektike, pasqyrohet edhe në onomastikë. Në Shqipëri të Mesme e Veriore shpjen disa emra fisesh e familjesh, përveç *Castriota* e *Scura* edhe *Cadicamo*, *Chetta*, *Gazullus*, *Gramsci*, *Manes* (*Mánëza* në Shqipëri), *Mates*, *Miracco*, *Musacchi* (*Muzhaqi*), *Plescìa*, *Polisi*, *Rada*, *Renes*, *Riolo*, si dhe disa emra visesh, si *Valkál* e *Prroi i Shtogut* të «Kënka e sprasme e Balës» e Gavril Darës prej Siqelie. Edhe regjistrat kishtarë përmbajnë ndonjë të dhënë për ardhës prej visesh më verriake. Kështu në «*Libro die matrimoni*» që ruhet në kryekishën e Piana degli Albanesit gjindet shënimi *Martino Cuccia greco albanese venuto di Albania della città di Croia con Francisca v.d. (vedova) relita del quond. Gasparo Cuccia di questa terra a di 28 Gennaio 1628.*

Sikundër shihet nga kjo paraqitje nevojisht e përmbledhur, në lëvizjen shtektare të elementit shqiptar për në Itali, pasqyrohet një pjesë e historisë shqiptare të mesjetës së vonë, e cila është me rëndësi edhe për vendet e tjera të Gadhullit Ballkanik. Çështja e burimit më të ngushtë të ngulimeve që u përfatuan nga kjo lëvizje, në thelb është një çështje e metodës shkencore. Mund të shpresohet që me një bashkim e lidhje të drejtë të rezultateve që janë arritur në fusha të ndryshme dhe një veçim e dallim më të mirë të shtresave, në këtë çështje do të mbërrihet me kohë në një qartësi më të madhe.

SHQIPTARËT NË ITALI TË MESME DHE NË NAPOLI

Në provincat italiane në breg të Adriatikut shqiptarët shfaqen të përzier me elemente sllave. Në Rekanati në Market përmenden shqiptarë që më 1437, siç mund të shohim nga ekstraktet e Leopardit të ri prej arkivave të vendlindjes së tij. Në vitin 1451 «si trattò di adattare qualche misura contro gli Albanesi, attesa la loro malignità, e fu risoluto che venissero tutti descritti, e avessero un mese di tempo a prendere impiego o servizio. Allo spirare del mese sloggiassero tutti dal nostro territorio accettuati i maestri d'arte e li battuali a famuli dei cittadini e degli altri abitatori». — Më 18 janar 1456 Këshilli i qytetit të Rekanatit vendos, për të evituar sa të ish e mundër pestën, kolerën, që të mos pranohen shqiptarë e sllavë dhe zbohen ata që kanë ardhur që më Krishtlindje... Në qershor 1460 nga shkaku i plasjes së re të kolerës merren masa të ra kundër sllavëve, të cilëvet u atribuohet shtimi i infeksioneve. Më 1478 «agli Schiavoni ed Albanesi fu proibito d'immischiarsi in alcune funzioni nelle fraternità dei cittadini». Në qershor 1479 «essendovi nuovi sospetti di peste, si adattarono varie misure e venne decretato che in caso di contagio la Fraternità degli Albanesi vistarebbe e seppellirebbe gli albanesi, quella degli Schiavoni gli Schiavoni, e l'una e l'altra gli Italiani». Në gjithë atë vit «... superfacto morbi evitandi fiat bannum quod nemo audeat receptare aliquem sclavum negue albanum... Eligatur et constituatur locus extra civitatem ad quem omnes Sclaviet Albani morbo infecti in civitate Recanati deferantur». ¹⁾ Në qytetin tregtar Ancona shqiptarët përmenden për herë të parë dhe të vetme në vitin 1458: «Quoniam Albanenses viri sanguinei sunt et malig-

1) Thalloczy, Archiv für slav. Philol. 27.82 vv.

nantis nature omnes, a quibus tamquam a furiosis gladiis au-
fugendum est». 1) Si në Veneti, ashtu edhe këtu në Market
kjo pjesë e hollë dhe e pavjefshme shqiptaro-sllave u shkri
në popullatën autoktone. Kështu ka ngjarë dhe me Dukagji-
nët, që ikën prej turqvet në Market dhe pasuesit e të cilëve
u shuan në shekullin e 17-të²⁾. Vendësisht dhe kohësisht jo
larg nga këta grumbuj në qytetin Urbino shquhet familja bu-
jare shqiptare Lazj, dhe në të sidomos vëllezërit Gjergj, Fi-
lip dhe Andrea me vepra luftare. Më vonë e ndërron emrin
në Albani. Prej saj rrjedh Giovanni Francesco Albani, i cili
hipën si Klement XI (1700-21) fronin.

Edhe Latiumi ka pasur dikur kolonistë shqiptarë. Në ka-
tundthini tani krejt italian Pianiano afër Caninos në pron-
vincën e Romës u vendosën prej Papës në shekullin e 18-të
familje shqiptare, të cilat nën kryesinë e rektorit trim Don
Simone, erdhën e kërkuan këtu strehë prej tiranisë osmane.
Shqiptarët një pjesë të tokës së tyre e quajtën «Piana di Don
Simone» për kujtim të kryetarit të adhuruar. Legjenda e
lë të dalë në dritë hëne dhe të ndejë petkun e tij mbi gjin-
djen e tij të dashur.³⁾ Pas Princit Lucian Bonaparte gjer në
vitin 1885 rronin këtu fjalë si buk, mish, rrush dhe ca të tjera.
— Të tjera grupe familjesh vendosen të përndara në pika të
ndryshme të provincës së Romës. Më të njohur janë kolonis-
tët e qytetit Genazzano⁴⁾, në kishën e të cilit nderohet edhe
fytyra e famshme e Mërisë, që gojëdhëna e bën të ardhur
prej Shkodre.

Por pjesa më e madhe e rrymës mërgimtare shqiptare u
derdh, pas shtypjes së Shqipërisë dhe së Moresë, në mbre-
tërinë e Napolit. Sunduesit e kësaj i favorizuan ata edhe për
të ripopulluar krahinat italiane jugore të shkatërruara prej
tërmetit të madh të vitit 1456 edhe për të përdorur në luftë
këtë popull të zotë ushtarësh. Rrogëtarë (mercenarë) shqip-
tarë prej Shqipërie dhe prej Greqie e Italie shërbenin shpesh
nën flamuj spanjollë-napolitanë. Meqë mjeshtëria që u për-
shtatej më tepër shqiptarëve ishte ajo e luftës, kish përherë
kompanji rrogëtarësh në mbretëri. Karli V i përdor me sukses.

1) Makusev, Monumenta historica Slavorum Meridionalium I 204.

2) Hopf, Chroniques Gréco-Romanes 334; Illyrisch-alb. Forsch. I 84.

3) Princ Lucian Bonaparte, Transactions of the Philol. soc. 1884, f. 492 vv.

4) Notizia distinta dell'Italo-Greci, e dell'Italo-Albanesi esposta da Mons.
Giuseppe Schirò... » Roma e l'Oriente» VII 344.

Historiani i asaj kohe Paulus Jovius përmend Demetrius Capuzzimadio (Kryemadh ose Kësulëmadh). Chiucchiaro, Theodor Biscari, kapetanë të kavalerisë shqiptare, që luftuan në soldin e Imperatorit. Pas ardhjes së tyre në Itali një numër i madh shqiptarësh u bënë pas zakonisht të atëhershëm chëfë bandash aventuriere. Jovius përmend Musacchion, një kapetan trim e plak, dhe *éclaireurs*-t e tij, kavaleri e lehtë shqiptare, 500 veta që i printe Nicola Masi¹): «Galeatorum vero equitum numerus, et pilcatorum. epirotici generis levioris armaturae, qui erant peltati, quingentiu summan implebant. His praeerat Nicolaus Maisius a Nauplio Peloponnesiaco vir egregie fortis cui Pellodro-epirotica lingua cognomen fuit».²) Në luftën hispano-holandeze lozin një rol të madh Epirotarum equites në soldin spanjoll. Equitatus ex Hispanis, Itali- que et Epirotis conflatus lëftojnë më 1567 ndënë të birin e Dukës d'Alba.³) Në një ndeshje të vitit pasues «inclinare in- terea videbatur turba Epirotarum, capto Georgia Crescia eo- rum ductore animosius in hostem invecto».

Në një fushatë të vitit 1580 tregohet se si Nicolaus Basta, et Georgius Cariseus Epirotarum ductores per eundem addi- tum irrumpunt.⁴) Karli III i Bourbonit themeloi regjimentin mbretëror maqedonas (Reggimento Real Macedone), që për- bëhej vetëm prej shqiptarësh, i cili ka luaitur gjithnjë një rol kryesor. Në luftën e suksesionit të Austrisë këta rrögëtarë u shquan në fushatat e Velletrit (1744) dhe të Guastallas (1746)⁵). Nga mbarimi i shekullit të 18-të kjo gardë u quajt Reggimento Albanese: në vitin 1812 u shpërnda.

Pas vdekjes së Skënderbeut e veja e tij gjen bujari në Napoli: «con lei andaro altre Signore vedove, che loro mariti erano morti in quella guerra de Turchi».⁶) Këtu ikën dhe Princi i Tomoricës në Shqipëri të Mesme Gjon Muzaka, të të cilit «Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi» (1510) e ka botuar Karl Hopfi në veprën e tij «Chroniques Gréco-Romanes»: «Io Don Giovanni Molosacchi Despoto d'Epi- ro, essendo discacciato per il Turco fora de mia casa et pri-

1) Masit rrojnë edhe sot në Mezzojuoso në Siqeli.

2) Famiani Stradae Romani e societate Iesu De Bello Belgico Decas Prima Ab Excessu Caroli V. Imperatoris, Roma 1632, I, 211.

3) Id.

4) Id. 116 v.

5) Rodotà, Dell'origine del Rito Greco in Italia, III 30 vv.

6) Hopf, Chroniques 334.

vato de detto stato (1476), pervenni nel Regno di Napoli, dove la memoria del Re Ferrante vecchio d'Aragona me provedette del vitto mio e de mia casa, con provisione d'augmentarme et darne la terra d'Apice et le altre cose, oltre d'havere accettati noi in suo corte... Ma fando poi pace Venetiani col Turco, furno forzati fuggir tutti, et il detto Mosacchi venne al Ré di Napoli, li Bassi in Ungaria, altri in Venetia, li Ducaguini in la Maeca d'Ancona». Të tre bijtë e Muzakut pas vdekjes së tij u kthyen sërish në Shqipëri.¹⁾ Provizorisht si ata qëndron që më 1455 bujari i ri i Gjinokastrës Zenevissi në dorë të Napolit. Në këtë qytet si dhe në Lecce, Messina, Reggio Calabria dhe Brindisi vendosen shqiptarë prej Greqie bashkë me tregëtarë grekë²⁾.

Përveç Napolit që Kampanja pjellore dhe Principato Ulteriore (Provinca e Avellinos), që i tërhoqën kolonistët për qëndrim të përhershëm. Në vitin 1941 takojmë shqiptarë dhe sllavë në qytetin Ariano afër Avellinos: «Albanisi et Scavuni abitanti in questa Cita si hanno optenute... provisioni in modo habiano ad contribuire a li pagamenti secondo li altri cittadini secondo loro facultati³⁾. Këta kalonistë duket të kenë qenë subjekte turbulente, se në një kërkesë të popullsisë së qytetit Dukës së tyre Ferrante Gonzaga «item se supplica atteso multi Albanesi, Schauuni, et altri cittadini reponeno vini e frutti senza che abbiano vigne, e molti Citadini se ritrovano continuamente dannificati, et arrobati in le loro possessione... e li tristi siano castigati⁴⁾.

Pas Francesco Pansas⁵⁾ dhe Matteo Cameras⁶⁾ rryma mërgimtare shqiptare ka arritur dhe qytetin e vjetër tregtar Amalfi. Një nip i Skënderbeut, dhe ky me emër Georg Kastrioti, u vendos këtu me familjen më 1498 dhe u bë visartar i Dukës të këtij qyteti Alfons I. Piccolomini. Në vitin 1505 ngrehu për vete dhe për pasuesit e tij një kapelë bujarishte në Domin della B. Vergine della Pietà. me vendvarrosje të vet; mbi të një inskripcion dhe mbi këtë një shqiponjë me

1) Hopf, 532.

2) «Roma e l'«Oriente». VII 341. Vr. 1.

3) Tommaso Vitale, Storia della regia città di Ariano e sua diocesi, Romë 1794. f. 408.

4) Id. 423.

5) Istoria dell'antica Repubblica di Amalfi. Napoli, 1724, f. 225.

6) Memorie storico-diplomatiche dell'antica Città e Ducato di Amalfi. Salerno 1876, f. 626 Vr.

dy krera dhe me kurora mbi to dhe në kraharor mburonjën me emblemat e Kastriotëve.¹⁾ Një Antonio Castriota theme-
loi këtu në vitin 1516 kishën dello Spedaletto. Po prej këtij
viti përmendet një Amalphiae Magnificus Dominus Georgius
Castriota procurator Monasterij. S. Laurenti.²⁾ Në shekullin e
17-të duket që dega amalfitane e Kastriotëve të jetë shuar.
Në vitin 1625 përmendet për herë të fundit një Kastriot, ka-
noniku Andrea, vdekjen e të cilit e mësojmë në këtë vit.³⁾

1) GEORGIUS CASTRIOTA VIR INTEGER CAESAREA COGNATIO-
NE, MORUM CANDORE CLARUS, SIBI POSTERISQUE SUIS VIVENS
FECIT MDVI.

2) Pansa, ibd., Notamentum Instrumentorum in Pergameno in Archivio
reverendissimi Capituli Archiepiscopatus Amalphiae.

3) viti 1939.

DISA BURRA TË SHQUAR TË ARBËRESHËVE TË ITALISË

NIKOLLË KETA

Nikollë (Kolë) Keta lindi më 1742 në katundin Kuntisa (Constessa Entellina), ngulim arbëresh në krahinë të Palermos në Siqeli, dhe vdiq në këtë qytet më 1803.

Studimet i kreu në Seminarin arbëresh të Palermos, të themeluar në vitin 1734 prej Gjergj Guzetës. Ky Seminar u bë, sidomos në shekullin e kaluar, një vatër e kulturës shqiptare, ku u shkolluan një varg burrash të shquar, si Zef Krispi, dy Darajt, Zef Skiroi, Pal Skiroi e të tjerë.

Përveçse si poet, Nikollë Keta shquhet sidomos edhe si dijetar, si një gjurmues i palodhur i historisë, i gjuhës, i dokeve e zakoneve e përgjithësisht i trashëgimisë kulturore të arbëreshëve të Italisë, veçanërisht të Siqelisë. Si poet ai është autori i një poemthi prej 76 stancash (oktavash) mbi krijimin e botës. Emri i tij ndërkaq është i lidhur më fort me disa vepra shkencore, të cilat presin ende që të botohen. Ndër veptrat me karakter gjuhësor hyn aty një fjalor mjaft i madh italisht-shqip, me rëndësi për studimin e arbërishtes së Italisë dhe për historinë e leksikut të shqipes. Megjithëse hartuar në një periudë para themelimit të gjuhësisë si dije më vete, nuk është pa interes edhe dorëshkrimi «Etimologjiku i gjuhës shqipe», ndonëse përmban shumë vërejtje me frymë të kaluar. Vepra historike e Ketës «Lajme mbi makedonët», shkruar italisht me titullin «Notizie su dei Macedoni» më 1777. dhe mbetur dorëshkrim ashtu si shkrimet e tjera të tijat, është me vlerë të veçantë dhe sot e kësaj dite, gati dyqind vjet pas hartimit të saj. Në këtë vepër bëhet një studim i thelluar i historisë së ngulimeve arbëreshe të Siqelisë dhe i çështjes së prejardhjes së tyre. Në hetimin e kësaj çështjeje aty merren në shqyrtim, me një metodë gjurmimi thuasje moderne, të dhënat e historisë, të dokeve e zakoneve, të gjuhës e të toponomastikës të këtyre katundeve arbëreshe, duke kaluar kështu caqet kur u hartua kjo vepër.

DHIMITËR KAMARDA

Gjuhëtari arbëresh Dhimitër Kamarda lindi më 1821 në Piana degli Albanesi (sot Hora e t'Arbëreshvet), ngulim arbëresh në Siqeli, dhe vdiq në Livorno më 1882.

Kamarda u muar gjithë jetën e tij me studimin e gjuhës shqipe. Ai është autori i veprës «Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese», botuar në Livorno më 1864. Dy vjet më vonë doli në Prato bleu i dytë i kësaj vepre, «Appendice al Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese». Në veprën e tij Kamarda na paraqitet si një nga përfaqësuesit e teorisë, e përhapur sidomos në atë kohë, sipas së cilës shqipja u afruaka më fort me «çiftin pellazgjik» latinishten e greqishten, po sipas tij më fort me greqishten. Kjo veprë, megjithëse në shumë pjesë është e vjetëruar, si fryti i një studimi të gjatë të gjuhës shqipe, mund të përdoret me dobi të madhe dhe sot e kësaj dite. Përveç materialeve të vlefshme nga visari gjuhësor i arbëreshëve të Italisë, ka në të një tok vërejtjesh me vend rreth gramatikës dhe etimologjisë së shqipes, të cilat meritojnë të vlerësohen.

Bleu i dytë i veprës së tij, «Appendice,» është një antologji e poezisë popullore shqiptare. Këngët që i përkasin Shqipërisë shumica janë marrë nga vepra e Hahnit, ato të Greqisë prej veprës së Reinholdit. Më rëndësi kanë këngët popullore të ngulimeve arbëreshe të Kalabrisë e të Siqelisë, ku jepen shumë pjesë për herë të parë. Veprës i prin një hyrje e gjatë, me vërejtje interesante rreth poezisë popullore shqiptare, në lidhje edhe me poezinë popullore ballkanike.

Në lëvizjen mendore të arbëreshëve të Italisë në shekullin e kaluar, që synonte në ringjalljen kulturore të atyre ngulimeve e në përtëritjen nacionale të Shqipërisë vetë, ky burrë zë një vend me rëndësi kryesisht në fushën e studimeve gjuhësore.

VINÇENS DORSA

Vinçens Dorsa lindi më 1823 në katundin Frashineto (Fransit) të Kalabrisë, krahinat e Kozencës, ngulim arbëresh i shekullit XV. Vdiq më 1885.

Dorsa ka qenë një studiues i flaktë i gjuhës së tij amtare dhe një njohës i mirë i greqishtes. Në veprën «Sugli albanesi — ricerche e pensieri», botuar më 1847, që ndahet

në 20 kapituj, rrihen shumë anë të historisë e të kulturës shqiptare: fatet e lashta historike, historia e ngulimeve të Italisë dhe e seminareve të tyre bashkë me burrat e shquar që kanë dalë prej sosh, misioni luftarak e kulturor i shqiptarëve, gjuha, poezia popullore, literatura, doket e zakonet. Për shqipen e Italisë, veçanërisht të Kalabrisë, është me vlerë edhe libri i tij «Studi etimologici sulla lingua albanese messa a confronto colla greca e la latina», botuar më 1862. Dorsa përktheu në dialektin e vet edhe Ungjillin e Mateut, ashtu siç e përktheu Zef Kamarda në dialekt të Pianës. Kjo vepër, që u botua në Londër më 1869, ka rëndësi si një dokument i ligjërrimit shqip të Kalabrisë.

Dorsa njihet edhe si grecist i mirë. Vepra e tij «La tradizione greco-latina nei dialetti della Calabria citeriore» përmban lëndë të dobishme për të folmet greke të Kalabrisë Jugore, dhe citohet edhe sot prej gjuhëtarëve. Përkundrazi, vepra tjetër «La tradizione greco-latino negli usi e nelle credenze popolari della Calabria» përmban lëndë folklorike.

Ndër arbëreshët e Italisë që janë marrë me problemet e gjuhësisë, historisë e etnografisë të katundeve të tyre, Vincens Dorsa zë një vend nderi. Ai vërtet nuk u shty në lëmin e kërkimeve krahasimtare si Kamarda, por duke mbetur brenda mjedisit të ngushtë të ngulimeve të Kalabrisë, ka qenë një gjurmues i mirë i vjetërsive të tyre. Shkrimet e tij mbeten kështu edhe studime me vlerë, edhe dëshmi e sigurt e jetës dhe e gjuhës shqipe të atyre ngulimeve për shekullin e kaluar. Një meritë e veçantë i bie këtij burri të shquar për punën që bëri në mbledhjen e këngëve popullore arbëreshe të Kalabrisë. Këto ai nuk i botoi vetë, po një pjesë ia dha Kamardës, i cili i ka botuar në bleun e dytë të veprës së tij. Puna që ka kryer Dorsa në mbledhjen e poezisë popullore mbetet ende për të studiuar.

MIKELE MARKIANOI

Ky gjuhëtar e letrar lindi në Makje, vendlindja dhe e De Radës, dhe kaloi pothuaj gjithë jetën si profesor liceu në Foggio, ku edhe vdiq.

I frymëzuar me ndjenja shqiptare të thjeshta, Markiano i punoi, pa u lodhur, për njohjen e veprimtarisë letrare të arbëreshëve. Ai qiti në dritë shumë vepra të vjetra e të reja dhe i botoi. Ndër shkrimet e vjetra do të përmendim në ra-

dhë të parë zbulimin dhe botimin e vjershave të Nikollë Filjas e të Nikollë Brankatit, shkrimtarë prej Siqelie, të shekullit XVIII. Këto vjersha Markiano i zbuloi në një kodik dorëshkrim dhe i botoi më 1908 me titullin «Poesie sacre albanesi». Më 1911 ai nxori në dritë katekizmin e Filjas.

Një meritë e veçantë i bie Markianoit për përhapjen e veprës së De Radës. Ai jep një pamje të përgjithshme të figurës së këtij poeti në librin «L'Albania e l'opera di Girolamo de Rada» botuar më 1902, ku analizohen një nga një edhe veprat e poetit. Një zgjedhje të këtyre ai e botoi italisht në librin «Poemi albanesi di G. de Rada»; Trani 1903.

Markiano i njihet edhe si folklorist. Në librin «Canti popolari albanesi delle colonie d'Italia» ai botoi këngë të moçme popullore të ngulimeve arbëreshe të Italisë, këngë kryesisht epike, me një hyrje historike të gjatë e me shënime. Më 1911 ai botoi disa këngë popullore të ngulimeve të Kapitane të Molizes. Një vështrim të përgjithshëm të literaturës arbëreshe ai e dha në artikullin italisht «Kolonitë arbëreshe të Italisë dhe literatura e tyre». Markiano, si filozof klasik, u mor dhe me literaturën greke. Ai shkroi veprën «Burimi i përrallës greke dhe lidhjet e saj me përrallat orientale».

PAL SKIROI

Te Hora e t'Arbëreshvet (Piana degli Albanesi), djepi i kaq burrave të shquar të elementit arbëresh të Siqelisë, lindi dhe Pal Skiroi, në vitin 1866. Si kreu studimet në Seminarin e Palermos, ushtroi për disa vjet detyrën e profesorit të greqishtes në qytetin Trivento e Bitonto.

Emri i Pal Skiroit është i lidhur me Mesharin e Gjon Buzukut të vitit 1555. Gjurmët e kësaj më së parës përmendore të shqipes që ne dimë, i gjeti në Seminar të Palermos, ku ruheshin të dhëna rreth një cope të veprës, të cilën ia pat falur dikur Gjon Nikollë Kazazi prej Gjakove Gjergj Guzetës, themeluesit të Seminarit. Dijetari arbëresh punoi rreth tri dhjetë vjet në përpunimin shkencor dhe gatitjen e Mesharit për shtyp. Teksti i Skiroit është i pajisur me vërejtje gjuhësore, me krahasime të formave të Buzukut me ato të së tjerëve autorë të vjetër të Veriut. Për leximin e këtyre formave ai mori në ndihmë sidomos shkrimet e Pjetër Budit, sikundër i ka kumtuar dikur gojarisht shkruarit të këtyre rrethave. Kjo vepër pret edhe sot e gjithë ditën të shohë dritën

e botimit. Vetëm disa pjesë të tekstit të Buzukut arriti autori të botonte më 1932, në bashkëpunim me Gaetano Petrotën, në të përkohshmen «Revista indo-greco-italica» të F. Ribezzos. Nga punimet që ka lënë dorëshkrim do përmendur edhe kthimi i fjalorit të Bardhit të vitit 1635 anasjelltas, d.m.th. shqip-latinisht. Edhe botimi i këtij punimi do të ishte me rëndësi për gjuhësinë.

NILO BORXHA

Nilo Borxha lindi më 1870 në Piana degli Albanesi të Sicelisë dhe vdiq më 1942.

Më 1930 botoi me një koment liturgjik më të vjetrin dokument gjuhësor të toskërishtes, që kishin zbuluar më parë Sp. Lambrosi dhe S. Gassisi në Bibliotekën Ambroziane të Milanos. Ky botim ka titullin *Pericope evangelica in lingua albanese del secolo XIV, da un manoscritto greco della Biblioteca Ambrosiana*. Për datimin e këtij dorëshkrimi të moçëm dijetarët ndahen në mendimet e tyre. Borxha mendon se kemi të bëjmë me përmendoren më të lashtë të shqipes. Lambrosi e zbret hartimin e këtij dokumenti në shekullin XVII. S. Gassisi vërtetoi karakterin e gabuar të këtij datimi, kurse Selaville me Kurillën bashkohen me mendimin e Lambrosit. Edhe Nd. Mjeda u mor me këtë dokument gjuhësor. Merita e Borxhës është në këtë mes që ia bën të njohur këtë tekst të vjetër një publiku më të gjerë.

Një interes të veçantë tregoi ky studiues i palodhur për misionet e arbëreshëve të Italisë në Shqipëri sidomos gjatë shekullit XVII e XVIII. Studimi i gjerë që trajton këto misione u botua në dy pjesë në vitet 1932 (1935) e 1942. Aty janë nxjerrë në dritë dokumente historike të panjohura më parë, me njoftime për Shqipërinë Jugore e sidomos për Himarën, me një sasi të dhënash interesante për jetën popullore dhe etnografinë shqiptare të asaj kohe.

Ky dijetar iu kushtua me interes të gjallë edhe çështjes së formimit dhe të pasurimit të shqipes letrare. Në një artikull botuar në vitin 1927 ai jep këshillën e drejtë që në pasurimin e gjuhës neologjizmat të farkëtohen me masë e me kursim, e më fort të shtihen në përdorim fjalët e moçme të gjuhës duke u dhënë atyre një kuptim të ri.

Borxha e kaloi pothuajse gjithë jetën e tij në Grottaferata afër Romës. Ishte një gjë prekëse të shihje këtë plak

sa interesohej për gjuhën e të parëve dhe për studimin e saj gjer në ditët e fundit të jetës së tij. Me zell të madh gjurmonte nëpër arkiva dokumente që i përkasin Shqipërisë dhe monumentet e vjetra gjuhësore. Gjatë një bisede aty nga viti 1940 ai i kumtoi shkruarit të këtyre rreshtave se kishte zbuluar në arkivat vaticane një dokument gjuhësor shqip të vjetër, më të vjetër se ato që dihen gjer tani. Vdekja mjerisht e ndaloi atë të na jepte të dhëna më konkrete rreth kësaj çështjeje me rëndësi themelore për gjuhësinë shqiptare. Kujtimi i tij do të mbetet i gjallë në lëmin e albanistikës.

MARKO LA PIANA

Me Marko La Pianën (1883-1958), edhe ky një bir i Horës së Arbëreshëve në krahinë të Palermos, mund të thuhet se nis brezi i gjuhëtarëve të mirëfilltë ndër arbëreshët e Italisë, i dijetarëve të rysur me parimet e metodat e gjuhësisë moderne.

La Piana qiti për herë të parë në dritë shkrimin më të vjetër të arbërishtes së Italisë, veprën e Lekë Matrangës të vitit 1592, të cilën e botoi më 1912 në të përkohshmen «Roma e l'Oriente». Duke iu kushtuar gjatë gjithë jetës së tij studimit të shqipes, të historisë së saj dhe të lidhjeve të saj me gjuhët e tjera, ai botoi më 1937 një studim të hapët mbi historinë e zanores o të gjatë në elementet vendëse edhe latine të shqipes. Më rëndësi kanë dy veprat me të njëjtin titull, «Studime gjuhësore shqiptare» I e II (1939-1949), shkruar edhe këto italisht ashtu si studimi i përmendur më sipër. Nga këto e dyta përmban edhe një studim mbi arbërishten e Siqelisë. Vlera e këtyre punimeve më fort se në fushën e fonetikës historike, të historisë gjuhësore e të etimologjisë, qëndron në disa vrojtime të reja e të drejta rreth çështjeve të morfologjisë historike, të cilat shënojnë një përparim në lëmin e studimeve shqiptare. Marko La Piana ka lënë në dorëshkrim një gramatikë historike dhe një fjalor etimologjik të gjuhës shqipe.

Sikundër shihet dhe nga këto pak shënime, prej mjeshtër të arbëreshëve të Italisë nuk kanë dalë vetëm revolucionarë e patriotë, poetë e shkrimtarë, po edhe njerëz të dijes e të studimit. Edhe pse njihen më pak se të parët, si mbledhës, si ruajtës e si gjurmues të pasurive mendore të popullit të tyre, kanë edhe këta një vend nderi në ndër-

tesën e kulturës shqiptare. Nëpër katundet e shpërndara ku flitet arbërisht, dhe nëpër arkiva e biblioteka shtetërore e private, të Evropës e të botës, gjenden një mori dorëshkrimesh shqip me lëndë letrare e shkencore. Ato meritojnë të shkunden nga pluhuri që kanë zënë me kohë dhe të shohin një ditë dritën e botimit, për t'i dhënë ato vetë më dritë ndërtesës së kësaj kulture në fjalë.

NGA LEKSIKU I DIALEKTEVET ARBËRESHE TË KALABRISË*)

Në punimet e tij, që hapin shtigje të reja, që vështtrimin e fjalëve e të sendeve e lidhin në mënyrë shembëllore me studimin historik e të terrenit, në studimin e gjuhëve të Gadi-shullit Apenin dhe Ballkanik Gerhard Rohlfsi ka afruar e përfshirë me të drejtë shpeshherë edhe shqipen. Me të vërtetë, kjo gjuhë, me karakterin e saj të lashtë, me pozitën e saj në një farë mase në mjedis të këtyre dy trevave dhe me degëzimet e saja më një anë nga Greqia, më një anë nga Italia Jugore e Siqelia, si historikisht ashtu dhe gjeografikisht është në gjendje të ndriçojë në një masë të veçantë marrëdhëniet e shumëllojshme të këtyre trevave. Rrethanat gjuhësore paromake të Italisë Jugore dhe mbeturinat e tyre sporadike në dialektet e sotme të asaj ane gjejnë përgjegjëset e tyre në këtë gjuhë. Huazimet dorike-greke veriperëndimore të shqipës me trajtën e tyre pajtojnë pjesërisht me vazhdimet e elementeve dorike të Italisë Jugore, prandaj nuk janë pa rëndësi në punën e çështjes së kontinuitetit (vazhdimësisë) të leksikut grek të vjetër në ato vise. Nga fusha e marrëdhënieve gjuhësore latine-greke të kohës antike dhe nga marrëdhëniet më të vona romane-bizantine të mesjetës janë ruajtur në këtë gjuhë gjurmë të tilla që janë me rëndësi edhe për gjuhët fqinje. Së fundi hyjnë këtu dhe dukuritë e lidhjes gjuhësore ballkanike, të cilat përfshijnë edhe shqipen, dhe — sikundër e ka treguar bash Gerhard Rohlfsi — shtrihen gjer në Italinë Jugore.

Nuk do të hyj këtu në këto çështje e të përpiqem të zbrit

*) Botuar së pari gjermanisht në «Serta romanica». Festschrift für Gerhard Rohlfs zum 75. Geburtstag. 1968, f. 115-124.

ndihmesën (kontributin) e këtij dietari në zgjidhjen e tyre¹⁾, po do t'i sillem një ane tjetër të punës së tij shkencore. Sikundër dihet, Gerhard Rohlfsi në regjistrimet e gjurmimit dialektologjike që pat kryer para shumë vjetësh për veprën «Atlas gjuhësor e material (etnografik) i Italisë e i Zvicrës Jugore» (të Jabergut e Judit) ka përisur dhe një ishull gjuhësor të shqipes, të folmen e Akuaformozës në krahinë të Kozencës në Kalabri (pika 751) dhe ka nxjerrë në dritë një material të pasur. Nga këto regjistrime të kryera me një kujdes e saktësi të rrallë desha të zgjedh këtu disa elemente të leksikut dhe t'i kundroj në lidhjet e tyre të ndërsjellta. Kjo zgjedhje bëhet nga bindja që kam se brenda vështrimit (konceptimit) të gjuhës si element i kulturës popullore nga ana e këtij dietari, leksiku, si dëshmi besnike e zhvillimit material e mendor, zë një vend kryesor në sistemin e gjuhës.

Dialektet e ngulimeve shqiptare të themeluara kryesisht në shekullin XV e XVI, pra në kohën e luftërave të para me turqit, e të shpërndara në Itali Jugore e në Siceli, janë me rëndësi të veçantë për historinë e gjuhës shqipe. Ato më një anë shpiten në një shkallë gjuhësore në të cilën zberthimi dialektikor nuk kishte arritur gjer në të sotmen shkallë gjuhësore. Më anë tjetër ato vazhdojnë të rrojnë si ishuj gjuhësorë me një popullsi tashmë dygjuhëshe, në të cilën shkëputja e gjatë dhe e përgjithmonshme prej trungut të hershëm dhe ndikimi i mjedisit roman që e rrethon kanë çuar në një zhvillim lloji të veçantë. Këto të gjitha pasqyrohen sidomos në leksik. Edhe aty, me ruajtje dhe risime, me lëndë gjuhësore të sjellë dikur me vete, të përfutur në mënyrë të vetësishtme dhe të përvetësuar në atdheun e ri, erdhi e u formua një tip dialektor më vete, i cili nuk është krejt i barabartë me asnjërin nga dialektet e atdheut mëmë. Do t'u shtohen këtyre edhe bjerrjet që kanë ndodhur, nga puna se me ngulimin në një mjedis të ri e mjaft të ndryshëm nga mjedisi i atdheut të moçëm, u hoq dorë prej disa elementesh të mënyrës së hershme të jetesës, të jetës fshatare e të kulturës materiale, të

1) Khs. për këtë vërejtjet tona në Glotta XXV (1936) 50 vv., Studii si cercetări lingvistice X (1959) 4554 vv., Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria shkencat shoqërore XVI (1962) 4 120 v., 137 v., Studia albanica (1964) 172 v., Rendiconti Ist. Lombardo di Scienze e Lettere Vol. 99, 1965, 216 vv., Les problèmes fondamentaux de la linguistique balkanique, Ier Congrès international des études balkaniques et sud-est européennes, Sofia 1966, f. 47 vv.

rregullimit të shtëpisë e të zejeve shtëpiake, të veshjes etj., dhe bashkë me objektet u humbën dhe emërtimet e tyre.

Leksiku shqiptar i këtyre ngulimeve, në të cilin po kufizohem në këtë artikull, në pjesën e tij kryesore rrjedh prej dialekteve mesjetare të vona të toskërishtes jugore që janë folur në anën jugperëndimore të dheut mëmë, dialekte që përbëjnë bazën edhe të shqipes që flitet në Greqi. Aty çojnë në pikëpamje dialektologjike trajta fjalësh si *më merr sish*, *dreq për drejt*, *xerku për xverku*, *fendia* «fëndyelli», *gjishtl'a* «gishtëza» bashkë me *veshl'at* «veshkat», «kryqëzat» (sufiks -lë), *hënza honza* «hëna», *kul'ish* «këlysh», *mbrizim* «mërzim», *ngahër* «përherë», *pishk* «peshk» shm. *pishq*, *i zvagal'isin* «përmih dheun përreth bimëve» etj.; në pikëpamje kohore elementet turke të paka në numër, si *manushaqe*, *masûr* me *hékuri masûrëvet* «çikrik», *sndûqi*, *trokomël* «misër» (në thelb «mel turk»), të cilat bëjnë pjesë në shtresën më të vjetër të huazimeve turke të shqipes. Në arbërishten e Kalabrisë e të viseve të tjera ndërkaq, krahas me këtë shtresë leksiore specifike, relevante më fort për çështjen se nga rrjedhin këto ngulime, përfaqësohet dhe një tjetër shtresë, e cila buron prej një baze më të moçme e më të gjerë e që prandaj është më me rëndësi për historinë e gjuhës. Hyjnë aty ndër të tjera fjalë si *bari dëllit* «gjeth delli», *bars* «shtatzënë, mbarsë; barrse, mbratë», *lopa bonet*, «lopa bohet, do demin», *dorza* «dorëza, tufa», *girdhû* «gërdhu», *greriza* «grerëza», *grtfcî* «laraska», *gjithsëj*, *gjufëza* «gjuhëza, rrumbi i komborës së lopës», *hesët* «ethet» (lopa, dosa), *karoqa* «karroqja», *mrûri* «mëruri i thikës», *rondi* «rrëndësi, rrani, mullëza», *i reshkt* që ka marrë një shije të keqe, që ka marrë të priset (gjalpi, vaji), *i rreshkur*, *shkilqen* «lustron (këpucët)», *shkrëpa* «hime e imtë, miell i përzier me hime», *shura* «rëra», *verrr* «plep i bardhë: verr». Është me interes për historinë e visarit të fjalëve, që elemente leksikore të këtij lloji na shfaqen dhe në shqipen e Greqisë, që në toskërishten vetë përkundrazi paraqiten më shumë sporadikisht, po që më anë tjetër dalin nëpër dialekte të hershme e të sotme të gegërishtes veriore, kështu që mund të quhen fjalë të mbarë gjuhës. Ndër këto elemente, disa, si *krip* «flokë, leshra», *prirem*, *regj* «mbret», *shtûara*, «më këmbë», *tekû* «ku», *tëtim* «mot i ftohtë, ftomë», *inëzót*, «zot, perëndi», *gjellë* me kuptimin «jetë» etj., në mënyrë të shënueshme i kanë të përbashkëta arbërishtja e Italisë (në Kalabri edhe gjetkë) me letërsinë e Veriut të shekullit XVI e XVII, të cilat të dyja janë të trevave anësore ekstreme, «aree

lateralit» në kuptimin e M. Bartolit. Kështu nuk gjan të jetë një gjë e rastit që e diela e luleve në ligjërimet arbëreshe të Kalabrisë quhet «e diela e larit» (e *diela dhafnis*) ashtu si në Veri (e *dielja e larit*), dhe që kumbaria në të dyja trevat dialektore quhet «shëngjon» (pagëzori), në Kalabri *jemi shinjánj* «jemi kumbarë», në malësitë e Veriut *jemi shnjon*. Nuk duket të jemi gabim kur të mendojmë se kemi të bëjmë aty me mbeturina të gjuhës kishtare të moçme të shqipës, e cila mbijetoi te këto fjalë edhe pas dallimeve besimore katolike e ortodokse.

Në dialektet arbëreshe të Kalabrisë janë ruajtur forma të vjetra. Kështu tek emri përdoren ndër të tjera *ballt* edhe *bart* si asnjans, *djepja* dhe *kriqja* si tema konsonantike femërore. Në *asht eshtra*, *derk dirqit*, *kalij kalëz* dallohen mirë njëjësi dhe shumësi; kjo tregon që njëjësit *eshtrë*, *dirk* e *kalëz*, oë përdoren në të tjera vise, janë marrë prej shumësit. Mbi dëshminë e mbiemrit femëror shumës të *rëa* të arbërishtes mund të themi se forma të *ra* që përdoret në ligjërimet e sotme të toskërishtes jugore, ka lindur shumëkund pas shpërnguljes së nguluesve tanë për në Itali. Te përemri pronor u ka ruajtur mashkulloria *tāj* «tuaj», si në *nipt tāj*, formë e trajtuar prej Norbert Joklit (IF 49, 276 shën. 1). sot në atdheun e vjetër e tërhequr mjaft nga përdorimi. Nga fusha e foljes do përmendur sidomos klasa e rasave që mbarojnë me një likuidë. tipi *mbiel*, *tjar*, *vjer* etj. të cilat përkundrejt formave sot letrare *mbjell*, *tjerr*, *vjerr* të Shqipërisë. që për mendimin tim janë formuar pas pjesores. paraqesin një shkallë më të vjetër. Format *väte* «vajti» dhe *kúarin* «ai korr» viden kryekrejet me *vate* e *kurorën* të Gjon Buzukut. Për historinë e foljes *lej lind* dhe përkatësinë e saj në grupin gjerm. *legen* «vë, vendoi» *liegen* «rri ratë, rri», lat. *lectus* «shtrat», gr. *λέχεται* «ai bie të flerë» etj. për mendimin tonë është vendimtare oë kjo fjalë në Kalabri dhe në tjetrën diasporë shqiptare të Italisë, nastai në Greci. në dialektet konservative të dheut mëmë dhe në literaturën e vjetër të kësaj ane. paraqitet si mesopësore *lehem. u lé* «leu, lindi». Ashtu qëndron puna pas gjase dhe me foljen *bij mbii*. oë në këtë të folme të Kalabrisë shfaqet si mesore. *grurt hiket*. Ndër format oë janë në gjendje të sarojnë çështjet e shumta të vecanta të leksikut mund të përmenden *ëvet* «morehin» *ëxa* «tehu i thikës» (e përriithshme është *preh* nga për-eh. *fshiasa* «fshesa», *orffëza* «kakëzoga», *primist* «përmbys», *thëprenët* «thërpehet dhia», që kudo gjetkë është *thërpehet*, *üu*,

«uri,-a», zjarm. Një fjalë si *urdhrfa* «hardhia», në të tjera ligjërimi arbëreshe të Kalabrisë *urdhf*, *dhrf*, në Sqeli pranë saj dhe *urdhf* emri i bimës urth, na tregon se emri i **hardhisë në gjuhën shqipe, ardhí, hardhí, ka lidhje me emrin e urthit, urth, urdh.** Po që ndërkaq në ishuj gjuhësorë kaq larg prej trungut të vjetër, pranë dukurive të ruajtjes dalin edhe risime në forma fjalësh, kjo është gjë që pritet vetvetiu në jetë. Kështu për «urith» në Kalabri thonë *burf*, *buríth*, për «njerith, lilti i prapagojës (në thelb «njeri i vogël») *harithi*, për «dëftón» *buthtón*, për «lemzë, lehmëz» ka *hëlmëzim* «avere il singhiozzo», ku ka ndërhyrë dhe *helm* me rru-gë të një etimologjie popullore. Fjala *nepërkë* e shqipes së përgjithshme këtu na del me formën *nepromptja*, duke iu mbështetur, si duket, *Prende-s*, pas gjase emri i një perëndeshe të lashtë të dashurisë, ku hyjnë dhe, e *premtë* si «dies Veneris» me *Shna Premte*, *Shna Prende*.¹⁾

Jo më pak peshë se format kanë dhe kuptimet me të cilat paraqitën disa fjalë në këto dialekte të largëta. Duke u kufizuar edhe këtu në disa pak shembuj, po përmendim se fjala *petk* shënon cohën a stofin me të cilin priten petkat. *tirqit* shënon pantallonat, dhe se është në përdorim një fjalë *kandūshi* «veste. sottana. fustan grash. kotull», që përndryshe nuk njihet gjetiu. Nga sfera bujqësore, fjala *thúmbeza* përdoret me dy kuptime, «bulë, syth» edhe «kopsë», krejt ashtu si frgj. *bouton*, dhe afërsisht ashtu si në gjermanishten, ku *Knopf* «kopsë» dhe *Knospe* «bulë, syth» janë afri ndërmiet tyre. sh. Kluge-Mitzka botimi i 19-të, f.384. Identiteti i emrit të gjembaçit (ferreckës). *krōfari*, me emrin e përgjithshëm të krehrit (*krahën, krehër*) është me interes për historinë e kësaj fjale. Shprehja *vëte pir vesh* «vete të vjel veshët e rru-shit, it. *racimolare*, frgj. *grappiller*» tregon bashkë me disa të tjera dëshmi që *vesh* shënon një veshak rrush të vogël dhe që pas gjase është një me emrin e organit të dëgjimit. Fjalës *fëlleqë*, që në gjuhën e sotme të grave në toskërishten jugore është një sharje për një grua që s'mban pastër as voten as shtëpinë, një lelë, pra i Kalabrisë, i përgjigjet *fulég* «bishtajë groshe na kokrra; gështenjë fyle, furbë», në Frasinë (Frasinetto) «hedhurinat e krimbit të mëndafshit, bërstitë»

1) Për giurmët etnografike të kësaj perëndeshe dhe për emrat e saj khs. M. Lambertzin, *Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde*, Akad. d. Wissenschaften in Wien, Schriften der Balkankommission, Ling Abteilung XII, 1922, shtylla 48 v.

rrushit, pështymë, këlbazë, lëvore, lëvozhgë¹⁾, e cila me përdorimin konkret që ka, ka ruajtur sigurisht një shkallë më të vjetër. Nga fusha e botës shtazore dhe e blegtorisë, rrethana që *ndirzenj*, «nxis, ndërsej (qenin)» me formën mesore *ndirzenet* do të thotë «(delja) do dashin, ethej», tregon se kjo fjalë gjer më sot ka qenë gënjkuar gabim në punë të historisë e të burimit të saj dhe se përkundrazi është e afër përbrenda gjuhës me *ndez ndizem*. Por foljen *rrëzój*, fjalë me histori ende të paqartë, në këtë dialekt ka *rezón lopt* «lëshon lopët, i lë të dalin (në kullotë)», e cila në Jugun më jugor të trevës gjuhësore të shqipes, në Çamëri, rishfaqet me shprehjen *rrëzój dhëntë* «lëshoj dhentë në kullotë». Emri i zogut *borsi* zborak, avdos, fink, *Fringilla coelebs*, që gjer më sot njihet vetëm për ligjërimet arbëreshe të Kalabrisë, na del dhe në Shqipëri të Mesme, në të folët e qytetit të Krujës *vdorsi*; i përket prandaj emrit *borë*, ashtu si kjo e dyta trajtës dialektore *vdorë*, dhe në formën e brendshme është kështu e krahasueshme me gjerm. *Schneefink* (Shnee «borë»), frgj. *pinson de neige* etj. Emërtimi i thëriave si «ve» (*vét*), bashkë me rrethananë që larvat e insekteve në gjuhën shqipe shpeshherë quhen shkurt «ve», është një mbështesë për mendimin që fjala *vem* «larva leshtore e disa fluturave, e cila dëmton pemët e barishtet», *veme* «vem»; larvë insektesh, larva e një lloji mize që lëshon vezët në mish. oë pështyn mishin» edhe *dhemje* «vem, veme, dhemizë» lidhen me emrin e vesë jo me dhé, si mendohej më parë.

Për karakterin e leksikut të këtyre dialekteve një rëndësi të veçantë kanë ato elemente të cilat — pavarësisht nga çështja nëse janë ruajtje a risim (inovacion) — nëpërmjet të një zhvillimi vetjak të trashëgimisë së siellur me vete prej atdheut të vjetër, me rrugë të ndryshme kanë arritur të bëhen karakteristike për këto dialekte. Aty sidomos për arsye të bjerries së fjalëve (sh. më lart) ka hyrë në veprim zëvendësimi i fjalëve bashkë me emërtime të reja. Kështu p.sh. bimës së kullumbrisë i thonë *móliza* «mollëza», krifës (ieles) së kalit *lesht e xerkut* ose thjesht *aimia*. Emri i kulacit. *kulaci*, ka marrë dhe kuptimin e unazës së poshtme të shtizës së zgjedhës, mbase duke u përzier me *kulár* «dru i lakuar që i pështillet kaut në oafë dhe që e mban te zgjedha». Emri i kakëzogës, *kakëzoza*, ka kaluar si emërtim

1) E. Giordano, «Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë» — «Dizionario degli Albanesi d'Italia», Bari 1963, f. 116.

i karremit, i rrajzës, dhe në vend të tij ka hyrë fjala *grifëza*. Me një bigëzim fjalësh, një «thérapeutique verbale», *bretku* ka mbetur si emërtim i bretkosës, dhe varianti *bretkōsa* ka kaluar si emërtim i thithëlopës. Me rrugë tabuje i janë shmangur emrit të mirëfilltë të hutit. Tyto alba dhe e kanë quajtur këtë zog *keq*. Ndër emrat e shtazëve prej thirrmashe për t'i ndjellë, emra që Gerhard Rohlfsi i ka gjurmuar edhe për shqipen, hyn dhe emri i dirkut (derrkucit), *rikaz*, shm. *rikza-t*, fjalë me burim prej italishtes. Me interes onomasiologjik të veçantë është rrethana që palmjes i thonë «fletëgjër» (*fletgjër*), palcës së bimëve «bukë» (*bukiz*, deminutiv), bletës *ariz mjal'i* «arëz mjalti» ose *miz blete* (khs. frgj. *mouche à miel*), kandrrës Coccinella punctata «kumbarë» (*kumarza*, emër përkëdhelës, hipokoristik, më -zë), ylberit *brezi pjåkavet*, kukllës *nūseza* «nusja e vogël», bukës së parë të mëngjesit *ūdhra*.

Në lidhje me këto duhet shënuar se në gjurmimin historik të këtij leksiku çështja e burimit etimologjik të ndryshëm të elementeve të tij (a fjalë trashëgimie a huazime) për mendimin tonë del në plan të dytë përpara çështjes tjetër se ndër këto elemente — pavarësisht nga burimi i tyre — cilat janë sjellë me vete prej atdheut të vietër, e cilat u shtuan në atdheun e ri, qoftë si huazime, qoftë si formime të reja të përfutuara prej lëndës vetjake. Është e qartë se me njohjen e pamjaftë të leksikut dialektor të shqipës kjo çështje mbetet shpeshherë e pazgjidhur. Megjithatë me një krahasim të brendshëm mund të arrihet në një përfundim të pranueshëm, sidomos sa i përket përpjesëtimimit sasior të ndër-sjelltë të dy pjesëve të leksikut, përpjesëtim i cili natyrisht është i ndryshëm për fushat e ndryshme leksikore. Me anë të një gjurmimi, të kryer para shumë vietëve, të materialit të mbledhur prej këtij dietari, përpjesëtimi është siellë me vete: është marrë a formuar në Itali paracitet afërsisht si vijon: (familja) emrat e farefisit 20 : 3; shkallët e moshës 18 : 2; lindie, dashuri, martesë e vdekje 11 : 3; emri i parë i nierëzve 0 : 5; (trupi i nierit) pjesët e trupit 61 : 9, funksionet e trupit 13 : 0; vetitë trupore 10 : 7; zejet e veprat përkatëse 26 : 35; të hollat e tregtia 3 : 9; numrat të gjitha të sjella me vete: viti, stinat e muajt të gjitha të sjella me vete: ndajfolje kohe e vendi të gjitha të sjella me vete: moti 18 : 5; metalet 5 : 6; mineralet 5 : 1; formime trualli dhe ujë-
ra 8 : 5; (emra shtazësh) gjitarët e egër 5 : 8, rrë-

shqanorët 5 : 0, amfibët 2 : 1, krimbat e molusqet 2 : 2, insektet 16 : 4, zogjtë dhe shpendët 12 : 12; gjahu e peshkimi 7 : 4; pylltaria dhe veglat e druvarit 11 : 12; bimët 37 : 12; gjumi e kujdesi i trupit 19 : 1; sëmundjet e mjekimi 14 : 10; cilësitë morale dhe pasionet (afektet) 16 : 6; (jeta fetare e shoqërore) marrëdhëniet njerëzore 4 : 1, lodrat e argëtimit 8 : 7, veglat muzikore 0 : 2, duhani 1 : 5, shkolla 2 : 5, të kremtet kishtarë 4 : 7, kisha 9 : 5, kleri 2 : 3, kultu kristian dhe besimi 12 : 0, folklori 2 : 2, katundi e tregu 17 : 10; (shtëpia e orenditë shtëpiake) sjellja e ujit 1 : 3, shtëpia e pjesët e saj 7 : 24, mobiljet 6 : 6, ndriçimi 5 : 3, zjarri 10 : 4, vatra e përdorset e vatrës 4 : 2, ngrohja 1 : 1, kuzhina e punët e saj 11 : 0, enët e kuzhinës dhe pajimet e sofrës 15 : 11, gjellët 13 : 10, haja e pija 16 : 4; (blegtoaria, mbajtja e shtazëve të mëdha e të vogla) bagëtia e trashë 28 : 1, bagëtia e imtë 28 : 11, shtazët shtëpiake 10 : 2; pulat 22 : 9, bletaria 6 : 1, krimbi i mëndafshit C : 3; (kullotat e bjeshkia) shtalla 4 : 9, kullotat 7 : 4, punimi i qumështit 13 : 11, qerrja, zgjedhja e pajimet e kafshëve të barrës 10 : 15; (bujqësia) pemët frutore e frutat 28 : 19, vreshtaria e punimi i verës 16 : 17, punimi i vajit 2 : 5, kopshti e perimet 18 : 12, patatet 3 : 0, bari i thatë (sana) 6 : 3, veglat e sanës 6 : 2, ara e livadhe 7 : 3, ujitja e punimi i tokës 10 : 3 drithërat e kultura e drithit 18 : 3 shirja 3 : 1, pastrimi e ruajtja e drithit 10 : 1; kosha e shporta 1 : 2; punimi i kërpit e i lirit 6 : 3; tjerrja e endja 18 : 5 ndërresat e punët e qepjes 15 : 6; petkat e këpucët 22 : 11, mbiemra 9 : 1, emrat e ngjyrave të gjitha të sjella me vete. Sikundër shihet nga kjo llogari e përmbledhur, që nuk shteron kurrsesi materialin, po që megjithatë përfshin pjesën më të madhe të leksikut, në jetën fshatare të këtij ishulli gjuhësor edhe pas pesë shekujsh mbizotëron përgjithësisht leksiku i sjellur prej atdheut të vjetër, dhe një gjë e tillë mund të thuhet dhe për të tjerat ligjëtime arbëreshe të krahinës së Kozencës. Në këtë mes janë lënë jashtë disa formime hibride, disa rasa të dyshimta, si p.sh. fjalët romane edhe greke që janë të njëllorja në Shqipëri e në Itali Jugore. Huazime greke të këtij lloji janë p.sh. *manganisin* «shtupim kërpin, lirin», sesklja «pazia, panxhari», *sirku* «krimb i mëndafshit», *sporëa* «lehe, vullâ, postat», *vasilikó* «borzilok». Ndër të tjera elemente të dyshimta nga kjo pikëpamje, e karakteristike për këtë dialekt, mund të përmendim edhe *barka'arta* «në kokërr të shpinës», *bubaleshi* emër shakaje (ofiq) i korbit nëpër këngë (*lesh*), *forriçka* «dry a man-

dall druri i vogël për të mbyllur dritare, dyer etj., it. la nottola», në të tjerat ligjëtime arbëreshe të Kalabrisë *ferckëz*, *fërrtiç* (Giordano 110), *grikmádh* «grykës i madh, llupës, gopçar», *gjufggjata* «grua llafazane, llaptore», *hret* «mjauillin», *nëmëren* «shan», *opnút* «almise bujqësore», *piçka* shm. «prençka, puçra që dalin verës në fytyrë», *pillíkáčç* «lakuriq», *pín-gula* «kukaçefas, fshehot», *skróqula vës* «lëvozhga e vesë», *shkerdet* «bujashkat e dërrasës kur e zdrugojnë», *tricka* «shilarësi, shregulla», *thíkza* «brisk xhepi».

Ky vështrim i përmbledhur i leksikut arbëresh të Kalabrisë, i kufizuar, si u tha dhe më lart, në pjesën shqipe të tij, do të dilte në njëanshëm po mos të ndiqej shkurt edhe ndikimi i mjedisit rrethues roman së paku nëpër rrugët e tij të tërthorta. Këtu në vend të parë hyjnë kalket në vështrimin e tyre më të gjerë, duke përfshirë aty sidomos huazimet përkthim dhe kalket kuptimore. Kështu, p.sh., me gjasë pas gjedhes së çiftit leksikor *cane: cagna* të italishtes, krahas *qen-it* është formuar dhe femërorja e nocionit *qene* «bushtër, shakë», e cila në atdheun mëmë jeton kryesisht me kuptim të figurshëm. Krejt formim i ri është emri i zogut *regjëthi* «çerri, ferrci», i cili si «mbret i vogël» (*regj-th*) u ngjit pas *reattino-s* së italishtes dhe emërtimeve përkatëse dialektore të saj. Më të shumtat janë kalket kuptimore, pra ato rasa ku disa fjalë edhe forma të shqipes, duke ruajtur zakonisht kuptimin e vet, kanë marrë edhe një kuptim të ri. Kështu p.sh. *shpia*, pas kalabrishtes *o kāsa*, përdoret edhe për «guaskë kërmilli», *shpátula* pas kalabrez. *spátula* edhe për «nënbishte», *dósa* edhe për «prostitutë», khs. it. *troia*, it. veriore *porca*, it. e mesme *na mayalina* të gjitha këto me të dyja kuptimet. Ashtu edhe gjel i *egir* shënon dhe pikthin, qukapikun, me gjasë pas gjedhes së kalabrez. *galluc* i *muntan* «pikth» (:«gjel mali»); *vjersh* «vjershë» në Siqeli ka marrë edhe vështrimin «mënyrë», pas it. *verso* në shprehjen *per questo verso* «në këtë drejtim, me këtë mënyrë». Për një dardhë të ndulkët thonë një *dardhë e shkuar*, pas kalabrez. *un pres pasa* (it. letrare *uva passa* «rrush i thatë»), që u muar sikur të ishte «*dardhë e shkuar*», për *bart* e *lik* mbase pas it. *malerba*: për «i ndaj sisën foshnjes e zvjerdh» i *nciar sisin*, pas kalabrez. *liva la minna*; për «pjata është e panisur», *taluri osht i tër*, pas it. *é intero*. Veçse disa emra zogish si *bishtekuqja* «bishtkuqi» e *bishtgjata* bishtatundës, delmere», mbi dëshminë e emërtimeve të njëllojta në dheun mëmë, nuk duhet të jenë formuar medoemos pas la *kuð arussa* e *kuð alonga* të dialek-

teve kalabreze.¹ Po kjo gjë vlen dhe për disa rasa si *vëshëza* «veshëza e parmendës, llapari» (it. *l'orecchio dell'aratro*), shgjedza «shigjeta, mëqiku i vegjve», mbjedh «mbledh fijen e indit të pëlhurës», *mezdi* etj., të cilat, me gjithë praninë e *a riccedda, a sayitta, koggγ e mezzodí* të mjedisit roman, duket të kenë qenë sjellë me vete prej atdheut të vjetër. Me përkthime të këtij lloji ka pësuar ndryshime edhe sistemi i formave gramatikore (sidomos sistemi foljor), të cilat për dialektet arbëreshe të Molizes i ka vënë në dukje Maximilian Lamberti. Kështu në arbërishten e Kalabrisë për it. *bisogna che si vestano* «duhet të vishen» thonë *kan veshen*, pas kalabrez, *sana vësty*. Forma si kjo lidhen në një fushë më të ngushtë me çështjen e përfuturit të kohës së ardhme me *kam* në arbërishten e Italisë e përgjithësisht në shqipen, si dhe në gjuhët e dialektet e tjera të Gadishullit Apenin jugor dhe të Gadishullit Ballkanik, një çështje që Gerhard Rohlfsi e ka hetuar edhe këtë mbi një bazë historike të gjerë. Në kundërshtim me këto, për shprehjen e tipit *jée e fjoo* «ti po fle», it. *dormi già, u jam e t e jap* jam duke ta dhënë, po ta jap, it. *io sto dandotelo, frgj, je suis en train de te le donner*, *isht e bun te tirku* «sta facendo la calza, (ajo) është duke thurur çorapë» të arbërishtes së Kalabrisë e të Siqelisë, mendimi i një ndikimi italian sto + përcjellore²) vështirë të pajtohet me faktet: struktura aty dhe këtu është e ndryshme, më një-rën anë parataksa ballkanike, më anën tjetër hipotaksa e gjuhëve romane perëndimore. — Të shumta janë më në fund në këta ishuj gjuhësorë, ashtu edhe pritet të jenë, emërtimet dhe shprehjet dygjymtyrëshe hibride, gjysmë shqip, gjysmë italisht, si *dega furkút* «dega bigë», *lōku shtrātīt* «dhoma e gjumit», *mura dirq* «tufa e derrave» (kalabrez. *á muerra*), *mer adūr* «merr erë», *i vjen mīnu* «i bien të fikët, të pakët» (pas *viní mīnu*), *dōpu ngrōn* «pas buket», pas *doppγ mang'āty* etj.

Sikundër po tregon kjo sprovë, një krahasim i formës gjuhësore të shqipes që jeton në dheun mëmë, me formën e shpërngulur lashtërisht në Itali, çon në rezultate interesante, sidomos në lidhje me ç'u ruajt në të dyja brigjet, këtu edhe atje, në lidhje me ç'u ka ruajtur në atdheun e vjetër e

1) Për emrat e bishtatundësit në gjuhën shqipe khs. C. Tagliavini. *Revue internationale des études balkanique I* (1934) 165 vv:

2) E. P. Hamp, «Ier Congrès International des études balkaniques et sud-est européennes», Sofia 1966, f. 666.

NGULIMET SHQIPTARE NË ITALI DHE GJUHA E TYRE

I

Në fushën e studimeve shqiptare ngulimet e përhapura në Greqi, Itali jugore e Siqeli, për vjetërsinë e themelimit të tyre e për shkëputjen e hershme nga trangu i përbashkët, janë me rëndësi si për historianin ashtu dhe për etnografin e onomastin. Po janë në mënyrë të veçantë edhe për gjuhëtarin, i cili gjen në dialektet e tyre gjurmët e një faze të përparme të shqipes dhe mund ta rindërtojë gjer diku këtë me anën e atyre.

Shtegtimi në masë i elementit shqiptar për në Itali nisi e u kthye në pjesën më të madhe gjatë shekullit të 15-të, një nga epokat më dramatike të historisë së Shqipërisë, kur populli nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit luftoi luftën e pabarabartë kundër pushtuesvet osmanë. Sidomos pas vdekjes së këtij heroi e pas pushtimit të vendit shumë gjind parapëlqyen një ekzistencë qoftë dhe të pasigurtë në dhe të huaj nga zgjedha e pushtuesit në atdhenë e parë.

Shpërngulja dhe vendosja e këtij elementi etnik janë kryer në dritë të plotë të historisë dhe kanë qenë trajtuar në plot studime të veçanta. Megjithatë gjer më sot kanë mbetur të pasqaruara nga shumë anë, bile dhe në disa pika kryesore. Arsyet për këtë gjendje janë të ndryshme. Më një anë sidomos për rrethanat e shpërnguljes mungojnë dokumente nga dheu mëmë, po të lëmë mënjanë traditën gojore. Më anë tjetër për vendosjen në atdheun e ri arkivat e mëdha dhe arkivat krahinore e lokale të Italisë për një pjesë të madhe nuk dihen ose nuk janë shfrytëzuar në masën e duhur. Më anë tjetër edhe interpretimi i dokumenteve të ditura shumë herë nuk ka qenë objektiv nga pikëpamja shkencore. Nga

dokumentet që përmbajnë privilegje për banorët e këtyre ngulimeve ka shumë që janë kopje të mëpastajme ose që janë hartuar më vonë. Gjithsesi dokumentet që janë presin një shqyrtim për nga ana e vlerës burimore e autenticitetit të tyre.

Shftegtimi shqiptar në Itali nuk është kryer përnjëheret, po me disa valë të ndryshme, të cilat shkojnë afërsisht prej mesit të shekullit të 15-të gjer aty nga viti 1744, kur u themelua Villa Badessa në Abrucet. Duke kaluar disa grupe sporadike që shfaqen atje në vjetet 1272, 1388, 1393 etj., si valë të parë do të përmendim një tufë të shpërngulurish të vitit 1442. Një tjetër valë na del në qytetin Ankona (1458) e një tjetër në qytetin e afërt Rekanati (1479), kjo e dyta diktuar nga poeti Giacomo Leopardi.⁴⁾ Për vitin 1461 kolonistë shqiptarë dëshmohen bashkë me sllavë dhe në Castelluccio dei Sauri në Apuli veriore. Në një letër të vitit 1467 thuhet ndër të tjera «fra l'altri Albanesi quali so passati ed passano omni di in questo nostro regno»²⁾. Po nga ajo kohë përmenden për qytetin e Brindisit një tufë ikësish, të cilët sjellin lajmin atje për dukjen e sulltan Mehmetit II në afërsitë e lumit të Erzenit³⁾. Një valë shqiptarësh të Greqisë na dëshmohe për vitin 1482.

Me rënien e Krujës më 1478 një valë e re iku në mbretërinë e Napolit, me të edhe i biri i Skënderbeut, Gjoni. Fisi i Kastriotëve në vijë mashkullore u shua që në shekullin e 16-të⁴⁾. Pak dihet ndërkaq që një bir i kësaj dere, edhe ky me emër Gjergj Kastriota, rreth 1498-s u vendos me gjithë familje në qytet të Amalfit në Kampani. Në përmendoren e varrit të familjes së tij ndërtuar më 1506 në kishën kryesore të qytetit, ruhej mbishkrimi që japim më poshtë, me një shqiponjë dykrenore përsipër e të stolisur me kurora e me stemën e Kastriotëve në kraharor. Nga kjo derë përmendet në atë qytet më 1516 një Antonio Castriota dhe një Amalphiae Magnificus Dominus Georgius Castriota procurator Mo-

- 1) L. V. Thollöczy, *Archiv für slavische Philologie* 27,82 vv. Mukasév, *Monumente historica Slavorum meridionalium I* 204.
- 2) M. v. Šufflay, *Srbi i Arbanasi* 80 — f. 115 e përkthimit shqip.
- 3) F. Babinger, *Moameito II il Conquistatore e il suo tempo* (1957) 383.
- 4) Khs, tabelën e Ch. Hopf, *Chroniques gréco-romanes, inédites ou peu connues* (1873) 533.

nasterii S. Laurentii, e për herë të fundit, më 1625, kanoniku Andre Castriota.¹⁾

Në Venedik gjejmë të shpërngulur shqiptarë më 1388 e 1444, po me shumicë sidomos pas rrethimit edhe rënies së Shkodrës më 1479. Kjo koloni kryesisht zejtarësh të ndryshëm e tregtarësh u zmadhua me kohë me njerëz të ardhur prej viseve të ndryshme të Shqipërisë Veriore e Jugore, të cilët kanë pasur dhe esnafet e tyre. Mendimi i F. Babingerit që Marco Basaiti, piktor i njohur venecian i viteve 1500-1530, të ketë qenë i gjakut shqiptar²⁾, gjen vërtetim tani me faktin e diktuar prej nesh që familje me emër Bazaiti ka edhe sot në qytet të Delvinës.

Elementi arbëresh i Italisë gjatë këtyre pesë shekujve që nga ngulimi i tij në ato anë ka pasur mjaft ndryshime dhe humbje në numër, sidomos nëpër qytete. Megjithatë ka ruajtur përgjithësisht me një qëndresë të çuditshme gjuhën dhe vetitë etnografike. Sot flitet shqip në 49 lokalitete e katunde të Italisë Jugore e të Siqelisë, në Abrucet, Molizë, Kampani, Bazilikatë, Kapitanatë, Apuli, Kalabri e Siqeli me një popullsi rreth 100.000 frymë. Zhvillimi dhe fatet e këtyre ngulimeve kanë qenë të ndryshme. Më një anë disa nga to janë romanizuar, sidomos në këta dy shekujt e fundit. Më anë tjetër disa katunde nuk kanë qenë themeluar prej shqiptarësh që në krye të herës, po prej arbëreshësh të shpërngulur për arsye të ndryshme nga njeri vend në tjetrin. Kështu p.sh. S. Cristina Gela në Siqeli është themeluar më vonë, nga ata të Piana degli Albanesis. Në Kalabri nga mungesa e disa katundeve të sotme në «Libro dei fuochi», gjatë një regjistrimi të popullsisë në vitin 1543³⁾ kuptohet se këto katunde nuk kanë qenë në atë kohë. Në ndryshimet etnike e gjuhësore

- 1) Francesco Pansa, *Istoria dell'antica Repubblica di Amalfi*, Napoli 1764, f. 225 (Notamentum Instrumentorum in Pergameno in Archivio reverendissimi Capituli Archiepiscopatus Amalphiae. — Matteo Camera, *Memorie storico-diplomatiche dell'antica Città e Ducato di Amalfi*, Salerno 1875, f. 626 shënim. Mbishkrimi: GEORGVIS CASTRIOTA VIR INTEGER CAESAREA CONGNATIONE MORVM CANDORE CLARVS; SIBI POSTERISQVE SVS VIVENS FECIT MDVI.
- 2) *L'origine albanese del pittore Marco Basaiti* (ca. 1470-ca. 1530). *Atti dell'Istituto Veneto di scienze, lettere ed arti*. Anno accademico 1961-62. Tomo CXX. — Classe di scienze morali e lettere, 1962, f. 497 vv. — *Studia albanica* Ire année, No. 2, 1964, f. 104 v.
- 3) D. Zangari. *Le colonie italo-albanesi di Calabria*. *Storia e demografia Secoli XV-XIX*, 1940, f. 71.

të ngulimeve një pjesë e mirë u bie dhe banorëve italianë që kanë zënë vend gjatë kohëve në to; këta nga një anë kanë shtuar ndikimin sa vete më të madh të italishtes në vend, nga ana tjetër ata vetë me kohë janë shqiptarizuar nga gjuha. Te përpjesëtimi i emrave italianë të familjeve ndaj emrave të vjetër shqiptarë mund të shihet gjer diku shkalla e simbiozës dhe e përzjerjes etnike në viset e ndryshme. Kjo ka lidhje dhe me karakterin topografik të këtyre viseve: në krahinat kodrinore e sidomos malore vetitë shqiptare të banorëve u kanë ruajtur më mirë, në fusha të hapëta si në Apuli është kryer asimilimi më heret. Në këtë kanë ndihmuar në shkallë të gjerë natyrisht edhe shkolla, shërbimi ushtarak, qarkullimi, përgjithësisht jeta moderne, jo më në fund edhe emigrimi në qytetet e mëdha të Italisë Veriore si edhe në Amerikë të Veriut e të Jugut.

Popullsia arbëreshe e Italisë, po ashtu si ajo e Greqisë, me punën e saj, me çeljen e tokave djerre e moçalore, me popullimin e vendeve të shkreta, është treguar një element pozitiv nga pikëpamja kulturele. Të dyja degët kanë ruajtur përveç kësaj edhe mjaft tipare të kulturës materiale e mendore të marra me vete nga vendi i të parëve, si veshjet, doket e zakonet, gjuhën e poezinë popullore, megjithëse edhe shumë kanë humbur. Besimi ortodoks në Greqi i ka çelur shteg asimilimit, në Itali përkundrazi, me një popullsi vendëse të rritit latin, ka qenë një faktor i ruajtjes etnografike e gjuhësore. Në lidhje me gjuhën do shtuar se si atje si këtu ndonjë fjalë e shqipes ka depërtuar në gjuhën e popullsisë që i rrethon. Në Greqi ndërkaq toponimia shqiptare është më e pasur se në Itali, ajo paraqitet edhe nëpër vise ku sot nuk ka mbetur në gjurmë shqiptarësh. Te të dyja elementet ruhet edhe emri i lashtë i popullit (*arbëresh*) e i gjuhës (*arbërisht*), gjë që dëshmon se në kohën e shtegimit shqiptar për në ato anë ky ishte emri në përdorim dhe emri i sotëm nuk ish përgjithësuar. Ndër emra personash tek arbëreshët e Italisë ka pasur dhe disa me karakter kombëtar, si *Lekë, Nerënca, Vasha e Zoga*, tani përdoren shumë ofiqe ndër ta. Në pikëpamje shoqërore është për t'u shënuar se ngulimet arbëreshe të Italisë, në kundërshtim me ato të Greqisë, kanë ndier ndikimin e një tradite kulturele të pandërprerë. Nga shtëpitë e tyre fshatare kanë dalë jo vetëm, si atje, luftëtarë, politikanë e patriotë, po edhe dijetarë, poetë e shkrimtarë të dëgjuar, të cilët i kanë dhënë shumë literaturës shqiptare. Mbledhja e folklorit që patën ndërmarrë ata vazhdon në mënyrë të kënaqshme dhe sot e gjithë ditën.

II

Një vështrim i gjuhës së arbëreshëve të Italisë, që synon të mos jetë skematik e i njëanshëm, nuk mund të bëhet pa përfshirë dhe rrethanat historiko-etnografike që u cekën pjesërisht më sipër. Përveç kësaj do pasur parasysh dhe konceptin arbërisht të Italisë. Me këtë do të kuptohet një shqipe e folur në Itali dhe e ndikuar thellë nga ana e italishtes dhe e dialekteve të saj.

E para gjë që karakterizon këto ligjërime është që këto janë isnuj gjuhësorë. Me pak përjashtime ato janë rrethuar kudo nga një botë gjuhësore e ndryshme, e cila i veçon nga njëri-tjetri dhe përcakton njëkohësisht dhe karakterin e gjuhës së tyre. Një tjetër rrethanë që peshon në këtë mes, është kjo, që këto ngulime janë themeluar në viset andej detit e përveç kësaj dhe në kohën turke. Kjo ka sjellë një zhvillim më vete e më fort të izoluar, me ruajtje të një shkalle gjuhësore të përparme e me një distancë më të madhe nga gjuha e dheut mëmë. Kjo sidomos në krahasim me shqipen e Greqisë, tek e cila për disa arsye gjeografike e politike nuk kanë munguar krejt fijet e ndërlianjes me vatrën e burimit të tyre. Ky karakter arkaik i arbërishtes së Italisë vihet re dhe në folklorin e saj.¹⁾

Në këto rrethana folësit e arbërishtes janë bërë folës dy gjuhësh, bile edhe tri gjuhësh; ata pas gjuhës amtare që marrin në fëmijëri përvetesojnë e përdorin dhe italishten, e krahas me këtë edhe dialektin italian të krahinës ku rrojnë. Shqipja është për ta gjuha e shtëpisë, italishtja a dialekti i saj gjuha e tregut. Kështu, pra, bilinguizmi ka çuar aty kudo në një gjuhë të përzier, veçse kjo përzierje ka arritur shkallë të ndryshme në ngulimet e ndryshme. Për këto ndryshime ka disa arsye: pozita topografike e qarkullimit, përpjesëtimi i popullsisë arbëreshe ndaj popullsisë italiane, rrethana për të cilat u fol dhe më sipër; madhësia dhe vjetërsia e ngulimeve, në mënyrë që ato më të voglat e më të moçmet përgjithësisht kanë pësuar më shumë ndikimin e gjuhës që i rrethon. Kështu p.sh. të Hora e t'Arbëreshvet (Piana degli Albanesi) të Siqelisë, me gjithë ndikimin e madh të italishtes respektivisht të dialektit italian të vendit, shqipja e italishtja kanë mbetur dy sisteme gjuhësore më vete. Në të tjera li-

1) Khs. autorin, *Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa* 3. Jahrgang, Nr. 3, 1939, f. 201 v.

gjërime përkundrazi, si në atë të Venas në Kalabri Jugorë, në Kieuti të Kapitanatës e pas studimeve të M. Lambertzit dhe në ato të Molizes,¹⁾ shihet një ndikim italian edhe në tingujt e në format gramatikore, megjithëse ky dijetar atë e ka mbivlerësuar disi. Nuk ka dyshim që ky ndikim sa vete po shtohet, me përfundimin e ditur për gjithë ishujt gjuhësorë të botës, të cilët më në fund vijnë e shuhen për fare. Shenjat e këtij procesi vihen re që sot. Ndërsa gjer tani sëfundi materiali italian i është shtuar sistemit fonetik e gramatikor: të shqipes (*speranza: sprënc, abitare: bitar etj.*)²⁾, ky vitalitet vise-vise ka zënë të zhduket. Kështu, bie fjala në Kutisë (Contessa Entellina) të Sigelisë thonë *zbellij la televisione* «Hape televizionin»³⁾. Shkalla e përzierjes gjuhësore ndryshon jo vetëm, si u tha, nga një vend në tjetrin, po shpeshherë edhe nga njëra lagje në tjetrën brenda një katundi. Ajo ndryshon ndërkaq dhe pas moshave, pas seksit, pas shkallës së formimit shkollor edhe pas gjendjes sociale të banorëve. Në lidhje me këto në mendimin e dijetarit italian Francesco Pullè:⁴⁾ «l'albanese invece conservasi solo dalle classi elevate» nuk e gjejmë veçse për një pjesë të drejtë. Vihet re përkundrazi që ishatarët e pashkollë, njerëzit e thjeshtë të popullit, burra e gra, në bisedën e përditshme të tyre përdorin përgjithësisht një shqipe më të pastër se njerëzit e shkolluar e intelektualët, të cilët zotërojnë italishten dhe mënyrat e saj të shprehjes. Edhe më shumë — po në drejtim të përkundërt — largohet nga të folët popullor gjuha e shkrimit që kanë përdorur e përdorin poetët, shkrimtarët e teologët, të cilët zakonisht u shmangen me vetëdijë edhe italianizmave më të përditshme të ligjërimit të vet, duke marrë shpesh dhe fjalë nga të Shqipërisë. Le të shtojmë në këtë mes që shqipja atje,

- 1) Për këto khs. L. Bruzzano, *Il dialetto albanese di Vena, Catanzaro* 1882, passim. M. Marchianò, *Canti popolari albanesi della Capitanata e del Molise, Apulia* III (1912. fash. 3-4, f. 188 vv. — M. Lambertz, *Albanische Mundarten in Italien*, IJ II (1915) 1-30; *Italoalbanische Dialektstudien*, KZ 51 (1923) 259-290, 52 (1924) 43-90, 53 (1925) 66-79, 282-307.
- 2) Autori, *Italoalbanische Studien* (1933) f. 74, 77, 86 të dorëshkrimit. Më parë R. Helbig, *Die italienischen Elemente im Albanesischen*, X. Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache zu Leipzig (1903) 28 v., 46.
- 3) M. Sciambra; *Orbis* t. XIII; Nr. 2 (1964) 414.
- 4) Italia, *genti è favelle* III (1627) 411.

kryesisht në prani të italianëve, shërben nganjëherë edhe si gjuhë e fshehtë, duke përdorur ata p.sh. *flutr* ose *ffutr* për «liretë», *di fjutra t madhe* «dy mijë lireta», ashtu si nganjëherë dhe në Malsi të Madhe (GJ. Shkurtaj).

Arbërishtja e Italisë në strukturën e saj përbëhet nga dy komponente: nga ajo që ka sjellë me vete prej dheut të së parëve dhe nga ajo që ka krijuar vetë ose që ka marrë së jashtmi pas ngulimit në atdheun e ri. Le t'u shtiem të dyjave nga një vështrim të shkurtër.

Gjendja gjuhësore në Shqipëri në kohën gjatë edhe pas shtegtimit arbëresh na paraqitet me dy dialekte me këto ndryshime kryesore. Në sistemin fonetik, në vokalizëm, zanore nazale në gegërishten e zanore orale në toskërishten; shqiptimi i *a*-së së pozicionit nazal si *ë* në toskërishten *zâ*, *zë*, *dhamb*, *dhëmb*; rënie e shpeshtë e *ë*-së fundore sidomos në gegërishten, më fort me zgjatim kompensimi të zanores së brendshme që i prin, *derë dër*, *rrimë rîm*; o-ja nistore ruajtur si *vo-* në gegërishten, hapur në *va* në toskërishten, *voj*, *vaj*; reduktim i *ie ye ue* në *i*, *y* e *u* të gjata në gegërishten, ruajtje e tyre si *ie ye ue* në toskërishten; monoftongim i diftongut ngjites *je* në *e* në gegërishten, dhjetë *dhët*; kontraktion i grupeve vokalike *ae oe* në një *e* më shumë a më pak të gjatë në toskërishten e në gegërishten jugore, ruajtje të ndryshme të tyre në dialektet e tjera të gegërishtes. Në konsonantizëm më fort ruajtje e karakterit të zëshëm të *b d g gj v dh z*-së në fund fjale e rrokjeje në gegërishten, më fort shurdhim i tyre në toskërishten; rotacizëm në toskërishten; një ruajtje më e mirë e nazalit palatal *ny* në toskërishten, më fort zbutim i tij në *j*, shpeshherë me nazalizim të zanores prise, në gegërishten; ruajtje thujse e përgjithshme e grupeve *mb nd ngj* në toskërishten, më fort asimilim i plotë ose i pjesëshëm i tyre në gegërishten; asimilim i grupeve *kl gl* më shumë në prepalatalet *g gj* në të dyja dialektet, ruajtje e tyre në çamërishten, asimilime të ndryshme të tyre në dialektet gege. Në rrokje një ruajtje më e fortë e opozicioneve kuantitative në gegërishten. Nga format gramatikore sidomos përemri vetvetor i *vet*, paskajorja e formuar me parafjalën *me* dhe pjesorja më *-m* janë karakteristike për gegërishten. Më pak kemi të bëjmë tek e ardhmja (futuri) me një element dallimi sa kohë që të dyja llojet e kësaj trajte kohore të përngjitur, ajo me *do* e ajo me *kam*, janë në të dyja dialektet, megjithëse e para mbizotëron në toskërishten. Një vështrim i këtyre tipareve

dialektore në lidhje me strukturën, me përndarjen gjeografike e me gjenezën e zhvillimit të tyre na dëfton së pari karakterin konservativ të gegërishtes në një periudë më të vjetër e të toskërishtes në një periudë më të re. Së dyti, në lidhje me kronologjinë e tyre, tregon që këto tipare janë formuar në faza gjuhësore të ndryshme, dhe që ato në tërësinë e tyre — e me to bashkë edhe vetë formimi i dy dialekteve kryesore — nuk arrijnë më lart se në mesjetë, në mënyrë që në mesjetën e hershme ndarja dialektore e gjuhës do të ketë qenë në shumë pika e ndryshme nga e sotmja.¹⁾ Për shekullin e 15-të, koha e shtegttimeve të para për në Itali, me një krahasim të monumenteve të vjetra të shkrimit me dialektet e Greqisë e të Italisë, gjendja gjuhësore mund të rindërtohet si më poshtë në vijat kryesore: Të dy dialektet ishin të formuara dhe të dalluara nga njëri-tjetri në tiparet e tyre konstitutive. Megjithatë afroheshin më fort në mes të tyre si edhe me tipin e përbashkët të gjuhës, për arsye se gegërishtja nuk kish kryer krejt hiferezën e ë-së, thjeshtimin e diftongjeve të mirëfillta e jo të mirëfillta (*je ia ye ue*) dhe të grupeve konsonantike *mb nd ngj* dhe zbutimin e *nj-së*, dhe toskërishtja nivelimin e dallimeve kuantitative, dhe sepse edhe në sistemin morfologjik e në leksik kishin elemente të përbashkëta më shumë nga ç'kanë sot. Vendi i arbërishtes së Italisë, e cila na intereson këtu në radhë të parë, në këtë mes mund të caktohet vetëm me një krahasim me rrethanat gjuhësore në atdheun e parë, po aty kryesisht jo me të sotmet, po me ato të kohës së shtegtimit: sepse që nga ajo kohë dialektet e atdheut kanë pësuar ndryshime, po edhe ato të Italisë nuk janë ato që kanë qenë. Nga një krahasim i tillë del atëherë që arbërishtja e Italisë me *va-* për *vo-*, me *ua* për *uo* gegërisht *ue*, me rotacizmin e saj, me mungesën thujse të plotë të paskajores e me disa të tjera veçori përgjithësisht ka për bazë një toskërishte më të vjetër. Cështja e një përkatësie dialektore më të ngushtë përbrenda këtij rrethi lidhet me problemin se nga kanë qenë shtegtarët e parë dhe nga e kanë pra burimin ngulimet e themeluara prej tyre. Këtu, mbi dëshminë e përbashkët të disa të dhënave të etnografisë e të folklorit, të historisë, të traditës gojore, të gjuhës, të emrave

1) Khs autorin, Studii si Cercetări lingvistice X 4 (1959) 527 vv., Buletin i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. XVII (1963) Nr. 3 f. 69 vv. Rev. Shkencore e Institutit Pedagogjik Dvÿjeçar Shkodër 1 (1964) 5 vv. Zeitschrift für Balkanologie II (1965) 6 vv.

të familjeve e të viseve, në shtegtimet shqiptare për në Itali kanë marrë pjesë grupe etnike prej krahinave të ndryshme të vendit, prej Jugu e prej Veriu, e pjesërisht edhe nga elementi shqiptar i Greqisë; po masa kryesore rrjedh nga jug-perëndimi, nga trevat që shtrihen midis Vlorës e Prevezës e nga hinterlandi i tyre¹⁾. Këto rrethana pasqyrohen edhe në gjuhë. Dialektet italo-shqiptare përmbajnë mjaft elemente heterogjene, midis tyre dhe ndonjë të gegërishtes si *opangë* në Kalabri, *katërdhjet* dikur në Apuli, etj., elemente që kanë lidhje me burimet e ndryshme të shtegtarëve. Megjithatë ato kanë një bazë të përbashkët. Në pajtim me rrethanat e përmendura të prejardhjes këtë bazë e përbëjnë dialektet e tos-kërishtes jugore të shekullit të 15-të, me inovacionet që kishin kryer këto në atë kohë.

Rrethanat e vendosjes në vendbanimet e reja, rrethana po aq me rëndësi për formimin e këtyre dialekteve sa dhe ato të shpërnguljes nga të vjetrat, edhe këto gjer diku mund të rindërtohen në vijat kryesore. Valët e veçanta të shtegtimin janë nisur zakonisht nga e njëjta krahinë, po për një kohë luftime do të mendohet anasjelltas dhe grumbullimi më një i turmave me prejardhje të ndryshme për të kërkuar një fat të përbashkët në dhe të huaj. Atje ka pasur kështu instalime grupesh homogjene në ngulime më vete krahas me instalime grupesh heterogjene në ngulime të përbashkëta, po së treti edhe ndarje të grupeve homogjene në vise të ndryshme. Me këto rrugë më një anë ju dha shkas gjer diku një përzierje dialektesh në atdhe të ri, më anë tjetër u shkëputën aty disa lidhje dialektore të mëparme. Ashtu gjejnë shpjegim nga njëra anë ndryshimet që ekzistojnë midis disa ligjërimeve arbëreshe që janë fqinje, e nga tjetra anë afrimet midis ligjërimesh që gjinden larg njëri-tjetrit. Kështu p.sh. Hora e t'Arbëreshvet (Piana degli Albanesi) në krahinë të Palermos, bashkë me koloninë e vet S. Cristina Gela, në shqiptimin e *l-së* velare si spirant velar i zëshëm (*mora* për *molla*) shkon me dialektet e largëta të Molizës; ajo largohet nga ligjërimi fqinj i Kuntisë (dhe i Mezzojusos e Palac Adrianit që janë krejt të romanizuara), të cilat në anë tjetër me ruajtjen e kësaj *l-je* velare në mënyrën e shqiptimit të *l-së* palatale e me disa tipare të tjera afrohen me ligjërimet — dhe këto jo të njësishtme — të Kalabrisë. Këtu shihet një nga degëzimet dialektore të arbërishtes së Italisë. Do të kemi parasysh, përveç

1) Autori, Proceedings of the Eighth International Congress of Onomastic Sciences (1966), The Hague-Paris, f. 70-81.

këtyre, që në disa ngulime vanë e zunë vend edhe banorë të rinj të ardhur prej atdheut të parë, a prej Greqisë, që pastaj — si u tha më sipër — ka pasur shtegtime nga një vend në tjetrin e nganjëherë edhe shoërngulje etnike me dhunë, dhe atëherë do të kuptojmë karakterin në fillim jo të njësishtëm të këtyre dialekteve. Po në qoftë se këto, me gjithë ndryshimet lokale që kanë në mes tyre, paraqiten si një njësi, si një «*unité dans la diversité*» në pamjen e gjithmbarshme të dialekteve të shqipes, në këtë gjë kanë vepruar disa faktorë. Së pari, është burimi i masës kryesore prej trevash të njëjta ose të afërta të Shqipërisë Jugore. Së dyti, si një dukuri konvergjence në atdheun e ri, sidomos në brezat e parë ka pasur një lloj nivelimi, me përfundimin që — sipas ngulimit — u afirmua dialekti i shumicës ose i shtresës më të vjetër të kolonistëve. Këtyre rrethanave erdhën e u shtuan pastaj marrëdhëniet gjuhësore midis ngulimeve arbëreshe fqinje. Me anë të kësaj koineje gojore, që u arrit pak a shumë kudo, me elementet e sjella me vete e me ato të zhvilluara në mënyrë të pavarur, erdhi e u formua një grup dialektor i një tipi më vete, i cili, si u tha, edhe në bisedën e përditshme zë një vend të vetin përkundrejt të tjerave degë dialektore të shqipes. Kështu, si thotë edhe M. Lambertzi¹⁾, me bashkëjetesën e re në dhe të huaj, u përfutua një gjuhë e re e përbashkët, e cila nuk ishte identike me asnjërin nga dialektet që fliten në atdheun e vjetër.

Duke përcaktuar me disa të dhëna konkrete këtë karakter të arbërishtes së Italisë, do të themi se ligjërimet e saj, pavarësisht nga përkatësia e tyre dialektore, ruajnë një shkallë më të moçme të gjuhës, ndër të tjera me këto tipare: opozicionet e gjatësisë me tri mora të ndryshme, të shkurtër, gjysmë të gjata e të gjata, me disa veçanti specifike për ato ligjërimet: *uo* në vend të *ua-s* në ndonjë ligjërim të Molizës, te F. Santori në Kalabri e në katundin Vila të Atikës në Greqi (*muoj*); *h*-në e sotme të shqipes me formën e vjetër si spirant gutural, pjesërisht velar (*i Xuaj*) e pjesërisht palatal (*X é <hie>*)²⁾; si një inovacion ndërdialektor mjaft të moçëm të shqipes, ndërrimin e prepalatalit *q* në *j* në pozicion parakonsontantik, si në *vdein* «*vdiqën*»³⁾; ndonjë disimilim likuidesh

1) IJ II 7.

2) Sh. për këtë H. Pedersen K 7 36; 280.

3) Autor, Buletini i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. XII (1958) Nr. 1, f. 33 v.

si te *gjalpër* për *gjarpër*; te format gramatikore do shënuar ndër të tjera përdorimi i nyjes së parme në emra etnikë ashtu si në literaturën e vjetër të Veriut (*i arbëreshë*)¹⁾, karakteri konservativ në përdorimin e temave konsonantike femërore (*djepja, kria*)²⁾, në ruajtjen e mirë të neutrit, gjë që ka çuar dhe në formim neutrash sekundarë, kryesisht në emra lëndësh, sidomos metalesh; aty hyn mbase edhe përdorimi i temave nazale me *-r* dhe në trajtën e pashquar (*drë-i, gjë-i*)³⁾ në disa ligjërime të atjeshme. Nga fusha e kongruencës së përcaktorëve të emrit me këtë vetë hyn këtu pikësëpari kongruenca në rasë (konciniteti), si në *E eshtrave tireve* (Matranga), *Ljümravet të kal'thërvet* (De Rada), dukuri edhe e literaturës së vjetër të Veriut (Gj. Buzuku e *ujënavet gjallave*, P. Bogdani *bjeshkëshit fort së naltash*)⁴⁾; pastaj trajta e shquar e njërit nga dy përcaktorët e një emri, në *Kalabri vashza vogël jotja*⁵⁾, në Shqipëri *vajza jote e vogla*. Nga përemrat janë mbajtur ndër të tjera vetori i thjeshtë *u* «unë» dhe pronorët *tāj* (*dherat tāj* «dherat tuaj»), *tote* (*vajza tote*), *sote*, *i katundit tit* e ndonjë tjetër, të cilat në Shqipëri në pjesën më të madhe kanë humbur; i pakufishmi *jetëri* «tjetri»; një krijim spontan mund të jetë refleksi *vetëjotja* «vetja jote», *vetëjuaja* «vetja juaj». Nga sistemi foljor me një shkallë të mëparme të gjuhës piqet përdorimi i së pakryerës së pazgjeruar të tipit *flij* «flinte», opozicioni morfologjik *viel: kam vjelë, tier: kam tjerrë* të klasës së foljeve më likuide, e përdorimi i gjerë i pjesores më *-m* me vlerë mbiemërore (*letër e shkruame*); aoristi sigmatik (*gjeçë, u ftohcë*), në disa ligjërime aoristi asigmatik i tipit *pë* «pashë», pe Buzuku *pae*, dhe zgjerimi me *-ënj -ën* i foljeve me fundor konsonantik (*qeshënj, qeshën*), një inovacion i vjetër i shumë dialekteve të shqipes. Nga një periudë e përpërme e më e njësishtme e gjuhës rrjedhin dhe disa elemente leksiake që ruhen në gegërishten, duke mbetur shpesh herë ja-

1) Autori, Studii si Cercetări lingvistice X 4 (1959) 533, Buletini i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. XVII Nr. 3 f. 74 v.

2) Autori, Lingua Posnaniensis VIII 113 vv. *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 136 vv.

3) Autori, Bul. për Shk. Shoq. 1952, nr. 3 f. 38 shën. 3. Zeitschr. für Phonetik u. allgem. Sprachwissenschaft IX 204 shën. 12.

4) Autori, Bul. për Shk. Shoq. 4 (1955) 123.

5) Khs. G. Rohlf's, *Sprach- und Sachatlas Italiens und der Südschweiz* I 40.

shtë toskërishtja e sotme: ë «është» geg. *â*, *lopa bonet* «ethet», *çëdo çdo* «disa» (Buzuku *zhdo*, Arbëreshi i Dalmacisë *dizhdo*), *drë* «frikë» geg. *droe*, *gjithsej*, *krip* «flokë», *mat* «buzë lumi, breg deti, më «iam» geg. *mâ*, *regj* «mbret», *shkëlqen*, *shtuara* «duke ndejtur më këmbë», *tëtim* «ftomë», *qjellë* «jetë», *zgardhullonj* «hap» (në Shqipëri *zgurdulloj*) etj. Pranë këtyre tipareve të trashëguara nga një periudë më e mëtejme e gjuhës ka disa të tjera që janë me përkatësi dialektore specifike: prej toskërishtes jugore rrjedhin në pjesën më të madhe nga fusha e fonetikës *i*-ja në vend të *y*-së, shqiptimi i *ë*-së së theksuar me një timbër *o*-je ose *i*-je (sipas ngulimit), po jo me timbër *e*-je si në toskërishten veriore, qendrore e lindore. ruajtja në shumë ligjërime e *lj*-së dhe grupeve *lk lg*, *k*, *gl* (*val*, sufiksi *-lë* për *-je*, *ulk*, *balgë*, *klumësht*, *gluxë*), shurdhimi i *j*-së fundore në spirantin palatal *ɰ* (*māɰ* «maj»), zhdukja asimilatore e *v*-së në grupet *xv zhv sv zv shv zhv* (*xerk. xhesh*) asimilimet e trajtave foljore si në *flini*, «flitni», *vrini* «vritni». Në fleksion shumëset e shpeshta me metafoni *a : e* në emra e mbiemra (*pëllesë*, *të glet*, *të lert*)¹⁾; shtrirja e madhe e shumësit të emrave me zgjerim *-ër -ëra* (*brezra*, *dejtëra*, *ditëra*, *mërza*. *unqlëra* «ungj», *viçra*) në dialektet e Greqisë v.sh. *ulkëra*, *leshëra*, *detëra*)²⁾, rrjedhorja shumëse me *-shit* si në literaturën e vjetër të Veriut; përemri i pakufishëm *mosgjë* «asgjë»; numërorët e metodës vigezimale *trezët* «60», *katrzët* «80»³⁾; te folja trajtat e prezentit shumëse më *-mi* (*shomi*, në Kalabri, inovacioni jugor i formimit të aoristit e të pjesores me *-t* (*erthtin*; *muartin*; *thertur*), urdhërorja e kontraktuar e tipit *vrë* «vrae». Nga leksiku forma e kuptime si *aj* «kafshim, kafshatë», *dej* «pasnesër» me *kosdej* «tjetërpasnesër», *njëditëz* «parëdje» me *njënatëz* «pardje mbrëma», *trivët* «parëvjet, tërvit», *dihet* «gdihet», *ëhenj* «preh», *hurdhë* «hudhër», *mbloni* «mbush», *vra* «pasta», *rusem* «zbres, ulem nga lart», *xhavidhe* «gocë deti», *zbier*, *zborā* «humba», *zboj* «dëboj», *zborë* «borë». çoj me kuptimin «gjei» etj. Nga një periudë më e mëtejme rrjedh rrëzë me kuptimin «rrënjë», geg. e vjetër dhe e sotme *rranzë rrâzë*.

- 1) *Lingua Posnaniensis* VIII 125 v., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 150 vv.
- 2) Për Greqi Reinhold *Noctes pelagicae* 6, C. Haebler, *Grammatik der alb. Mundart von Sdlamis* 60.
- 3) Bul. për Shk. Shoqërore 1952 Nr. III f. 40, *Zeitschrift für Phonetik u. allgem. Sprachwissenschaft* IX 206.

Sikundër u tha edhe më lart, formimi i arbërishtes së Italisë e i karakterit të saj lidhet me trashëgiminë gjuhësore të marrë me vete nga atdheu i parë e të shndërruar gjatë shekujve në bashkëjetesë me një sistem gjuhësor tjetër. Në vijim të këtij zhvillimi historik të veçantë ka rezultuar një karakter i shumëfishtë i këtyre ishujve gjuhësorë: ruajtje tipesh e elementesh në të dyja anët, në gjuhën e atdheut të vjetër e në atë të së riut; ruajtje në të vjetrin e humbje në të riun; ruajtje në të riun e zhdukje në të vjetrin; interferenca të ndryshme. Nga ky karakter kompleks e shumështrësash rrjedh për një pjesë të madhe edhe rëndësia e kësaj dege dialektore për gjuhësinë shqiptare.

HISTORI GJUHËSORE DHE STRUKTURË DIALEKTORE E ARBËRISHTES SË ITALISË

I

Shpërngulja e elementit shqiptar për në Itali është e lidhur historikisht me ngjarjet dramatike që ndodhën në Gadi-shullin Ballkanik në rrjedhë të shekullit XV, kur kjo trevë e Evropës ra në duart e Perandorisë Osmane. Bashkë me arsyë të tjera, të rendit ekonomik e shoqëror, fryma e lirisë dhe e pavarësisë që ka karakterizuar popullin shqiptar gjatë historisë së tij, ka qenë një nga shtysat e braktisjes së vendit të së parëve dhe e kërkimit të një atdheu të ri në viset përtej detit.

Nga dëshmia e rrethanave historike, d.m.th. kur u pushtuan krahinat e ndryshme të Shqipërisë, dhe nga dokumentet që ekzistojnë, rezulton se shpërngulja shqiptare për në Itali ka zgjatur, me ndërprerje, afërsisht tre shekuj, prej mesit të shekullit XV gjer aty nga mesi i shekullit XVIII. Do të mendojmë se kjo shpërngulje nuk u krye përnjëherë, po me disa valë të ndryshme, më të mëdha e më të vogla. Në vijë të përgjithshme mund të thuhet se shumica e ngulimevet arbëreshe u themelua gjatë gjysmës së dytë të shekullit XV, kur pas vdekjes së Skënderbeut dhe pas një luftë të pabarabartë kundër pushtuesve osmanë nisi shpërngulja për në Itali. Kjo vazhdoi me hove në shekujt e mëpastajmë, gjer në vitin 1744, kur u themelua katundi Villa Badessa në Abrucet. Nga dokumentet që disponojmë dihet ndërkaq se grupe sporadike të shpërngulurish ka pasur edhe para dyndies së osmanëve, në vitet 1272, 1388, 1393 etj. Në shekullin XV një valë shpërnguljeje ka ndodhur në vitin 1442. Për Venedik dëshmohen për mesjetë që heret shqiptarë, të cilët me kohë formuan atje dhe një koloni më vete, të grupuar më vonë edhe në esnafe (korporata) të veta. Kjo koloni u përforcua sidomos me elementin e ri të ardhur pas rënies së Shkodrës më 1479, i cili

u vendos pjesërisht në qytet të Venedikut, e pjesërisht në qytetet e hinterlandit¹). Mendimi i F. Babingerit²), që piktori venecian Marco Basaiti, i cili veproi rreth viteve 1500-1530, të ketë qenë me rrjedhë shqiptare, pas mendimit tim gjen vërtetim me faktin që Bazaiti është edhe sot një emër familjesh në qytet të Delvinës në Jug. Prej Shqipërisë Veriore duket të kenë dalë edhe disa grupe shqiptarësh që dëshmohen në vitin 1458, bashkë me sllavë, për qytetin e Ankonës, si dhe disa të tjera, po ashtu të përziera me kolonistë sllavë, që diktoi Leopardi i ri nëpër dokumentet e arkivit të vendlindjes së tij Rekanati për vitin 1437 e për vjetët më vonë. E njëjta gjë do të mendohet edhe për disa grupe kolonistësh. shqiptarë e sllavë, që shfaqen më 1461 në Castelluccio dei Sauri në Apuli Jugore. Valët e shtegtimit kanë qenë të dendura në këtë kohë. Në një dokument të vitit 1467 me burim prej mbretërisë së Napolit thuhet se «fra l'altri Albanesi quali so passati et passano omni di in questo nostro regno». Dihet se me rënien e qytetit të Kruiës më 1478 pati një tjetër valë shkulljeje. emigrimi, në të cilën mori pjesë edhe i biri i Skënderbeut Gjon Kastrioti. Kastriotëve, sikundër dihet, iu dhanë feude kryesisht në Apuli ku zunë vend bashkë me disa nga bashkatdhetarët e tyre. Kjo derë në vijë mashkullore u shua në shekullin XVI. Prej gjurmimeve që kanë kryer Francesco Pansa³) e më vonë Matteo Camera⁴) rezulton se një degë e kësaj dere u shpërngul aty nga fundi i shekullit XVI në qytet të Amalfit në Kampani. Në kishën kryesore të atij qyteti ruhej — e mbase ruhet dhe sot e kësaj dite — përmendorja e varrit të familjes, ndërtuar në vitin 1506, stolisur me një shalibe dykrenore. emblema e kësaj dere, e me mbishkrimin GEORGIUS CASTRIOTA VIR INTEGER CAESAREA COGNATIONE MORVUM CANDORE CLARVS SIBI POSTERISQVE SVIS VIVENS FECIT MDVI — Duke rrokur me një vë-

- 1) Për këto më sipër e më poshtë khs. autorin në *Proceedings of the Eighth International Congress of Onomastic Sciences* (1966) 70 vv.; *Studime filologjike XX* (IX), 1972, Nr. 2, f. 23, vv.; *Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike III* (1970), 107 vv.
- 2) *Atti dell'Istituto Veneto di science, lettere ed arti CXX*. Classe di scienze morali e lettere (1962) 497 vv.; *Studia Albanica I*, Nr. 2 (1964), 104 v.
- 3) *Istoria dell'antica Repubblica di Amalfi* (1774) 225.
- 4) *Memorie storico-diplomatiche dell'antica Città e Ducato di Amalfi* (1875) 626 shënim.

shtrim përmbledhës historinë e shpërnguljes së elementit shqiptar për në Itali, do të thuhet se ajo nga puna e numrit të pakë dhe e njohjes së mangët të dokumenteve të kohës, vetëm pjesërisht mund të rindërtohet në procesin dhe në etapat e ndryshme të sajat. Dokumente përkatëse për Shqipërinë mungojnë për atë kohë. Burimet që gjinden në arkivat e mëdha dhe në arkivat krahinore edhe lokale të Italisë, në regjistrat kishtarë etj., për një pjesë të madhe presin që të shohin dritën e të shkunden nga pluhuri i kohës që i ka mbuluar. Dokumentet e botuara gjer më sot duhet të rishqyrtohen për nga ana e autenticitetit dhe e vlerës burimore të tyre. Gjithsesi historia e kësaj lëvizjeje etnike duhet të rimerret ab ovo e të trajtohet sërish në një mënyrë e me metodë shkencore.

Duke kaluar prej historisë në gjuhë, para se të shqyrtohen disa çështje të kësaj fushe, ndeshim pikësëpari në emrin «italo-shqiptar». Ky emër, i cili përdoret shpeshherë për të shënuar arbëreshin e Italisë bashkë me gjuhën e tij, përmban në vetvete një koncept etnik e gjuhësor. Gjuhësisht ai shënon një shqipe të ndikuar në një masë të konsiderueshme prej italishtes e prej dialekteve të saj gjatë një simbioze të pandërprerë prej disa shekujsh. Aty njëkohësisht përmbahet dhe një raport gjuhësor. Përmbahet raporti midis elementit të sjellë me vete prej atdheut të burimit dhe elementit të marrë në atdheun e ri. E ky raport përfshin nga ana e tij në një farë vështrimi edhe një luftë të rendit gjuhësor, më një anë ndikim e më anë tjetër rezistencë. Prandaj, për të rrokur disa nga tiparet qenësore, esenciale, të kësaj forme gjuhësore, duan sqaruar më parë disa pika të një karakteri të përgjithshëm të fushës socio- e veçanërisht dhe etnolinguistike.

Dihet se shqipja që flitet në Itali paraqet një formë të shqipes jugore, të dialekteve që përfshihen me emrin toskërisht, ndërsa dialektet më veriore të truallit gjuhësor të shqipes hyjnë, sikundër dihet, në grupin e gegërishtes. Po ky emërtim global a mjafton për të rrokur karakterin qenësor të arbërishtes së Italisë? Gjuha paraqet diçka rezultative, përfundimin e disa proceseve historike, të kryera në rrethana të caktuara etnike e shoqërore. Për të kuptuar atë në formën e saj të veçantë, do vështruar ajo prandaj në lidhje me këto procese e rrethana nga të cilat ka dalë. Me barazimin arbërisht = toskërisht nuk shpjegohet gjithçka në këtë problematikë. Çështja është disi më komplekse nga ç'mund të duket me vështrimin e parë. Aty ka vend për diferencime nga më se një pikëpamje.

Pikësëpari në lidhje me vendin e prejardhjes. Prej cilës anë ose prej cilave anë të trevës shqiptare rrjedhin arbëreshët e Italisë? Sot e afërsisht dy shekuj më parë, një arbëresh prej Siqelie, Nikollë Keta prej Kuntise (Contessa Entellina) në krahinë të Palermos, me një metodë kërkimi thujse moderne iu përvesh zgjidhjes së kësaj çështjeje në një mënyrë gati tërësore, duke shtënë në përdorim përveç dëshmimeve të gjuhës edhe ato të etnografisë, të historisë dhe të onomastikës. Ndonëse e përdorur në një periudë para themeimit të shkencave historiko-gjuhësore e të metodave të tyre, dhe me mjete shkencore të pamjafta e me rezultate të paka, rruga e ndjekur prej këtij burri të shquar në parim mbetet e drejtë¹⁾. Zgjidhjes së problemit të rrjedhës së ngulimeve arbëreshe mund t'i afrohem vetëm me një metodë globale të kërkimit, duke kombinuar dëshmitë gjuhësore me të dhënat e historisë e të etnografisë: trajtat dialektore edhe emrat e familjeve, të vendeve e të shenjtorëve lokalë të ngulimeve me dëshminë e dokumenteve, të regjistrave kishtarë të tyre, me traditën gojore të gjallë në Shqipëri e në Itali, me elementet e kostumeve, të dokeve e të zakoneve, me disa motive të përbashkëta të poezisë popullore, e të tjera si këto. Me gjëndjen e tashme të studimeve, pas kërkimeve të kryera gjer më sot, rezultojnë se arbëreshët e Italisë janë të ardhur prej visesh të ndryshme të Shqipërisë, mendim që e kanë pasur dhe Z. De Rada²⁾, Dh. Kamarda³⁾ në shekullin e kaluar, dhe në shekullin tonë F. Andriulli⁴⁾, M. Lambertzi⁵⁾, D. Zangari⁶⁾ e të tjerë. Duke lënë mënjanë dëshmitë e tjera, do të përmendim se tradita gojore në Shqipëri, në krahina të ndryshme të Veriut e të Jugut, ruan kujtimin e shpërnguljeve lokale të hershme për në Itali; kështu në Lumë e në Mat, në anët e Krujës e të Kavajës, në anët e Vlorës e në vise të ndryshme të Bregut të Detit me hinterlandin e tij, edhe gjetkë. Në Shqipëri Veriore na shpjen dhe emra famil-

- 1) Khs. G. Spata, *Studi etnologici di Niccolò Chetta sulla Macedonia e l'Albania* (1870) passim. — Vërejtjet tona te «Revista pedagogjike» XXIX (1974) Nr. 4, f. 140 v.
- 2) *Grammatica della lingua albanese* (1871) 5.
- 3) Te G. Papanti, *I parlari italiani in Certaldo* (1875) 662.
- 4) *Atti del primo Congresso di etnografia italiana* (1912) 183 vv.
- 5) *Indogermanisches Jahrbuch* II (1915) 6 v.
- 6) *Le colonie italo-albanesi di Calabria. Storia e demografia Secoli XV-XIX* (1941) 70, 77.

jesh arbëreshe si Gazullus, Plesha, Riolo, Skutari e Span; në Shqipëri të Mesme ndër të tjera Gramshi, Keta, Manes, Mates, Matranga, Mirakko, Muzaki, Polisi Rada, Skura; në Shqipëri Jugore Barbaçi, Borgia (Borshi), Bua, Damis, Dirmi, Dorsa, Dragotta, Dramis, Glava, Groppa, Kappareli, Jerbes (Gjerbës), Kakosi, Krávari, Kuçi, Kudes, Likursi, Lopes, Losha, Luçi, Petta, Pílorá, Píqerri, Rerés, Spata, Stamati, Strati, Tannassi, Toskves, Thani, Varfi e shumë të tjerë. Disa emra janë të shumëkuptimshëm, meqë prej Shqipërie u përgjigjet më se një emër, vendi a familjeje, me të njëjtën formë. Prej anëve të Veriut rrjedhin ikësit e Krujës e të Shkodrës që u zunë ngoje më sipër, elementet që shfaqen për një kohë në Rekanati e në Ankona e që u përmendën edhe këta, një shpërngulje banorësh të Durrësit në vitin 1393, e një grup ikësish të vitit 1467, të cilët sjellin në qytet të Brindisit kumtin e dukjes së Sulltan Mehmetit II në afërsitë e Erzenit në Shqipëri të Mesme¹⁾: gjithsesi grupe që u asimiluan në një kohë të shkurtër. Një dëshmi ndër të tjera për ardhje elementesh gege na e jep edhe shënimi i një regjistri (Libro dei matrimoni) që ruhet në kishën kryesore të Hora e t'Arbëreshvet (Piana degli Albanesi) në Siqeli ku shënohet martesë e një «Martino Cuccia, greco albanese venuto di Albania della città di Croia con francisca v.d. (vedova) relita del quond. Gasparo Cuccia di questa terra a di 28 gennaio 1628». Po të pyesim ndërkaq se cila është treva prej nga u shkulën pjesa më e madhe e banorëve që zunë vend në krahinat e ndryshme të Italisë Jugore e të Siqelisë, aty, pa hyrë në këtu në hollësira, rezulton se masa dërmuese e themeluesve të ngulimeve arbëreshe rrjedh prej bregdetit ç'mban afërsisht prej anëve të Vlorës gjer në anët e Prevezës në Çamëri dhe prej hinterlandit përkatës. Atje çojnë si forma gjuhësore, si emrat e njerëzve e të vendeve, si edhe elementet e etnografisë e të poezisë popullore. Këtu është vendi të përmendet ndërkaq se ka indice, historike, gjuhësore e të tjera, të cilat dëshmojnë se elementit arbëresh të Italisë në prak të kohës së re erdhi e iu shtua edhe një komponente ardhësish shqiptarë të ikur prej Greqie, veçanërisht prej Moreje, të cilët zunë vend nëpër ngulime të ndryshme arbëreshe e në katunde të tjera të Italisë Jugore. Kënga e përmallshme «O e bukura More» e Kalabrisë e e Siqelisë ruan kujtimin e një rrjedhe të tillë. Përmasat e kësaj komponenteje të re nuk dihen, veçse nga

1) F. Babinger, *Maometto il Conquistatore e il suo tempo* (1957), 383.

pikëpamja shkencore do të thuhet se ato nuk duhet të teprohen. Pa druajtje që të biem në gabim mund të themi se masa e këtyre ardhësve të rinj ka qenë më e vogël, shumë më e vogël se ajo e banorëve të parë të ardhur prej Shqipërie. Kundra një gjykimi të tillë nuk japin dëshmi as gjuha, as emrat e familjeve e të vendeve. Kur ka p.sh. një emër familjesh *Dara* në Siqeli e një katund *Dara* në Moré, kjo nuk vërteton një rrjedhë të bartësve të emrit të Siqelisë prej Moreje, sa kohë ka dhe një katund *Dara* në anët e Prevezës në Çamëri. Ashtu qëndron puna edhe me *Koroni*, emër i një lagjeje (fshatthi) afër Picarit në anën e Gjirokastrës në Jug, dhe në kaza të Margëllëcit në Çamëri, *Koroni* në Moré e *Korone* në Kalabri. Gjithashtu edhe me emrin e katundit *Varibopi* (disa herë) në Shqipëri Jugore, *Varibobi* katund në Moré, *Variboba* në Kalabri, e të tjera si këto. Këtu ka dy mundësi burimi: ose këta arbëreshë janë të ardhur prej Moreje, ose prej vatrash të përbashkëta të atdheut mëmë u ndanë dy degë: një me drejtim për Greqi e një për Itali.

Në historinë e brendshme të arbërishtes së Italisë diferencimet që u përmendën më sipër duan pasur parasysh edhe në lidhje me atdheun e ri të folësve të parë të saj. Do të mendojmë që ikësit e parë për një pjesë përbënin njësi kompakte, me burim prej një vendi a një krahine të përbashkët, pra grupe homogjene në pikëpamje etnodialektore. Për një pjesë tjetër rreziku i përbashkët mblodhi e pështolli në kohë luftime elemente heterogjene, gjind krahinash të ndryshme, dhe i bëri të ndiqnin një fat të përbashkët në dhe të huaj. Edhe te ky dhé ndërkaq do të mendohet se ka pasur fate gjuhësore të ndryshme, me interferenca të shumëfishta. Ka pasur, në pjesën pas gjase më të madhen, ngulim ardhësish me rrjedhë prej një krahine të vetme të Shqipërisë, pra me një dialekt pak a shumë të njësishtëm. Mund të ketë pasur ndërkaq edhe shpërndarje grupesh homogjene në katunde të ndryshme, ndonëse të afra, pra degëzime të një dialekti të njësishtëm. Krahas me këto ka pasur vendosje ardhësish me rrjedhë prej visesh të ndryshme në një ngulim të përbashkët. Këtyre ngulimeve të themeluara erdhën e iu shtuan me kohë vise-vise edhe ardhës të rinj prej Shqipërie e prej Greqie, si edhe ardhës italianë prej katundeve fqinje. Nuk do harruar se ka pasur edhe shpërngulje banorësh, për shkak epidemish, tërmetesh e për arsye të tjera. Ndonjë katund është koloni e një ngulimi më të vjetër, si S. Cristina Gela në Siqeli, që u

themelua prej arbëreshësh të Horës, Piana degli Albanesi¹). Po të shikohen këto procese sociolinguistike në mbarë kompleksin dhe në interferencat e tyre, do të kuptohet se arbërishtja e Italisë jo vetëm u bart prej tej detit, po edhe u formua në trojet e reja. Krahas me shkëputje e degëzim njësisish dialektore të hershme aty ka pasur edhe përzierje dialektesh, me anë të simbiozës në të njëjtin ngulim e me marrëdhëniet e natyrshme midis katundeve të afra midis tyre. Krahas divergjencës ka pasur kështu dhe konvergjencë. Me dukurinë e divergjencës gjen shpjegim fakti që një pjesë e ligjëtimeve të Sigelisë shkon gjuhësisht me ato të Molizes, një pjesë me ato të Kalabrisë, të cilat dhe këto paraqesin ndryshime ndër-mjet tyre. Më rëndësi ndërkaq ka aty dukuria e konvergjen-cës, e afrimit të shoqishojmë të dialekteve disi të ndryshme. Ajo ka sjellë që arbërishtja e Italisë, me gjithë ndryshimet lokale që ekzistojnë përbrenda saj, paraqitet si një farë një-sie, si një «*unité dans la diversité*» në mjedis të dialekteve të shqipes. Një formë dialektore më vete, e cila nuk është e barabartë me asnjërin ndër dialektet e vendit të burimit²).

Duke e kundruar arbërishten e Italisë nga këto pikëpa-mje, karakteri i saj, i përgjithshmi, njëkohësisht i njësishtëm edhe kompleks, paraqitet afërsisht si vijon: Ai përmban ti-pare të sjella me vete prej atdheut mëmë dhe tipare të fi-tuara në atdheun e ri. Përveç kësaj ai përmban tipare ruaj-tjeje, konservimi dhe tipare risimi, inovacioni. Paraqet më në fund dhe disa bjerrje.

Në lidhje me elementin e sjellë me vete, i cili përbën fondin kryesor të saj, arbërishtja e Italisë pasqyron një tos-kërishte të një faze më të vjetër, afërsisht të mbarimit të me-sjetës. Ky karakter i saj arrihet të rrokët me anë të një ri-ndërtimi të brendshëm, nëpërmjet të një krahasimi të shoq-i-shojmë të dialekteve të shqipes. Në këtë prizëm historik, e në pajtim me parimet e gjeografisë gjuhësore, kjo degë dia-

1) Khs. G. Chiaramonte Musacchia, *Notizie sulle origini e sulla storia della colonia albanese di S. Cristina Gela (Palermo, Annuario 1966-67 del Centro Internazionale di Studi Albanesi, Palermo, f. 5 vv. e boti-mit të veçantë. — Për ngulimin e Horës vetë khs. tani dhe H. Kellner, Die albanische Minderheit in Sizilien. Eine ethnosoziologische Unter-suchung der Siculo-Albaner, dargestellt anhand historischer und volks-kundlicher. Quellen sowie eigener Beobachtungen in Piana degli Al-banesi, Wiesbaden 1972.*

2) Khs. edhe M. Lambertzin, vendi i cituar, f. 7.

lektore, e shkëputur disa shekuj më parë prej trungut të përbashkët të gjuhës, si një «aria seriore» (aire tardive) në kuptimin e M. Bartolit, paraqet disa tipare të përbashkëta, fonetike, morfologjike, sintaktike e leksikore, më një anë me shqipen e Greqisë, të shkëputur në një periudë edhe më të parë, më anë tjetër me gjuhën e autorëve të vjetër të Veriut, të shekullit XVI e XVII, sidomos me gjuhën e Mesharit të Gjon Buzukut të vitit 1555. Në mbarim të mesjetës, në periudën paraletrare të gjuhës, na çojnë edhe ato të paka huazime turke që gjinden në ligjërimet arbëreshe të Italisë.

Përveç këtij aspekti historik ndërkaq, në arbërishten përmbahet dhe një karakter gjeografik, ai i një përkatësie dialektore. Në tiparet e saj konstruktive, arbërishtja e Italisë, ashtu si dhe arbërishtja e Greqisë, i përket toskërishtes jugore, ose — mund të themi — jugperëndimore, nga pikëpamja etnolinguistike labërishtes e çamërishtes në kuptimin më të gjerë të këtyre termave, duke vërtetuar kështu gjuha dëshmitë historike e onomastike që u përmendën më sipër. Kjo përkatësi del qartë në mbarë sistemin gjuhësor, e bie në sy menjëherë në intonacionin e melodinë e frazës, e cila ka diçka të zvargur e muzikore. Ky afrim, e më anë tjetër ky opozicion ndaj dialekteve të tjera të shqipes, shihet edhe sot, po do të ketë qenë më i fortë dikur: Sepse do të kemi parasysh që dialektet e Shqipërisë gjatë pesë shekujve kanë kryer evolucionin e tyre, dhe se më anë tjetër edhe ligjërimet e Italisë kanë evoluar në kohë ndonëse në një masë më të pakë.

Sikundër shihet, afrimet e arbërishtes së Italisë me atë të Greqisë e me gegërishten e moçme të Veriut janë të një karakteri sinkronik. Afria dialektogjeografike me toskërishten jugore (jugperëndimore) paraqitet për ne sot më fort diakronike, veçse gjithsesi specifike. Ndër tiparet e përbashkëta të kësaj fushe të fundit ka dhe elemente ruajtjeje dhe elemente risimi (inovacioni): sepse këto dialekte jugore kishin kryer risime qysh në kohën para shpërnguljes së një pjese të tyre për në viset e Greqisë e të Italisë.

Në lidhje me gjendjen në atdheun e ri, për këto dialekte është qenësore kjo që ato në pjesën më të madhe janë ishuj gjuhësorë. Megjithëse në marrëdhënie me ligjërimet arbëreshe fqinje, këto dialekte janë të rrethuara prej mjedisit roman, e kjo ka qenë vendimtare në punë të gjuhës. Simbioza në shumë rase ka nisur që në fillim të nguljes në trojet e reja:

sikundër dëshmohet me anë të dokumenteve të kohës, në disa vise të Kalabrisë ardhësit e rinj u vendosën nëpër katunde që ekzistonin më parë, duke i populluar rishtas ato katunde¹). Kemi të bëjmë kështu gjithkund me gjuhë në kontakt, dukuri që vetvetiu sjell me vete ndikime të ndërsjellta: më një anë ndikim dërrmues i italishtes, me asimilimin e një pjese të arbërishtes në rrjedhë të shekujve; më anë tjetër — në një masë shumë më të kufizuar — integrim i ndonjë elementi roman në bashkësinë arbëreshe, pjesërisht me anë të marte-save. Edhe ndonjë leksemë e shqipes ka kaluar në dialektet italiane fqinje, si p.sh. në Akri e gjetkë në Kalabri *cullacciu* «pasta di farina intrecciata a corona, nel Cosentino una treccia fatta di fichi, e la torta composta degli avanzi della pasta di pane che si cuoce nella cenere», «sorta di pane intrecciato a corona sormontato da un uovo, treccia di fichi»²). Simbioza e përherëshme ka sjellë që sot — me ndonjë përjashtim të rrallë, te ndonjë grua në moshë, e më fort pa shkollë — arbëreshët janë dygjuhësh, bile edhe trigjuhësh, duke zotëruar përveç italishtes edhe dialektin italian të vendit. Shkalla e përzierjes gjuhësore është e ndryshme në dialektet e ndryshme arbëreshe. Ndikimi i italishtes e i dialekteve të saj, shumëkund i është përshtatur strukturës fonetike e morfologjike të shqipes, duke mbetur shqipja dhe italishtja në vetëdijën e folësit dy sisteme gjuhësore më vete. Vise-vise ndërkaq italishtja ka depërtuar dhe në strukturën fonologjike e gramatikore, duke kontribuar kështu në varfërimin e elementit shqiptar të tyre. Në pikëpamje sociolinguistike mendimi i F. Pullésë «l'albanese invece conservasi solo dalle cassi elevate»³) nuk më duket kryekrejtë i drejtë. Kam vënë re përkundrazi se bash njerëzit e thjeshtë të popullit përdorin një gjuhë më të pastër nga ndikime italiane se njerëzit e shkolluar dhe inteligjenca e vendit. Përveç faktorëve socialë e kulturorë, edhe faktorë fetarë kanë luajtur një rol në punë të asimilimit si dhe të rezistencës gjuhësore. Ndërsa tek elementi

1) Zangari, 62 vv.

2) V. Dorsa, *La tradizione greco-latina nei dialetti della Calabria Citeriore* (1876) 30. — G. Rohlfs, *Dizionario Dialettale delle Tre Calabrie*, 249. — Autori, *Revue Internationale des Etudes Balkaniques* III/II (1938) 559 vv.

3) *Italia, genti e favelle* III (1927), 411.

arbëresh i Greqisë besimi ortodoks, i përbashkët atje me atë të mjedisit grek, ka ndihmuar në asimilimin gjuhësor, në Itali përkundrazi vihet re se ky besim, me formën e tij të rritit grek unit, ka qenë një faktor konservimi të gjuhës, dhe se kthimi në ritin latin ka shpejtuar asimilimin etnik e gjuhësor. Do përmendur se edhe rrethanat korografike të ngulimeve të veçanta nuk kanë mbetur pa ushtruar një ndikim në këtë pikëpamje. Nëpër vise malore e larg qarkullimit, kostumet, dotket e zakonet bashkë me gjuhën e me besimin u kanë ruajtur më mirë; në krahina fushore si në Apuli, asimilimi, me ndonjë përjashtim të rrallë (S. Marzano), është kryer që heret¹). Gjë e shënueshme, dhe jo pa rëndësi edhe në punë të ruajtjes së gjuhës, është edhe mbajtja gjallë e vetëdijes historike, e ndjenjës së rrjedhës prej Shqipërie²).

Kështu paraqitet tani në vija të përgjithshme gjendja etnografike e shoqërore e elementit shqiptar të Italisë. Ky element banon sot në trevat Abruce, Molize, Kapitanata, Bazilikata, Apuli, Kalabri të Italisë Jugore e në Siqeli, në afërsisht pesëdhjetë ngulime, me rreth 100.000 banorë. Ai e quan veten *arbëresh*, emri etnik i vjetër i popullit shqiptar, më i vjetër se emri i sotëm *shqiptar* dhe i gjallë edhe sot e kësaj dite dhe në atdheun mëmë edhe tek elementi shqiptar i Greqisë. Në rrethet italiane të vendit arbëreshët quhen shpeshherë *gjegji*. Ky emër nuk ka të bëjë, si ka menduar shumëkush, me emrin *gegë*. Ai reflekton përkundrazi foljen *gjegjem* «dëgjoj» të shqipes, përdorur aty shpeshherë me kuptimin «urdhëro», fjalë me të cilën përgjigjet një njeri kur e thërret tjetri me emër.

Megjë jemi në fushën e emrave, mund të përmendim se tek arbëreshët e Italisë janë të shpeshta ofiqet, si p.sh. *Mushku*, *Derri*, që u vihen individëve të ndryshëm, kur flitet për ta në mungesë të tyre, zakon që është më i rrallë në Shqipëri e që është vështirë të thuhet ku e ka gurrën dhe si e mori zhvillimin³). Në lidhje me emrat e vendeve do të thuhet se emrat e qendrave të banuara, emra katundesh si Vila (Villa Badessa) në Abrucet, Ungër (Lungro) e Mbuzát (S. Gi-

- 1) Për këto ngulime tani rishmë R. Parmegiani, *L'Albania Salentina Bollettino della Soc. Geogr. Italiana* 99 (1962), 397 vv.
- 2) Kl. Rother, *Die Albaner in Südtalien, Mittel. d. Österr. Geogr. Gesellschaft*. Bd. 110, Heft I (1968), f. 17 e botimit të veçantë.
- 3) Për ofiqet në Shqipërinë mesjetare M. v. Šufflay, *Arhiv za arb. starinu* 11 (1925), 220.

orgio) në Kalabri, dhe ato të emërtuara prej shenjtorësh sidomos të rritit oriental (S. Basile, S. Costantino, S. Demetrio, S. Sofia d'Epiro e ndonjë tjetër), pas gjithë gjasësh janë sjellë me vete prej atdheut ballkanik. Të tjera — dhe përbëjnë shumicën — janë të italishtes dhe janë marrë prej mjedisit roman. Sa për emrat e arave, të lëndinave, pyjeve, rrjedhave të ujit etj., të cilat pjesërisht janë shqip e pjesërisht italisht, duhet të shënohet që emrat shqip përgjithësisht kanë mbetur në përdorim të brendshëm të ngulimeve arbëreshe dhe nuk kanë depërtuar në mjedisin italian që i rrethon. Kjo është në kundërshtim të dukshëm me gjëndjen në Greqi, ku toponimet shqiptare janë ngulur e kanë marrë përdorim të përgjithshëm edhe në gojë të mjedisit grek. Një dëshmi kjo edhe nga ana e onomastikës që elementi shqiptar i Greqisë shumëkund ka populluar vise të pabanuara, e që ai i Italisë — si u tha edhe më lart, — nguli shpesh në vise ku ekzistonte një popullsi lokale.

Në pikëpamje të kulturës dihet mirëfilli, dhe nuk është vendi të shtjellohet këtu më tej, që elementi arbëresh i Italisë ka trashëguar një pasuri të shënueshme visaresh folkloristike, e cila në pjesën e saj të lashtë rrjedh prej mesjetës së vonë. Si e tillë, ajo përmban elemente me rëndësi për historinë e folklorit shqiptar dhe të marrëdhënieve të tij me folklorin e popujve fqinj ballkanikë të asaj kohe. Krahas me këtë, elementi arbëresh ka bashkëvepruar në mënyrë të shquar në zhvillimin e literaturës shqiptare, me disa vepra nga më të vlefshmet të kësaj literature, të denja të hyjnë edhe në literaturën evropiane.

II

Po kalojmë tani në disa fakte konkrete të gjuhës.

Në sistemin fonetik, përveç melodisë së frazës që u zu ngoje më lart, vërehet pikësëpari ruajtja e opozicioneve në kuantitetet të rrokjeve të theksuara: tipar arkaik e specifik njëkohësisht, duke pajtuar arbërishtja më një anë me gegërishten, më anë tjetër me toskërishten jugperëndimore. Me një pjesë të mirë të ligjërimeve të këtij grupi dialektor të fundit afrohet arbërishtja edhe me palatalizimin e zanores *ʎ* në *i*, në rasi *sī* për *sȳ*, me reduktimin e grupit konsonantik *xv* në *x*, si p.sh. në *xerk* për *xverk* (i cili ndërkaq rishfaqet edhe në shqipen e Greqisë) dhe me asimilimin e shpeshtë

të grupit *tn*, *ju flini*, *vrini* për *flitni*, *vritni*¹). Veçanërisht me ndonjë shqiptim të Bregdetit pajton shqiptimi i zanores së mesme ë si o në ndonjë dialekt të anëve të Katancaros në Kalabri Jugore e më anë tjetër shurdhimi i spirantit *j* në pozicion fundor, dhe brenda fjalës me rrokje të mbyllur, në spirantin palatal të shurdhëtin të Hora e t'Arbëreshvet (Piana degli Albanesi) në Siqeli, si në *má* për *maj*²). Këtyre u shtohen disa forma specifike, si *dreq* për *drejt*, *kulish* për *këlysh*, fjalë si *děj* «pasnesër», *kosdej* «tjetërpasnesër», *tëtim* «të ftohtit» e shumë të tjera.³) Trajtimi i likuidave *l* e *lj* dhe i grupeve të hershme *kl*, *gl* e *lk*, *lg* paraqitet i ndryshëm në ligjërimet e ndryshme. Në trevat gege (më fort të Shqipërisë së Mesme se Lindore) çon zbutimi i likuidës *l* në gjysmëzanore *j* pas labialeve *p*, *b*, *f*, *v* në dialektet e luginës së lumit Krati në Kalabri Qendrore, në fjalë si *pjot*, *bjej*, *fjamur*. Atje çon edhe ndonjë formë si *opangë* për tosk. *opingë* në këtë krahinë, dhe *katërdiét* «dyzet» e S. Marzanos në Apuli, toskërisht *dyzét*. Në çdo rasë me rrjedhë ballkanike është kalimi i likuidës velare *ll* në aspirantin velar të zëshmin *gh* (ɣ) të Hora e t'Arbëreshvet, në Siqeli dhe në dialektet arbëreshe të Molizes, në fjalë si *mogha* për *molla*. Kjo dukuri shfaqet vise-vise dhe në shqipen e Greqisë, ku si *gh* e ku si *v*⁴). Ndeshet dhe në ndonjë ligjërim të aromunëvet.

Në strukturën morfologjike, një veti konservative në sistemin emëror është ruajtja e asnjansit në kundërshtim me zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës në Shqipëri, ruajtje që ka çuar bile dhe në përfitim sekundar të disa asnjansëve⁵). Një dukuri konservimi është edhe ruajtja e temave femë-

- 1) Për *tn* : n Kamarda I 258, H. Pedersen *Alb. Texte mit Glossar* (1895) 13, autori *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria shkencat shoqërore* XII (1958) Nr. 1, f. 74 v., M. Totoni *Studime filologjike* XVIII (I), 1964, f. 143 dhe të *Dialektologjia shqiptare* I (1971) 55; Q. Haxhihasani të *Dialektologjia shqiptare* I, 156.
- 2) Gjurmë të këtij shurdhimi edhe në dialekt të Salaminës në Greqi, *gl'unxtë* «gjunjët», *minxtë* «minjtë», *thonxtë* «thonjtë», të Cl. Haebler, *Gramatik der alb. Mundart von Salamis* (1965), 69.
- 3) Khs. autorin në *Serta Romanica, Festschrift für G. Rohlfs zum 75. Geburtstag* (1969), 116 v.
- 4) Kamarda I, 80, Lambertz KZ 51 (1923), 280vv.
- 5) Autori, *Buletin për shkencat shoqërore* 1955 Nr. 3, f. 40 vv., Sh. Demiraj. *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe* (1972) 94vv.

rore konsonantike, tipi *djepja, kriqja*¹⁾. Karakteristike për arbërishten e Italisë është përhapja analogjike e shumësit të emrave mashkullorë më *-ra, -ëra*, tipi *regjra* «mbretër», që me *-a-në* e saj gjan të jetë zhvilluar më tej në Itali; në Labëri e në Çamëri kjo formë shumësi paraqitet me *-ër, -ëre, -(ë) ra*, po *-ër* është mjaft e përhapur në mbarë toskërishten, gegërisht *-ën, -ëna, -na, mbretër mbretën, drithëra drithna*²⁾. Një tjetër tipar karakteristik, i përbashkët me dialektet e toskërishtes jugore dhe të Greqisë, e përbëjnë shumëset me metaforë *a : e*, tipi *thëtëra* «të thatë», *të glet* «të gjatë», *të lert* «të lartë»³⁾. Një tipar arkaik ruhet ndërkaq në format më *-shit* të rrjedhore shumës, (*diershit*), ku arbërishtja piqet me gegërishten e vjetër e me disa dialekte të toskërishtes jugore. Te numërorët themelorë është karakteristik zhvillimi i mëtejme i sistemit vigesimal (njëzetsh), pas *njzëzët* e *dizët* edhe *trezët* «gjashtëdhjetë», *trezetedhjetë* «shtatëdhjetë», *katërzët* «tetëdhjetë». Një dukuri e tillë ndeshet edhe në shqipen e Greqisë (*trezët, katërzët*), gjen ndonjë analogji sporadike edhe në poezinë popullore të Shqipërisë së Veriut.

Në sistemin foljor bie në sy përhapja analogjike e mbarësës *-ta* shumës *-tim* etj. e aoristit (*lajta, piqta, shkruajta, erthtim* etj.), në dëm të më së përgjithshmeve *-va*, e *-a*, si dhe e pjesores (*thertur*), një përkim sidomos me ligjërimet e Greqisë, Bregut të Detit, Labërisë e Çamërisë, përgjithë-

- 1) Autori në *Lingua Posnaniensis VIII* (1960), 113 vv., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* (1967) 136vv., *Revue de Linguistique VII* (1962), 190, *Studime filologjike XXVIII* (XI) 1974, Nr. 2, f. 42.
- 2) Kamarda I 200, Gius. De Rada *Gramatika* 12 vv., Lambertz KZ 51, 73v. — K. H. TH. Reinhold, *Noctes pelagicae* (1855) 6, Haebler 60, — M. Totoni, *Studime filologjike XVIII* (I) Nr. 1, f. 147. XIX (II), 1965 Nr. 3, 107v. dhe te *Dialektologjia Shqiptare I*, 61v., 63. Q. Haxhihasani te *Dialektologjia Shqiptare I*, 167, 168. — G. Meyer, *Alb. Studien I* (1883), 101 vv., *Kurzgefasste alb. Grammatik mit Lesestücken und Glossar* (1888) 10; Dr. Pekmezi *Grammatik der alb. Sprache* (1908), 101.
- 3) G. Meyer *Alb. Studien I* 105 v., A. Xhuvani te *Kopështi letrar I* Nr. 1 (1918) 7; autori *Lingua Posnaniensis VIII*, 125 v., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 151v. me literaturë (Gius. de Rada, Furikis); M. Totoni, *Studime filologjike XVIII* (I) Nr. 1 f. 147. XIX Nr. 3, f. 108, *Dialektologjia shqiptare I*, 62v., Q. Haxhihasani, *Dialektologjia shqiptare I*, 165v.

sisht të toskërishtes jugperëndimore, aty kryesisht në shumës, *lëpijti, múartim, ndajtim, blejtim, deftojtim, vartur*, në shqipen e Atikës *thiejta*.¹⁾ Te aoristi sigmatik në një perioidë të caktuar të gjuhës ka ndodhur një risim që mund të quhet ndërdialektor: në vetën e parë të njëjësit në disa dialekte është zhdukur forma me sufiks -s (shqip *-shë*), në mënyrë që kjo paraqitet e barabartë me atë të vetës së dytë; khs. këngën popullore *O e bukura Moré, Çë kur të lé Më nëng të pé* «Që kur të lashë, më nuk të pashë», që u përmend më lart. Aty arbërishtja e Italisë piqet me përdorimin e autorëve të vjetër të Veriut, te Gjon Buzuku p.sh. *lae* «lashë» edhe «le», *pae* «pashë» edhe «pe», te Fjalori i F. Bardhit (f. 223) *i lae* «i lashë», forma me ruajtje të plotë të grupit zanor *ae*; në të folët e Dibrës në vetën e dytë *më dhá* «më dhe», *më thá* «më the» me reduktim të këtij grupi në një *a të gjatë*, reduktim i rregullt në një pjesë të mirë të gegërishtes²⁾. Me pjesoren më -m shpeshherë me vlerë mbiemërore (e *bekúame*, F. Santori *i shtruam* «prostrato», kudo i *déjm*, në Greçi i *martuam* etj.) e me format e tjera të pjesores arbërishtja ruan forma e përdorime të trashëguara të gjuhës, duke u afruar edhe këtu me gegërishten e me disa ligjërime periferike të toskërishtes jugore.

Një vëmendje të veçantë meriton morfosintaksa. Edhe aty na dalin përpara disa dukuri të një periode më të vjetër të gjuhës, krahas me bjerrje dhe me disa përkime specifike.

Nga të dyja nyjat që ka shqipja: nyja e mbrapme shquese (*mal-i*) dhe nyja e parme (*i malit, i mirë* etj.), mund të thuhet me siguri matematike që e para është me moshë prehistorike, kjo e dyta më e re, e sekundare. Kjo ka dalë gjatë periodes historike, po gjithmonë paraletrare të gjuhës, prej nyjës së mbrapme, me një përsëritje të kësaj në ngërthim të fjalisë, në sandhi. Përftimi dhe zhvillimi i mëtejme i nyjës së parme në kategoritë e ndryshme të sistemit emëror (emër, mbiemër, përemër, numëror) ka lidhje me

1) Kamarda I 241 vv., 148v.: Lambertz KZ 52, 63v. e 70; Reinhold 39; Weigand *Balkan — Archiv* II (1926) 201; Pedersen *Alb. Texte mit Glossar* 15v. e 18; M. Totoni, *Studime filologjike* XVIII (I) Nr. 1, f. 152 XIX (II) Nr. 3, f. 112, *Dialektologjia shqiptare* I 72, 75; Q. Haxhihasani, *Dialektologjia shqiptare* I 182, 185.

2) Khs. edhe F.M. da Leccen *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese* (1716) 140, Kamardën I, 239; v., autorin «Meshari» i Gjon Buzukut» I (1968), 29.

disa dukuri të ekonomisë gjuhësore e bashkë me të edhe me prirjen e një hiperkarakterizimi; sidomos u krijua me këtë një mjet fleksioni, në pasojë të bjerrjes së mbaresave të lashta të sistemit emëror në rrjedhë të zhvillimit të brendshëm të gjuhës. Në këtë mes mosekzistenca e nyjës së parme në arbërishten e Italisë në ato rase ku kjo në shqipen e sotme letrare është rregull, pasqyron një gjendje gjuhësore të mëparme. Khs. p.sh. jo vetëm të *rrushit ëmbëlj*, po edhe *Dielja e Pashkvet* (B. Bilotta)¹⁾, *tū bilj* «bijtë e tu» (G. De Rada), *tū vghezër* «fratres tui» (G. Kamarda). Aty arbërishtja piqet më një anë me mbarë literaturën e vjetër, më anë tjetër pjesërisht dhe me gjuhën e sotme popullore; khs. prej GJ. Buzukut *t'párëvet priftënet* «principibus sacerdotum», prej P. Budit e *gjenisë tyne*, prej F. Bardhit *Mjeshtrit pëllasit*, prej P. Bogdanit *vâlëvet detit* etj. Krahas me këtë dukuri është për të përmendur që arbërishtja, bashkë me literaturën e vjetër të Veriut e me disa dialekte të Veriut e të Jugut, merr pjesë në përdorimin e një nyjeje të parme para emrave etnikë. Përdoret kështu i *arbëresh*, te P. Budi i *arbëneshë*, në *Veri i Shalë*, në *Jug i Gusmár* etj.²⁾

Nga fusha e emrit, një tipar i vjetër i arbërishtes së Italisë përmbahet te mënyra e formimit të emrave kryesisht abstraktë. Aty vihet re se përdorimi i mbiemrave të substantivuar dhe i emrave foljorë të substantivuar mbizotëron tejet mbi substantivat e formuar sidomos me prapashtesat *-im* edhe *-esë* (*tipi shkërim*, *martesë*), të cilat, bashkë me formantin *-je* (*lindje*, fare në *Jug -lë*, *veshlat* «veshkët»), në një periudë të mëpastajme kanë marrë një përhapje që mund të shtrihet pa fund. Arbërishtja e Italisë (bashkë me atë të Greqisë) historikisht këtu qëndron në një shkallë me literaturën e vjetër të Veriut, e më anë tjetër dhe me gjuhën popullore të sotmen, sidomos të fushës dilektore. Këto fusha gjuhësore përkëndeje e përandeje detit jo se nuk i njohin fare formimet me këto prapashtesa, po nuk kanë marrë më pjesë në zhvillimin e mëtejme të tyre, të kryer në rrjedhë të modernizimit të gjuhës e të një përdorimi më të madh të mje-

1) Te E. Giordano, *Folklore albanese in Italia* (1957), 9.

2) Për historinë e nyjës së shqipes autori, *Studii si cercetări lingvistice* X (1959), 531vv., *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës Seria shkencat shoqërore* XVII (1963) Nr. 3, f. 73vv., 102vv., *Actes du Premier Congrès International des Etudes Balkaniques et Sud-est Européennes* VI (1968), 613v.

teve abstrakte të saj. Gjejmë kështu te Lekë Matranga prej Sigelie (1952) të *dáshurë* «carità»¹⁾, sikundër gjejmë te Buzuku *n së dashunit së bótësë sanë* «prej dashurisë së atdheut tonë», te Bardhi të *dáshunë* «amor». Buzuku ka dhe *e të madhtë e Libanit anshtë dhanë atyne e të bárdhëtë e malit Karméliesë e fúshësë Saronit* «gloria Libani data est ei, decor Carmeli et Saron», ku lat. *gloria* është dhënë shqip me të *madhtë*, decor «stoli, hijeshi» me të *bárdhëtë* në vështrim të figurshëm. Ashtu ky autor dhe lat. *iniquitatem* «padrejtësinë» e shqipëron me të *shtrëmbënëne*, Bardhi lat. *caecites* «verbësi» me të *vërbëtitë*, *macies* «të qënët thatiq» me të *ligunitë*, Bogdani *la distanza* me të *lárqëtë*. Nga ligjërimet e diasporës, me këto forma mund të krahasohen të *plotit*, emri i një tëmble te Hora e t'Arbëreshvet (Piana degli Albanesi) në Sigeli, të *lierit* «lyra» po, aty, e cila i përgjigjet formës të *lyer* të Vlorës dhe formës *tëlyen* «gjalpë» të gegërishtes; pastaj *ndë një plaf ndë një të shtruam* «në një plaf në një shtresë» në një këngë popullore të ishullit Hidra në Greqi, *ti ke të drejtë* në Shqipëri, e të tjera si këto²⁾. Literatura e vjetër e Veriut, si shprehje gjuhësore e një kulture qytetare lashtërisht të trashëguar, në këtë lëmë përdorimesh të ndryshme ndërkaq nganjëherë del më e përpuar se arbërishtja e Italisë. Kështu p.sh. Buzuku lat. *ut videant vestra bona opera* e jep shqip me *përse ata të shóhënë vëpëratë e mira túojtë*, pra substantivin *opera* me refleksin e tij në shqipen *vëpëra*. Ashtu edhe Kristoforidhi në përkthimin e tij (1872), Grigori (1823) *me rúnëratë tuaj të míratë* $\mu\acute{\iota}\omega\nu\ \tau\acute{\alpha}\ \kappa\acute{\alpha}\lambda\acute{\alpha}$ ($\tau\acute{\alpha}\ \kappa\acute{\alpha}\lambda\acute{\alpha}\ \sigma\acute{\alpha}\varsigma\ \acute{\epsilon}\rho\gamma\acute{\alpha}$) Zef Kamarda prej Sigelie përkundrazi e jep këtë fjali me *satë shóxëjënë të bëmat e mira túajtë*, me emrin foljor të *bëmat*³⁾; khs. me këtë formë shprehien *me fjalë e me të bëme* «me fjalë e me vepra» të anës së Bregdetit, edhe *një e pabëme* «një vepër e keqe» (vrasje eti.) në të folët e Gjirokastrës. Këta shembuj mjaftojnë për të treguar që ashtu si fonemat në fonologji, edhe morfemat në morfosintaksë dhe leksemat në leksikologji do të vështrohen në vlerën e tyre funksionale, në lidhiet e tyre të shoqishoime dhe në opozicionet e tyre, në luftën që kanë pasur ndërmjet tyre në rrjedhë të zhvi-

1) M. Sciambra, *La «Dottrina Cristiana» albanese di L. Matranga* (1964), 208v.

2) Autori, *Buletin për Shkencat Shoqërore*, 1955, Nr. 3, f. 44 v.

3) Il Vangelo di S. Matteo tradotto dal testo greco nel dialetto di Piana de' Greci in Sicilia da un nativo di questo luogo (1868), 14.

llimit të gjuhës, shpeshherë me fitoren e njërave dhe me tërheqjen ose me zhdukjen e të tjerave.

Një tjetër mbeturinë e një faze gjuhësore më të parme paraqet kongruenca e përcaktorit të emrit me emrin vetë jo vetëm në gjini e në numër, po edhe në trajtë të rasës (koncinitët). Gjejmë kështu te Lekë Matranga e *ështravet tîreve*, te De Rada *Ljûmravet të kâljlthêrvet*, sikundër gjejmë te Buzuku e *ûjênavev gjállave* «aquarum viventium», te Budi *anëmiqet mive*, te Bardhi *zotënivet Gardhinajet*, te Bogdani *bjëshkëshish fort së naltash*, në anët e Gjakovës *shokve tmi-ve*.¹⁾ Do shënuar ndërkaq se në gjuhën e atdheut mëmë ashtu edhe në atë të arbërishtes së Italisë kjo fazë gjuhësore është tashmë e kapërcyer. — Në punë të përcaktorit të emrit arbërishtja e Italisë zbaton edhe një tjetër rregull të moçme të morfosintaksës së shqipes, sipas së cilës ndër dy përcaktorë të një emri njëri përdoret në trajtë të shquar. Kështu G. Rohlfsi dëshmon për të folët e Acquaformosas në Kalabri *vajza vogil jotja*, ndërtim të cilit toskërishtja popullore e sotnja i përgjigjet me shquarje të tjetrit përcaktor, *vajza jote e vogla*.

Përemrat e mbiemrat pronorë kanë pësuar në shqipen në këta shekujt e fundit shumë rrafshime, shkaktuar kryesisht prej procesesh të analogjisë. Disa forma janë përhapur në dëm të disa të tjerave; këto janë zhdukur nga përdorimi i përgjithshëm, duke mbijetuar vetëm tek autorët e vjetër të Veriut e në ndonjë dialekt të izoluar. Arbërishtja e Italisë, sidomos në disa ligjërime e në fazat e saj të përparmet, edhe aty paraqitet mjaft konservative, më konservative se gjuha e dheut mëmë edhe se ajo e Greqisë. Në ligjërimet arbëreshe ruhet pra ende opozicioni i formave për të dalluar numrin e pronës, *qetë tāj* «qetë tuaj» përballë *bleva kálinë tēj* «bleva kalin tuaj»²⁾. Po arbërishtja tregon këtu një individualitet edhe më të theksuar. Te format që shënojnë pronën mbahet opozicioni funksional jo vetëm në numër, po edhe në gjini. Kështu p.sh. femërorja e shumësit *me shkruámet tot* «me shkrimet e tua» (B. Bilotta),³⁾ *arat tote* «arat e tua» aëndron jo vetëm përballë formës së njëjësit *ara iote* po edhe përballë mashkullores shumësit *miqt e tú*, dallim

1) Autori, *Buletin për Shkencaat Shoqërore*, 1955, Nr. 4, f. 123v., «Meshari» i Gjon Buzukut I, 20.

2) M. La Piana, *Studi linguistici albanesi, Varia* (1949) 71.

3) Te E. Giordano, *Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë — Dizionario degli Albanesi d'Italia* (1963) s. v.

që shqipja moderne mjaftohet ta kryejë me anë të mbaresës -a të femërores së shumësit, *shokët e tu, shoqet e tua*. Kështu edhe *nipi i j* «nipi juaj» qëndron përballë formës *vera juaj*. Dhe vetëm e pronës mashkullore të shumësit është forma e moçme tāj në nipt tāj, «nipat tuaj»¹⁾ e krahasueshme me *bijtë taj e białtë tuoj* «filii vestri e filiae vestrae» të Gjon Buzukut. Meqë përemri pronor i shqipes paraqet një kompozitë të përbërë prej përemrit dëftor dhe përemrit vector në rasë të zhdrejtë (gjinore), forma *tot, tote*, e cila pas dijes sime përveçse në arbërishten e Italisë nuk shfaqet kurrkund në fushë të shqipes, përmban -to si në *atò* dhe -te si formë reduktimi të tÿ, duke bërë *tot, tote* rimë me *jot, jote*. Do përmendur ndërkaq që në mjaft ngulime, nën ndikim të italishtes me rrugë analogjie u ka rrafshuar larmia e madhe e formave të përemrit pronor të arbërishtes. — Duke mbetur në lëmin e përemrit, mund të përmendet këtu edhe një tjetër formë kompozimi, po më e re se *tot, tote*, dhe mbase një formim spontan i kryer në Itali: Në ligjërime të Pianës në Siqeli është në përdorim përemri i identitetit *vetë-jotja* «vetja jote», shumësi *vetëjújaja*, univërbime të *vetja jote, vetja juaj*. Për Kalabri Gius. De Rada (Gramatika 1871 f. 35) jep edhe vetëmëa «il mio essere, vetja ime», *vettësái* «a suo essere, vetes së saj» etj.

Nga fusha e sistemit foljor, në shqyrtimin e shkurtër të të cilit po kalojmë, një vëmendje të veçantë meritojnë pikësepari disa kohë të foljes.

Giuha që përdoret sot në atdheun mëmë, si në të folur si në shkrim, përgjithësisht ka rrafshuar prej kohësh opozicionin midis formës të së tashmes dhe asai të pjesores të klasa e folieve që mbarojnë me likuidë. *sjell: kam sjellë, tierr: kam tierrë* etj. duke denërtuar forma e pjesores edhe në të tashmen. Arbërishtja e Italisë ruan këtë opozicion të një shkalle të përparme të gjuhës duke shkuar aty kraher për kraher me autorët e vjetër të Veriut e me disa dialekte të sotme periferike e si të tilla konservative, duke përfshirë aty dhe ato të Greqisë: *sjell, viel, nxier, tier, zbier* «bjerr, humb» përkundërt *kam sjellë, kam vjelë, kam nxjerrë, kam tjerrë, kam zbjerrë*. Duket prandaj se rrafshimi analogjik u ka përgjithësuar në dialektet e Shqipërisë në kohën pas shpërnguljes shqiptare për në Itali.

1) Te G. Rohlfs, *Sprach- und Sachatlas Italiens und der Südschweiz I* (1928), 21, khs N. Jokl IF 49 (1931) 276.

Në lidhje me format e së ardhmes (futurit) dhe me funksionet e tyre mund të thuhet shkurt sa vijon. Dihet se shqipja nuk ka një formë foljore të vetën për të ardhmen. Për të shprehur një veprim të ardhëm përdoret, si në shumë gjuhë, e tashmja e dëftores, te Gjon Buzuku shpeshherë e tashmja e lidhores, mënyrë e cila sintaktikisht afrohet fort me të ardhmen. Në fushën indoevropiane nuk ekziston një formë e përgjithshme e së ardhmes. E ardhmja sigmatike dihet mirëfilli se është vetëm e disa gjuhëve, si e indoiranishtes, lituanishtes e greqishtes. Shumica e gjuhëve indoevropiane, ndër to gjuhët gjermanike e sllave dhe hetitishtja, kanë lentuar (krijuar) të ardhme të veta si risime të periodës së tyre postetnike, vetiake¹⁾. Edhe për shqipen asgjë nuk dëshmon që të ketë pasur dikur një formë të vetën të së ardhmes të trashëguar prej kohësh të lashta. Format e sotme të së ardhmes janë lentime (krijime) të periodës historike të saj. Sikundër dihet prej kohësh, ashtu si dhe disa të tjera gjuhë ballkanike, shqipja i ka të dyja trajtat e kësaj kohe foljore, edhe të ardhmen e tipit *kam* «habeo», të formuar me *kam* + paskajore, edhe atë të tipit *volò*, të formuar me *do* (nga *dua*) + lidhore e tashme. E para dëshmi e datuar e së ardhmes më *do* (të), nga sa di unë, është ajo që na ka lënë kalorësi Arnold von Harf prej Koelnit të Gjermanisë; ky, duke kaluar gjatë vitit 1497, me rrugë detare, nëpër bregdetin shqiptar (ishte nisur prej qytetit të tij të lindjes një vit më parë), shënoi ndër të tjera fjalinë *do daple* «wyl it gelden», d.m.th. *do ta ble* (fjalorthi i Harffit është riprodhuar së fundi te Mario Roques, *Le dictionnaire albanais de 1635*, f. 48-49, 1932). Është vënë re gjithashtu, megjithëse më pak është e ditur, që të dyja tipet janë në përdorim në të dyja dialektet kryesore të shqipes, dhe në gegërishten dhe në toskërishten²⁾. Ndryshimet janë më fort të karakterit funksional, duke mbizotëruar tek e ardhmja me *do*, *do të* koncepti vullnetor (voluntativ), te ajo me *kam* koncepti i domosdoshmërisë a i detyrës, aq sa mund të thuhet se shpeshherë aty nuk ekziston më ideja e një veprimi të ardhëm; vihet re ndërkaq që aty ka dhe interferenca, bile edhe përmbysje të funksioneve, duke pasur e ardhmja me *do* (të) në fushën

1) Khs. edhe W. Porzig, *Die Gliederung des indogermanischen Sprachgebiets* (1954), 88.

2) N. Jokl, *Litteris* IV (1927) 209; M. La Piana, *Studi linguistici albanesi* I (1939) 151.

dialektore shpeshherë kuptimin e një veprimi të prerë, të domosdosë, *oda do të mëshihet, zjarri do të ndizet*. Në pikëpamje dialektgjeografike do të shtohet edhe se e ardhmja e ndërtuar me *kam* + paskajore mbizotëron në gegërishten sidomos të pjesës veriore, e ardhmja me *do* në toskërishten e gegërishten jugore. Brenda kësaj përndarjeje dialektore është për të vënë re se arbërishtja e Italisë i njeh të dyja tipet e së ardhmes, veçse me një mbizotërim të qartë të tipit me *kam*, ndjekur prej lidhore, ndonëse ky dialekt, sikundër u pa, i përket përgjithësisht toskërishtes. Aty në thelb kemi të bëjmë me një futurum necessitatis, me një domosdoshmëri. Ky funksion shfaqet që heret në këto dialekte. Gjejmë kështu në një mbishkrim varri të Hora e t'Arbëreshvet (Piana degli Albanesi) në Siqeli, të vitit 1606, *Kujtoui se ke të vdeç, të silësh botë «Memento mori», te Rap-soditë e De Radës gjindet u kam vette «unë duhet të vete», te K. Belushi Kije bes se ke të garronesh «Beso se do të harrohesh, se ke për t'u harruar» etj. Kjo formë u zhvillua me kohë në të ardhmen e përgjithshme tek arbëreshët; khs. p.sh. nga shqipërimi i parabulës së djalit plangprishës në dialekt të Spezzano Albaneses në Kalabri *dua të vete tek tata im, e kam t'i thëm «Surgam, et ibam ad patrem meum, et dicam illi»¹⁾*. Forma më e përgjithëshme ndërkaq, është ajo që është e ndërtuar me foljen ndihmëse *ka* të vetës së tretë të njëjësit, e cila u shkri me pjesëzën të lidhore dhe ka kështu pjesëzën e pandryshueshme *kat, katë* si eksponent të së ardhmes²⁾, e krahasueshme funksionalisht me *do, do të* të përmendur më sipër; khs, p.sh. *kat vete* në Molize *si ka t shuxem? «si të ngushëllohem?»³⁾*. Në mbledhjet e mia nga Hora e t'Arbëreshvet në Siqeli p.sh. *Ma para se t'i shtiesh rrëndin ka marrm klumshtit ç'ka bunet gjiza. «Po para se t'i shtiesh mullëzën do të marrim qumështin që do të bëhet gjiza», ka të t qex përjashta «do të të çoj përjashta», se ka t'ia japë plaks se ka më japëj bishtin: qo ë xera çë ka vdes; kush jë, çë kë? — Çë ka këm? «Çdo të kem, quid habeam?. Që pranë kësaj forme ekziston, si u tha dhe ajo e së ardhmes të ndërtuar me *do, do të*, e dëshmojnë rasa të tilla si *Se nani Lázëri Ngë do t'ju vdesë; Prán i thash; sonte do vinj prej***

1) Angelo Nociti, te G. Meyer, *Kurzgefaste alb. Grammatik* 70 khs, edhe Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique* (1930), 184, shën. 3.

2) Kamarda, I, 266.

3) Lambertz KZ 52, 54 v.

Sicilie, u do martoxem prej Molizes etj 4). Ky dualizëm morfosintaktik i arbërishtes shtron disa probleme për historinë e shqipes e të dialekteve të saj. Fakti që në shqipen e Greqisë zotëron e ardhmja me *do, do të*²⁾, tregon që kjo kishte marrë formë në kohën e shpërnguljes shqiptare për në Greqi (e në Itali). Më anë tjetër te mbizotërimi i së ardhmes me *kam* në arbërishten e Italisë ndihet një ndikim nga ana e italishtes dialektore. Ndërtimi p.sh. *kan veshen* «bisogna che si vestano» i *Acquaformosas* është një përkthim, një kalk gramatikor i kalabrezishtes *s an a vestx*. Kemi të bëjmë me tipin e së ardhmes *habeo ad cantare*, që është karakteristik për dialektet e italishtes jugore, sidomos për Siqeli, Apuli, Lukani e për Abrucet, si p.sh. luk. *l.aggi' a manná*, tarent. *l'agghi' a mmanná*, siç. *l'ai a mmannari* për it. *lo manderò* «do ta dërgoj»; apul. jugore *aggiu ffare* «duhet të bëj», siç. lindore *aj a scriviri* «do të shkruaj», palerm. *am a ffari* «do të bëjmë», abruc. *ajj a purtà* «do të sjell», *avem'a purta, avet' a purtà etj.*³⁾ Format e këtij lloji ndërkaq nuk arrijnë të shpjegojnë mbarë sistemin e së ardhmes me *kam*. Një futurum necessitatis ndërtuar me *kam* edhe lidhore përdoret dhe në Shqipëri, në të folët e Dibrës p.sh. *kam të laj petka, kam të boj drekë*. Edhe i ashtuquajtur Anonimi i Elbasanit, vendi i prejardhjes dhe koha e veprimtarisë të të cilit nuk dihen, po që pas gjase është i shekullit XVIII, *ka e ti ke... të helmohesh tepër mbi gjithë gra të jetësë.*⁴⁾ Në lidhje me arbërishten e Italisë më rëndësi ka kjo, që — sikundër *del* nga gjurmimet e dialektologjisë shqiptare — ndonjë gjurmë e këtij tipi haset edhe në dialektet e Shqipërisë Jugore. Në ndonjë ligjërim të Bregdetit dhe të hinderlandit përkatës të Labërisë përdoret, ndonëse rrallë, ndërtimi *kam + lidhore* me kuptimin e një të ardhmeje të domosdoshmërisë, *kam të dërgój, ka të dërgój, kam t'i thom, ka të vër dhe ai pjesën e tij; kemi të japëm; me largim kuptimi ka të thotë «do të*

1) Te Z. Skirò, *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia* (1923) 286, Kamarda II (1866) 195, Lambertz KZ 52, 55.

2) Khs. P. Furikin, *'Αθηνα*, 45 (1933), 144.

3) Khs. për këto forma G. Rohlfs, *Historische Grammatik der Italienischen Sprache und ihrer Mundarten* II (1949), 384v.

4) Te botimi i I. Zamputit, *Buletin për shkencat shoqërore*, 1951, Nr. 3-4, f. 73. — Për datimin khs. M. Domin, «Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike», 271 vv.

thotë», *kan të thon* «duan të thonë»¹⁾, në ligjërimet e Çamërisë *kjo fjalë ka të thetë* «kjo fjalë do të thotë»²⁾. E njëjta formë rishfaqet dhe në shqipen e Greqisë, *Ka të flë tri katër nett*³⁾. Këto të dhëna të shikuara së bashku tregojnë se në kohën e shtegimit shqiptar për në Greqi e në Itali, në një pjesë të tokërishtes pranë së ardhmes me do ka ekzistuar një e ardhme e domosdoshë (futurum necessitatis) ndër-tuar me *kam* ndjekur prej lidhores së foljes që shpreh veprimin, e ardhme që — si u pa më sipër — ka edhe një vartër tjetër në gegërishten lindore. Këtë lloj të ardhme, pas gjase krahas me të ardhmen më *do*, mori me vete elementi shqiptar që u shkul për në Itali. Atje e zhvilloi më tej nën ndikim të një trajte analoge të mjedisit roman, kurse ky në Shqipëri Jugore gjellin tashmë si një mbeturinë, si një formë relikti. Kështu pra në formim të kësaj forme kanë bashkëvepruar pas gjase dy komponente, një që u soll me vete prej atdheut të vjetër dhe një që u mor në të riun nën ndikim të italishtes dialektore.

Një kalk gramatikor pas italishtes vërehet dhe në ndërtimin e pësore me anë të foljes *vinj*, si p.sh. në *vjen thritur* «vien chiamato, thirret, quhet». Një ndikim i tillë shfaqet edhe në literaturën e vjetër të Veriut, te Gj. Buzuku, p.sh. *qi parë se vjen ndukunë anshtë përvëlutotë* «quod priusquam evellatur exaruit»⁴⁾ Te P. Bogdani *vjen emënuem, vjen bām*⁵⁾. Këto ndërtime të autorëve në fjalë nuk janë të gjuhës popullore po janë ndikime savante të italishtes.

Nga fusha e morfosintaksës së foljes po përmëdim më në fund një ndërtim që është specifik për arbërishten e Italisë: shprehjen e tipit aktual e durativ (stativ) *isht e flë* «është duke fjetur», *ish e shkruaj* «po shkruante», në *Molize isht e ha buk e ishën e hajën*⁶⁾. Në *Acquaformosa* (Kalabri) *u jam e t'e jap* «io sto dandotelo, je suis en train de te le donner» te *Hora e t'Arbëreshvet* (Siqeli) *isht e bun te tirku* «është duke thurur çarapë», *u jam e shkruanj* «jam

1) M. Totoni, *Studime filologjike* XVIII (I), Nr. 1, f. 154, *Dialektologjia Shqiptare* I, 73.

2) Q. Haxhihasani, *Dialektologjia Shqiptare*, I, 183.

3) Reinhold, *Noctes pelagicae*, Antologjia, f. 9; khs. Sh. Demiraj *Studime filologjike* XXIV (VII), Nr. 3., f. 80.

4) Autori, «*Meshari*» i *Gjon Buzukut* I 32.

5) *Cuneus Prophetarum*. (1685) I 16, 21; 25, 25.

6) Kamarda I 329. — Lambertz KZ 52, 83 v.

duke shkruar, po shkruaj», *geni isht e ndron qimen; ishnë e vdisnë uriet; se jot ëmë isht e të dërgon te një vënt i lik*. Aty një ndikim i tipit it. *sto scrivendo* «jam duke shkruar, po shkruaj¹⁾» nuk është fort bindës. Struktura është e ndryshme në dy shprehjet, më një anë ndërtimi perifrastik i italishtes, më një anë parataksa ballkanike, megjithëse në katundin Greci të Apulisë, përdoret ndërtimi «jam ç qepinj «jam duke qepur», *jam ç lahem* «po lahem». Një ndërtim analog në trajtë e në kuptim me atë të italishtes shfaqet dhe në Shqipëri, *jam tuj punue*, nëpër dialekte shpesh thjesht *tuj punue*: Funkcionalisht — po jo në formë — shprehja arbëreshe *ish e therëj* «gati po e therte, stava per trafiggerla» afrohet me shprehjen *qe tue e vra* «gati e vrau» të gegërishtes veriore. Ndërtimi parataktit i arbërishtes i tipit *jam e shkruanj* i përmendur më sipër ndërkaq e ka gurrën gjetiu. Si ka treguar Gerhard Rohlf²⁾, në dialektet italiane të Apulisë Jugore për shprehjen e një veprimi që po kryhet, përdoret në mënyrë parataktike folja stare «*rrri*» së bashku me foljen që shpreh veprimin përdorur në mënyrën dëftore, si p.sh. *sta scrivi* «është duke shkruar, po shkruan», *sta mman-gia* «(ai) po ha», *sta ppone lu sole* «po përëndon dielli» (:«*rrri* përëndon dielli»), *la signura stia dduemia* «zonja ishte duke fjetur, po flinte» (:«*rrrinte* flinte»). Ky ndërtim rrjedh, si e ka treguar ky dijetar, prej greqishtes së Italisë, *estèi cé grafi ai* po shkruan (:«*rrri* e shkruan»), *estèi cé troi* «është duke ngrënë, po ha» (:«*rrri* e ha»), *stèo cé tro* «jam duke ngrënë», *ti stèi cé kanni?* «ç'po bën ti?» etj. Sikundër shihet, në ndërtimin arbëresh ruhet, ashtu si në greqishten, edhe lidhëza këpujore (kopulative), e cila sipas këtij dijetari në ndërtimin italian është shkrirë me fundorin vokalik të trajtës foljore *sta*, porse gjithsesi nuk është e dukshme. Ky ndryshim në formë nga një anë, e nga ana tjetër përhapja gjeografike e dy ndërtimevet — në italishten vetëm në Apuli Jugore gjer në anët e Barit, në arbërishten përkundrazi pothuaj në të gjitha dialektet, si të kontinentit si të Siqelisë — tregojnë që ndërtimi me *stare* i apulishtes as gjuhësisht as gjeografikisht nuk mjafton për të shpjeguar kënaqshëm këtë dukuri të arbërishtes së Italisë. Po të kthehemi nga dialektet e dheut

1) E. P. Hamp, *Actes du Premier Congrès des Etudes Balkaniques et Sud-est Européennes* VI 666. Khs. autorin, *Serta Romanica, Festschrift für G. Rohlf zum 75. Geburtstag*. 123.

2) *Griechischer Sprachgeist in Süditalien* (1947), 25v.

mëmë, aty ndeshim në ndërtimin parataktik rri e ... kryesisht të toskërishtes, në rasi si *rrinte e dëgjonte*, në një këngë popullore të sulotëve aty nga fillimi i shekullit të kaluar *natë e ditë rrimë e qajmë*, në një përrallë të Mitkos *Ama kur ata po rrinin e mendoheshin*¹, çam. *rrinej e mbanej vesh*²), ku folja rri është larguar prej kuptimit të saj të mirëfilltë dhe shpreh një aktionsart, aspektin e një veprimi durativ. Një veprim i gjashëm, veçse jo i barabartë me këtë, në disa dialekte të caktuara të gegërishtes, ndër to dhe ato të Kosovës (Rrafshi i Dukagjinit, Llapi e të tjera), shprehet me ndërtimin po ashtu parataktik *jam + parafjala ka, kah* ndjekur prej dëftores së foljes që shënon veprimin, *jam ka shkoj, se ti s'din shka je kah thue, jam kah des uni, s'jam kah i shkruej, a ka hjek* «po heq, po jep shpirt»³). Nga përdorimet që u përmendën këtu, më afër me atë të arbërishtes së Italisë ndërkaq qëndron ai i tipit *jeshë shturij bukët* i toskërishtes jugore⁴), dialekt që, si u pa, afrohet më shumë me atë degë dialektore; ky tip ndërtimi shihet se ndryshon nga ai i asaj dege vetëm në karakterin asindet, në mungesën e lidhëzës këpujore. Sikundër shihet, për ndërtimin parataktik me kuptim durativ *jam* e shkruanë të arbërishtes së Italisë nuk mungojnë analogji në dialektet e Shqipërisë. Mbi dëshminë e këtyre, edhe këtu, afërsisht ashtu si tek e ardhmja me kam që u trajtua më sipër, në mënyrë objektive do të mendohet zhvillimi i mëtejme në rrethanat gjuhësore të atdheut të ri i një prirjeje të sjellë me vete prej atdheut të burimit.

Duke përfunduar do të themi se edhe me këtë paraqitje nevojisht sumare, të përmbledhur, e cila është larg së rrokuri gjithë çështjet kryesore të arbërishtes së Italisë, shihet rëndësia që ka kjo degë dialektore për studimin e shqipes e të historisë së saj. Si një sistem gjuhësor i bartur në një sistem lloji të ndryshëm, kjo formë gjuhe ndërkaq është me interes dhe për dialektologjinë italiane, e përtej caqeve të kësaj disipline, edhe për gjuhësinë e përgjithshme dhe problemet e saj.

1) Te G. Meyer, *Kurzgefasste alb. Grammatik*, 64.

2) Te Pedersen, *Alb. Texte mit Glossar*, 78, 184.

3) Lambertz, *Bericht über meine linguistischen Studien in Albanien* (1916) 18, *Lehrgang des Albanischen I* (1954), 82; *Fjalor i gjuhës shqipe* (1954), 192

4) *Edukata e Re*, te St. E. Mann, *A Historical, Albanian — English Dictionary* (1948) 505.

PËR NJË SHITRESIM KRONOLOGJIK TË HUAZIMEVE TURKE TË SHQIPES

Me studimin e huazimeve turke në gjuhët ballkanike, ku hyjnë natyrisht edhe ato elemente (arabe, perse ose të tjera) që turqishtja vetë i ka marrë si huazim, lidhen disa probleme me rëndësi parimore. Aty së pari del çështja e shtrirjes gjeografike të këtyre huazimeve në gjuhët e veçanta të Gadishullit dhe në dialektet e tyre. Pastaj është puna të dihet nëse ndikimi gjuhësor i pushtuesve osmanë ka shkuar më thellë në disa prej këtyre gjuhëve se në të tjerat, dhe gjer ku ky ndikim ka lidhje me dallimet fetare e sociale. Një çështje tjetër do të ishte të dihet nëse gjuhët ballkanike kanë qenë ndërmjetëse duke i dhënë njëra-tjetrës ndonjë element nga lëmi i huazimeve turke. Një tjetër çështje themelore, me rëndësi edhe për historinë e kulturës, është puna e përndarjes së këtyre huazimeve në sferat e ndryshme të jetës dhe fushat e veprimtarisë njerëzore. Së fundi edhe caktimi i një kronologjie në marrjen e këtyre elementeve leksikore më duket të jetë me rëndësi për historinë gjuhësore — si për ballkanistikën dhe për turkologjinë — si edhe për lidhjet kulturore të gjuhëve të ndryshme. Kjo çështje për mua përfshin dy pika të veçanta. E para: Cilat huazime kanë hyrë më përpara, cilat më vonë? (kronologji relative). E dyta: A mund të caktohet përafërsisht koha e depërtimit të tyre? (kronologji absolute). Me këtë do të lidhej edhe çështja tjetër nëse të njëjtat huazime turke kanë hyrë afërsisht njëkohësisht në këto gjuhë.

Duke hyrë këtu pak më thellë në çështjen e kronologjisë, do të shënoj se — sikundër e kam shtjelluar disa herë para shumë vjetëve¹⁾ — për gjuhën shqipe dija është në gjen-

1) Albanologji (1947), Premier Congrès international des études balkaniques et sud-est européennes VI (1968) 47v.

djen e favorshme që mund të kryejë një farë shtresimi në punën e marrjes së elementeve turke, dhe aty në secilin nga dy drejtimet që sapo u përmendën. Kjo është e mundur të bëhet në saje të disa rrethanave historike krejt të veçanta. Sikundër dihet, para edhe gjatë kohës së luftrave të para të popullit me turqit nën prijën e Skënderbeut, dhe sidomos pas pushtimit të vendit nga osmanët, në Shqipëri pati një shpërngulje kryesisht për në Itali Jugore e në Sicili, e cila në një farë pikëpamje paraqet një vazhdim të shtegtimit shqiptar në drejtim të jugut për në Greqi. Ndërsa ky i fundit u krye më fort në kohën paraturke edhe në kohën e parë turke, ai tjetri në drejtim të Italisë është afërsisht një shekull më i ri. Ai u krye me valë e dyndje të ndryshme kryesisht rreth mesit dhe gjysmës së dytë të shekullit XV. Aty pati më vonë edhe disa dyndje për një pjesë të madhe prej Greqie (Moreje), gjatë gjysmës së parë të shekullit XVI si dhe gjatë të XVII-it. Prej shtresës së parë të shpërnguljeve rrjedhin ngulimet e sotme të Molizës, Kapitanatës, Apulisë, Kalabrisë e Siqelisë, prej shtresës së shekullit XVII disa katunde të Basilikatës. Më së fundi, sipas vrojtimeve të Maksimilian Lambertzit, rreth vitit 1744, nga banorët e katundit Piqeras të Bregdetit u themelua ngulimi Villa Badessa në Abrucet. Kolonitë arbëreshe të Italisë në pjesën më të madhe të tyre rrjedhin prej Jugut, prej Toskërie; veçse me kohë në shumë vise e kanë bjerrë gjuhën e të parëve.

Grupet etnike që zunë vend kështu në caqe kohe të ndryshme në trojet e Italisë, sollën me vete secili, në ngulimet e reja ku u vendosën, ato huazime turke që kishin depërtuar në dialektet e atdheut të tyre të vjetër gjer në kohën e shkulljes së tyre për në dhe të huaj. Do të mendojmë kështu që fjalët turke që na dalin në katundet e Molizës, të Kapitanatës, Apulisë, Kalabrisë e Sicilisë patën hyrë në Shqipëri vonë-vonë (jo më vonë se) në shekullin XV. Thom vonë-vonë, ngaqë këto huazime për një pjesë do të jenë më të lashta. Sepse kontaktet e para të shqiptarëve me osmanët nisën që me shekullin XIII e XIV, atëherë kur trupat turke që shërbenin herë në armët e Anzhuve, herë të bizantinëve e herë të feudalëve shqiptarë, u dukën në viset e Shqipërisë. Si një shtresë më e vonë, që shkon gjer në rrjedhë të shekullit XVII, do të shikohen elementet turke të ngulimeve arbëreshe të Basilikatës, të cilat gjer më sot mjerisht pak janë studiuar për nga ana e gjuhës. Më në fund, për fjalët turke që për-

doren në Villa Badessa, si cak më i vonë (terminus ad quem) i hyrjes së tyre do të merret viti 1744.

Në këtë mes do pasur parasysh fakti që këto ngulime pas vendosjes së tyre në trojet e Italisë i humbën një herë e përgjithmonë lidhjet me atdheun e vjetër prej nga u shkulën; shumë-shumë mund të ketë depërtuar në to ndonjë element i veçuar turk (ose përgjithësisht oriental, sidomos arab) me anë të mjedisit italian që i rrethon. Për këtë arsye elementet turke të këtyre ishujve gjuhësorë mund të përdoren me dobi për një kronologji në vështrimin që u tha më sipër, në kundërshtim me dialektet shqiptare që fliten në Greqi. Këto të fundit, si u tha, i përkasin një kohe më të përparme të shpërnguljes, veçse gjëllimi i tyre i vazhduar në Gadishullin Ballkanik, lidhjet e pandërprera me osmanët pjesërisht drejtpërdrejt e pjesërisht nëpërmjet të mjedisit grek ku jetojnë, ka bërë që depërtimi i elementeve gjuhësore turke aty asnjëherë nuk u ndërpre. Ashtu qëndron puna dhe me ligjërimin e Arbëneshit (Borgo Erizzos) afër qytetit të Zarës në Dalmaci. Ky ngulim, i themeluar rreth viteve 1726-33, përmban sigurisht më pak elemente turke se dialektet e sotme veriore që fliten në perëndim të liqenit të Shkodrës, treva prej së cilës kanë dalë. Megjithatë, mjedisi kroat do të ketë shërbyer si ndërmjetës për t'u dhënë ndonjë huazim turk, ndonëse ndikimi turk në këto dialekte sllave mjaft të mënjanuara nuk është aq i fortë nga ç'është në viset jugore. Kështu pra ky ishull gjuhësor vetëm gjer diku vjen në vështrim në punë të huazimeve turke. Nuk çojnë më peshë ishujt gjuhësorë në Istrië e në Sllavoni, ngase këto ka kohë që janë tretur në rrethin gjuhësor të huajin ku jetojnë.

Duke parashtruar tani materialin në formë të përmbledhur,¹⁾ në vijim të Fjalorit etimologjik të Gustav Meyerit, mbi dëshminë e të dhënave të M. Lambertzit, G. Rohlfisit, E. Giordanos (Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë — Dizionario degli Albanesi d'Italia, 1963) e të disa të tjerëve, si dhe pas gjurmimeve të mia vetjake (sidomos në lokalitetin Hora e t'Arbëreshvet, Piana degli Albanesi, afër Palermos në Sicili), po përmend pikësëpari huazimet turke që i përkasin shtresës më të vjetër. Aty hyjnë: *daule* prej turq., *davul*; *dufék*, *duf*, *cafék*, *chufék* «dyfekt» prej t. *tüfek*, *fitil*, me *pethku sfiti-*

1) Në lidhje me leximin e tingujve të këtyre dialekteve po vërejmë shkurt që x shënon spirantin e shurdhër velar; ç spirantin e shurdhër palatal γ spirantin velar të zëshmin:

liaret petku po tretet fije-fije» prej t. *fital*; *gajtán*, *galtán*, «kordela, shiriti i bukur që i varet nuses që prej kezës (kësulës) e në supe gjer poshtë te thembra» prej t. *gaytan*, trajta popullore e *kaytan*-it; *jar* «i shoqi» prej t. *yar*, sot në Shqipëri vetëm si shumës i singularizuar *jarán* «miku, i dashur i një vajze a i një gruaje» prej shumësit t. *yanan*; *masúr* «gjep ku mbledhin fijet» prej t. *masur*; *nerënxë* «portokall» *narënx* «mandarinë» prej t. *narenc* (kjo nga persishtja); *ortá* «cetë, togë» prej t. *orta* «mjedis, qendër, regjiment jeniçerësh»; *pexhér* «ballkon, dritare» prej t. *pencere*; *sakát*, në shprehjen *isht e jep sakat* «po jep shpirt» nëse do të thotë «po jep orën e fundit», prej t. saat «orë, sahat» (kjo vetë prej arab. *saçat*); *tel* «gjalmë për të lidhur një barrë» prej t. *tel*; *tok-a* «brezi i nuses së re kur martohet» prej t. *toka* «tokëz»; *tumác* lloj petarishte, jufka» prej t. *tutmağ* «jufka, espèce de vermicelle taillé en carré». Ndonjë apelativ i turqishtes ruhet nëpër këngët e vjetra popullore si emër vetjak, si p.sh. *beg*; *bey* te *Ali begu* e në emrin e *Skënderbeut*. Në këto këngë ndeshim dhe në emrat *turk* e *mushkumëndi* «muslimani», ky i dyti edhe nëpër këngët e Shqipërisë Jugore.

Është për të vënë re se disa nga elementet turke paraqiten me trajtë fonetike greke. Kjo do të thotë se shqiptarët i morën këto në kohën e parë turke nëpërmjet të greqishtes qoftë vetë në Shqipëri, qoftë në Greqi, prandaj ato mund të merren si huazime të vjetra turke ose dhe si huazime greke. Hyjnë aty në radhë të parë disa fjalë të cilat, me ndërrimin e afrikatës dhëmbore (dentale) *c* (*ts*) në *ç* (*tsh*), ndërrim që është karakteristik për huazimet turke të greqishtes së re, e dëftojnë veten që janë greke: *cohë*, *cojë* «petku gala nacional i gruas së martuar» prej t. *çoha* nëpërmes të gr. së re τσόχα, edhe në Shqipëri kudo *cohë*; *jani-carith* (me sufiks zvogëlues — *th*) «jeniçer» prej t. *yeniceri* nëpër gr. e re γενιτσάρης *carixë-t* shm. «këpuçë fshatarësh, nallane» *carifat* etj., prej gr. së re τσαρούχια, më e vjetër. Kjo prej t. *çanin* «sandale fshatarësh»; lloj opingash, chaussure en cuir que portent les villageois»; ky huazim turk-grek rron dhe nëpër dialektet e Shqipërisë Veriore, si *caruqe*, *saruqe* «opinga luksi» Në kundërshtim me këto fjalë që përmbajnë një *c* (*ts*), fjala *çayapatis*, *çalapatisënj* «flas keq, bigonis» prej gr. së re τσαλαπατιῶ ἑσταλαπάτησα «shkel me këmbë», prej t. *çala* «en frappant, duke i rënë» nga *çalmak* «godit, trokas, kjo i bie», nis me *ç* ashtu si në turqishten. Me anë të greqishtes kanë hyrë edhe fjalët *xandaqe*

shm. «henedqe të thella, gropa» prej $\chi\alpha\nu\tau\alpha\mu$ kjo nga arab. *khandaq*, t. *hendek*, trajtë popullore e fjalës *handak*; *kuturis* «guxoj; vendos» prej t. (*gotürü* «toktan, kuturu, shuk e grumbull» nëpërmjet të gr. së re $\kappa\omicron\upsilon\tau\omicron\upsilon\rho\omicron\upsilon$ në tym, au hasard» $\kappa\omicron\upsilon\tau\omicron\upsilon\rho\acute{\iota}\zeta\omega$ «veproj pa menduar»; *manushaq*, *manushaqe*, *manusaq* prej t. menekşe, mbase nëpër gr. e re $\mu\alpha\nu\omicron\upsilon\sigma\acute{\alpha}\mu$ pranë $\mu\epsilon\nu\epsilon\zeta\acute{\epsilon}\varsigma$, *sëndúq*, *snuq*, *sëndúq*, *snduqi* i *nuses* prej t. *sandük* (arab. *sandük*), për punë të grykores qiellzore palatale fundores mbase nëpërmjet të gr. së re $\sigma\epsilon\nu\tau\omicron\upsilon\mu$.

Duke kaluar te fjalët turke që përdoren në Villa Badessa, depërtimi i të cilave i përket, si u tha, një shtrese mjaft më të re, më saktë kohës para vitit 1744, do të përmenden këto huazime: *belá* prej t. *belá*; *berqavre shum* «falemnderit shumë» prej t. *bereket versin ki* ...; *birbil* prej t. *bülbül*; *deli-si* në *deli-ujë* «ujë shumë i mirë», *deli-fshat* «fshat i bukur» *deli-grua* «grua e bukur», prej t. *deli* «i marrë; trim i egër»; *destemél* «peshqir» prej t. *destimal* (kjo prej persishtes), që ka shkuar dhe në rumanishten, bullgarishten e greqishten e re; *futë* «përparse» prej t. *futa*, në Shqipërinë Jugore më fort *futá*, hakë «ahmarrje» *ke hak* «ke të drejtë» prej t. *hak*; *hashonem*» refuzoj» prej t. *haşa* «zoti më ruajtë»; *inát* prej t. *inad*; *kalá* prej t. *kale kala*; *perdë* «ombrellë, çadër» prej t. *perde*; *rraki* prej t. *raki*, *tepsí* «jo vetëm tepsia e metaltë, po edhe gjella nacionale me oriz të lyrshëm e me copa suxhuku, peshku e mishi, që gatuhet në një tepsí të tillë».

Huazimet turke të dialekteve arbëreshe të Italisë që u shënuan këtu fare shkurt, pas sa u shtjellua më lart bëjnë pjesë në më të lashtin element turk të gjuhës shqipe. Duke pasur parasysh që ngulimi shqiptar në Itali përfshin përgjithësisht një periudë kohe prej treqind vjetësh — afërsisht prej mesit të shekullit XV gjer aty nga mesi i shekullit XVIII —, këto huazime paraqesin një pjesë të shtresës leksikore që pat hyrë në Shqipëri gjatë kësaj periode. Po thom një pjesë, sepse është e qartë, dhe as nuk ka nevojë të theksohet, që kjo shtresë, për sa i përket Shqipërisë, duhet të ketë qenë shumë më e madhe. Do të kemi parasysh që kemi vetëm një katund prej Italisë, Villa Badessa, për të dëshmuar ndikimin e turqishtes në shqipen e shekullit XVIII, ndikim që pa dyshim kishte shkuar shumë më përpara. Pjesa më e madhe e ngulimeve arbëreshe në Itali, sikundër u shtjellua më lart, është e shekullit XV, kur ne jemi në fillim të ndikimit gju-

hësor të turqishtes. Kësaj vjen e i shtohet edhe kjo, që këta të krishterë, të cilët, pas një lufte të shënueshme për liri, për një pjesë të mirë morën rrugën e mërgimit edhe për të ruajtur besimin e tyre, nuk morën më pjesë në leksikon fetar islamik që depërtoi në atë kohë. Kështu nuk ka si të presim tek ata fjalë të tilla si *dervish*, *haxhi*, *hoxhë*, *kadi medrese*, *minare*, *myfti*, *Qabe*, *sheh*, *teqe*, *xhami*, *xhehnëm*, *xhenët*, që i ndeshim në literaturën e vjetër shqiptare, p.sh. te Pjetër Bogdani (1685); e megjithatë fjalët e kësaj sfere, në pajtim me gjithë rrethanat historike, do t'i shohim si një pjesë të më të vjetrit element turk të shqipes, bile përgjithësisht të gjuhëve ballkanike. Një tjetër rrethanë që për këto dialekte të bën të mendosh një pasuri më të madhe me elemente turke për një kohë më të parë, është kjo, që me romanizimin progresiv të këtyre ngulimeve, me mënyrën e re të jetesës që nisën me kohë në mjedisin e ri e krejt të ndryshëm nga i pari, e me ndryshimin kulturor që erdhi nevojisht në këto kushte, bashkë me disa elemente të leksikut shqiptar që sollën me vete, mund të jetë bjerrë dhe një pjesë e huazimeve turke. Përveç kësaj duhet kujtuar që nga këto dialekte gjer më sot vetëm një pjesë ka qenë studiuar nga ana gjuhësore. Në shumicën e ngulimeve që kanë mbetur ende të pastudiuara ka sigurisht edhe të tjera huazime turke, të cilat presin që të konstatohen me kohë.

Ky rezultat i arritur kështu me mjetet e dialektologjisë historike e të gjeografisë gjuhësore kryesisht për pjesën jugore të shqipes, mund të plotësohet, në pikëpamje dialektore edhe materiale, dhe nga një anë tjetër, e aty me dëshminë e veprave historike e të kronikave (Marin Barleci), si dhe me atë të dokumenteve, si edhe të përmendoreve letrare.

Është me interes për historinë politike e sociale të Shqipërisë që një fjalë si *haraç*, del që në një marrëveshje të Skënderbeut me Alfonsin e Aragonës, mbret i Napolit e i Sicilisë, që është e vitit 1451. Nëpër dokumente të tjera të asaj kohe e të një kohe më të vonë, pas konstatimeve të K. Hopfit, S. Ljubiçit, M. v. Šufflayt, F. Babingerit, O. L. Barkanit, H. Inalçikut, Z. Shkodrës e disa të tjerëve, gjinden ndër të tjera fjalë si *akçe*, *beg*, *çaush*, *cullha*, *dushman*, *duqan*, *hajn*, *han*, *haxhet*, *hyqm*, *jeniçer*, *kadi*, *kanun*, *kanunname*, *karvan*, *karvanseraj*, *kaza*, *ogllu*, *pazar*, *sakat*, *saxhak*, *tabor*, *tajfë*, *timar*, të cilat bashkë me disa të tjera janë të shekujve të parë të sundimit osman.

Edhe më të pasura janë burimet letrare,

Në shekullin XVI e XVII në Shqipëri Veriore lulëzon, kryesisht si efekt i kundërreformës, një literaturë kishtare, si përfaqësues kryesorë të së cilës mund të kundrohen Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frangu i Bardhë (Frano Bardhi) e Pjetër Bogdani, ku do të shtohen edhe Vendimet e Kuvendit të Arbënit (Koncilit provincial) të vitit 1706. Me anë të këtyre përmendoreve të shkrimit mund të ndjekim hap më hap për Shqipërinë Veriore shtimin e leksikut të huazuar prej turqishtes. Me një analizë të mëtejme, nëpërmjet të një krahasimi me materialin e arbërishtes së Italisë, mund të arrihet pastaj edhe në disa tregues e pikëmbështetje të karakterit kronologjik.

Gjon Buzuku, një gegë i Veriut me prejardhje të paditur, me «Mesharin» e tij të kryer në vitin 1555 dhe pak më vonë të botuar — nuk dihet se ku —, me gjendjen e sotme të njohurive tona mund të shikohet si autori i parë i literaturës shqiptare. Te ky autor gjinden disa huazime turke vërtet të paka, po karakteristike për kohën dhe për gjendjen e atëhershme: *harami* «cuba, hajdutë», *kallauz*, *cohë* «petk galla», *dollamë* për lat. *indumentum* «petk», *tekë* «me qëllim që, vetëm që, vetëm» prej serbokr, *tëk* «mezi, vetëm», e kjo prej t. *tek* «vetëm», *tepsi*, *turk*, *ndër Arapit* pranë *ndë Arabit* «në Arabi». E dyshimtë (a turke a magjare) është *shator* «çadër».

Jo shumë më të shpeshta janë huazimet turke të Pjetër Budit prej Mati, ipeshkv i Zadrimës, ndonëse caku kohor që e ndan nga Gj. Buzuku është mjaft i madh. Gjej këtu në tri veprat e tij të botuara më 1618 e 1621, përveç fjalës *cohë* që del dhe te paraardhësi i tij, edhe *me dërtunë* «vajtoj, ankohem» prej t. *derd* «dert», pastaj *hesáp*, *maskarí* prej t. *maskara*, *pajë* «hatër» prej t. *pay* «pjesë, dasik, porcion», *pajt* «eja këtu» prej *pa hajde*, kjo prej t. *hayde*, *pazár*, *rakí*, *sen-gjir* «zinxhir» prej *zincir zencir shend* «gëzim» prej *şen*, *taminqár*, «i matur» prej *tahmin*, *temél* e *themél* prej *temel*, forma me *th*-marrë nëpërmjet të greqishtes së re, *terezí* prej *terazi*.

Shumë më i pasur paraqitet elementi turk te bashkëkohësi më i ri dhe pasardhësi i Budit Frano Bardhi prej Zadrimë, autor i të parit fjalor të shqipes, fjalorit dygjuhësh «Dictionarium latino-epiroticum» të vitit 1635. Edhe më fort vlen kjo për veprën «Cuneus prophetarum» të Pjetër Bogdanit të botuar në vitin 1635, ku gjejmë një numër bukur të madh me huazime turke, të cilat patën hyrë në atë kohë në gjuhën

e popullit. Ndonjë element i ri na del në Vendimet e Kuvendit të Arbënit të vitit 1703, shtypur më 1706.

Një vështrim përmbledhës i këtyre që u shtjelluan këtu tregon që ndikimi turk mbi gjuhën shqipe u shtrua shumë më fort në jetën e qytetit se në të fshatit. Këtë e dëshmon vetë rrethana që terminologjia e bujqësisë dhe e blegtorisë e kësaj gurre është shumë e vogël në krahasim me pjesën që ka turqishtja në leksikun e rretheve qytetare. Kjo pamje pajton kështu me rezultatin që na jep studimi i historisë, dhe vërtetohet këtu edhe një herë që rrethanat gjuhësore nuk paraqesin gjë tjetër veçse pasojën e pasqyrimin e zhvillimit historik. Për sa i përket periodës së vjetër, e cila na intereson këtu në rend të parë, aty një shqyrtim i materialit arbëresh të Italisë me një krahasim me atë të përmendoreve letrare të Veriut na dëfton se ndikimi i turqishtes u ka ushtruar më fort në këto fusha: shtëpia dhe orenditë shtëpiake, kuzina; veshja; tregtia e trafiku, zejtaria, jeta e tregut, jeta botore (publike), sociale e politike, administrata, drejtësia; jeta fetare; sfera e luftës; emra bimësh e shtazësh ekzotike; emra vendesh e popujsh. Le të krahasojmë nga huazimet që u përmendën më lart si edhe nga ato që gjinden te Bardhi e Bogdani dhe te të tjerë autorë të vjetër fjalët që hyjnë në sferat e përmendura më sipër, si *çardak, hayat, konak, odë, odá, oxhak, saraj, temel; hambar, sënduk, tepsi, zinçhir; biber bilur, bojë bojá, raki, — caruqe, cohë, çarap, çarçaf, çizme, dollamë, futë, gajtan, masur, tok-a. — gjemi, hesap, okë, pazar, shinik, terezi, berber, kasap, terzi, zanat. — amanet; bullë, hadum, hajn, haramí, jar jaran, kallauz, sejmen, bajrak, bajraktar, haraç, pashë pashá, raje, sançhak, sulltan, vezir. — davi, davis, kadi, kanun, kanunname, mehçemé, myhyr, testir, veqil, vergji, xhelat, zabit. — dervish, hoçhë, kurban, myfti, synet. — bori buri, daulle, dyfek, fitil, gargji, jeniçer, mejdan, top. — manushaqe, nerënxë, selvi, zymbyl, asllan, deve, fil, majmun, — Arnautllar, Ederne, Misir, Selenik, Stamboll, Turk. Brenda këtij grupi do veçuar një shtresë me fjalët bori, caruqe, cohë, çarçaf, daulle, dollamë, dyfek, gajtan, haraç, haramí, hesap, jar, jeniçer, kadi, kallauz, manushaqe, masur, nerënxë, pashá, raja, sançhak, sënduk, sulltan, shinik, tepsi, tok-a e me ndonjë tjetër, të cilat mbi dëshminë e burimeve gojore e shkrimore dhe në pajtim me rrethanat historike do të mbahen si një pjesë e më të moçmit element të leksikut të shqipes të huazuar prej turqishtes.*

Në kohën e mëpastajme ndikimi i kësaj gjuhe u shtri

vazhdimisht edhe më tej. Përparimin e tij hap më hap e tregojnë shkrimet letrare të shtypura e në dorëshkrim, si dhe fjalorët e glosarët e shekullit XVIII, XIX e XX. Me largimin e osmanëve pas luftërave ballkanike ky ndikim mori fund, pasi u pat ushtruar pa ndërprerje gjatë një periode prej një gjysmëmijëvjetshi.

Do të ishte më në fund një punë tërheqëse të hetohej se cilat elemente leksikore kanë hyrë më parë prej turqishtes në gjuhët e tjera të Evropës Juglindore. Nga puna se mungon aty një shpërngulje në një vend jashtë Gadishullit të Ballkanit siç ka ngjarë me elementin shqiptar, në këtë lëmë gjurmimesh studiuesi do të mbështetet vetëm në burimet e shkrimit në vështrim më të gjerë; një përjashtim do të bënin vetëm dialektet e ngulimeve serbokroate të Italisë Jugore, të themeluara ashtu si ngulimet arbëreshe, në periodën e parë turke, dialekte të studiuara prej M. Reshetarit. Nuk është vendi këtu as të preket ndërkaq kjo çështje gjuhësore.

POEZIA POPULLORE E ARBËRESHVE T'ITALISË

Poezia popullore e arbëreshëve të Italisë zë atë vend, ka atë shkallë vjetërsie brenda poezisë popullore shqiptare, që ka të folët e atyre kolonive brenda gjuhës shqipe. Sikundër që këto dialekte ruajnë një shtresë të shqipes që është e fundit të mesjetës dhe e praktik të kohës së re, ashtu dhe kjo poezi në pjesët e saj të vjetrat i përket asaj kohe. Këta kolonistë, të shpërngulur nga trangu i dheut mëmë në atë kohë morën me vete gjuhën që flitej atëherë në Shqipëri dhe bashkë me këtë morën dhe këngët që këndoheshin asokohe në atdheun e vjetër. Këto këngë ata i kanë mbajtur për një pjesë gjer më sot. E shikuar kështu nga kjo anë, kjo poezi, bashkë me zakonet dhe me kostumet e moçme që kanë ata, është një pjesë e gjallë, një mbeturinë e vlefshme e jetës shqiptare, sic ka qenë aty nga mbarimi i kohës së mesme.

Dijes i bie barra të bëjë një shtresim brenda poezisë popullore italo-shqiptare për sa i takon vjetërsisë. Ajo duhet të dallojë se cilat këngë i kanë sjellë ata kolonistë në formën e parë prej Shqipërie (a prej Greqie), dhe cilat kanë dalë më pastaj në atdheun e tyre të ri. Sepse, sikundër që gjuha e këtyre ka pësuar ndikimin dërmonjës të rrethit italian brenda të cilit ata jetojnë prej shekujsh, ashtu edhe te poezia e tyre popullore ne shohim gjurmë të forta të poezisë popullore italiane. Një vecim i poezisë së vjetër nga e reja nuk është dhe aq vështirë të bëhet. Një nga kriteret e dallimit është ai që ka shënuar dhe Kamarda.¹⁾ Të lashta dhe të shpura prej atdheut të vjetër janë ato këngë që i gjejmë dhe tek arbëreshët e Kalabrisë dhe tek ata të Siqelisë, shumë herë të barabarta gjer në hollësi. Duke qenë se këto dy grupe ngulimesh nuk kanë pasur dhe aq të dhënë e të marrë në mes

1) Appendice al saggio di grammatologia comparata p. XIX.

të tyre gjatë jetës së tyre në Itali, s'ka sesi këto këngë t'i kenë marrë nga njëri-jettri atje; ata këto i kanë sjellë në themel prej atdheut të tyre ballkanik.

Për të kuptuar karakterin historik të kësaj poezie brenda poezisë popullore shqiptare, karakter që na paraqitet në këngët e lashta të arbëreshëve të Italisë, duhet pasur parasysh gjendja historike dhe sociale e Shqipërisë në kohën e shpërnguljes shqiptare në Itali. Jemi në shekullin XV. Në këtë kohë Shqipëria, ashtu si vendet e tjera të Ballkanit, rron brenda në trajtat e plota të jetës mesjetare bizantine. Po ky është edhe shekulli në të cilin një valë e re sundimtarësh të ardhur prej Orienti vjen e përplaset përmbi Gadishull dhe me këtë hap një faqe të re në historinë dhe në jetën shoqërore të kësaj treve. Trajatat bizantine të jetës, me sundimin e osmanëvet sa venë po tretën; ato zëvendësohen dalngadalë me trajta të reja, shumë më orientale të jetës. Kjo aq më shumë, meqë me këtë sundim të ri edhe një fe e re erdhi e u shtrua vise-vise në këto anë: duke kontribuar edhe kjo në shkallë të lartë në ndërrimin e strukturës sociale. Po ta vështrojmë shpërnguljen shqiptare në Itali nëpër prizmën e këtij procesi historik, ne do të shohim se ajo u krye kryesisht në shek. XV, në atë kohë kur osmanët shfaqen dhe sapo nisnin të zënë rrënjë në Shqipëri. Ata që u shpërnguljen sapo kishin nisur të njihnin sundimtarin e ri të vendit. Shpërngulja pra u bë në një periudë kalimi, kalim nga jeta e krishterë bizantine në jetën turke-orientale. Gjurmët e këtij kapërcyelli ne i shohim më së miri në gjuhën dhe në poezinë popullore të arbëreshëve të Italisë. Sikurse dialektet e këtyre krahas me një buri të madhe fjalësh greke-bizantine kanë dhe një numër të pakët huazimesh turke, ashtu dhe te poezia popullore e tyre na pasqyrohet qartas gjendja historike e shoqërore. Te kjo poezi, që këta morën me vete para vendosjes mirë të osmanëvet në Shqipëri, na del përpara më një anë jeta mesjetare bizantine e Shqipërisë shprehur me atë thjeshtësi që ne admirojmë në këto këngë, më anë tjetër fillimi i një kohe të re, disi të egërsuar, kohë që lidhet me sundimin turk. Këtë kohë të re, të egërsuar në jetë edhe në poezi, në përmbajtje, në ndjenjë dhe gjer diku edhe në formën e përjashtme të kësaj, ne do ta gjejmë më të fortë në Shqipërinë e kohës turke; te shqiptarët e Italisë gjejmë fillimin e saj. Kështu pra, në poezinë popullore italo-shqiptare neve na ruhet koha e mesjetës paraturke e vendit dhe krahas me këtë koha e parë turke.

Pjesën më të rëndësishme të kësaj poezie popullore e përbëjnë këngët popullore. Ç'këngë këndohen te këta shqiptarë në Itali? Ç'këndohet në këto këngë? Si në Shqipëri, ashtu dhe në Itali, kemi lloje të ndryshme këngësh, veçse ato të arbëreshëve kanë, siç u tha, përgjithësisht një karakter më të lashtë, më arkaik nga këngët popullore të Shqipërisë. Kemi te ata këngë epike, këngë lirike, këngë dasmash, këngë fetare, si dhe këngë djepi, vaje etj.

Këngët epike të vjetrat që përmendëm më lart, të cilat i shpunë kolonistët e parë atje, mund të quhen dhe këngë historike, me heronj si Pjetër Vojvoda, Nik Peta, Pal Golemi, Radovani etj., të cilët do të kenë qenë persona historikë. Në këto këngë përshkruhen me ngjyra të gjalla, sepse të jetuara vetë, luftat e para që bënë shqiptarët me turq në Shqipëri dhe në Greqi, që shqiptarët e kanë quajtur gjithë kohën Moré. Na këndohet shqiptari që lufton për vend dhe shqiptari renegat që lufton në vendin e të parëve, si jeniçer turk-muhamedan, për «zotin e madh», rrëmbimi i vashave shqiptare prej ushtarësh turq, shumë herë duke dalë e rrëmbyera dhe rrëmbyesi motër e vëlla.

Në këngët lirike na përshkruhet trimi me vashën: skenat e kroit në fshat, malli i fshehtë e i padëftuar, që lidhet me konditat shoqërore të Shqipërisë, siç do të kenë qenë edhe para kohës turke, përjetësia e dashurisë që shprehet në forma simbolike: mbi varr të trimit del qiparisi dhe mbi varr të vashës del «dhria e bardhë», ku çlodhen dhe mbëlcohen me rrush udhëtarët që kalojnë së andejmi. Të gjitha këto janë shprehur me një bukuri e thjeshtësi arkaike, të cilës rrallëherë i gjindet shoqe, dhe që te poezia popullore e Shqipërisë pasturke më nuk e shohim si këtu. Gjejmë nganjëherë dhe këngë humoristike, kështu kur këndohet martesë e plakut me një të re.

Të bukura dhe të moçme janë dhe këngët e dasmave. Këto ashtu si shpeshherë dhe këngët e dasmës në Shqipëri, janë këngë korale, në të cilat kori i burrave ndërrohet me korin e grave, duke marrë kënga kështu një karakter disi dramatik. Në këngët arbëreshe të dasmës dhëndri — si dhe në Shqipëri — krahasohet me një petrit a një qift (skifter), nusia me thëllëzë. Me këtë simbolizohet zakoni i vjetër — diku-diku i gjallë edhe sot — i rrëmbimit të gruas. Këto krahasime i gjejmë kudo në Ballkan. Janë të ardhura prej Orienti nëpërmjet të Bizantit.

Kjo është poezia popullore e vjetra e shqiptarëve të Ita-

lisë, ashtu siç na ruhet në këngët epike-historike, te këngët lirike dhe në këngët korale të dasmës. Vjetërsinë e kësaj poezie e dëshmon, siç u tha, rrethana që shumë nga këto këngë i gjejmë si në Kalabri si në Siqeli, shumë herë me vargje krejt të njëjta e me të njëjta fjalë. Një dëshmi tjetër e lash-tësisë së saj është forma e përjashtme, vargu. Këngët që këndohen në Itali, sikundër na mëson Maximilian Lambertzi, janë me vargje gjashtë-shtatë e tetërrokëshe, që ndërrohen me gjallëri të madhe me njëri-jetrin dhe që janë zakonisht vargje pa rimë. Në këtë kjo poezi ndahet kryekëput nga poezia popullore italiane. Siç dihet, poezia e popujve romanë, posaçërisht poezia italiane, bazohet kryesisht në numrin e rrokjeve dhe në rimë, duke mbetur akcenti në vartësi të plotë të atij numri. Po ta krahasojmë vargun arbëresh me vargun italian, do të shohim një ndryshim themelor, parimor në mes të këtyre. Vargu i poezisë shqiptare të Italisë nuk bazohet as në numër të rrokjeve, as në rimë. Ai pëshitet në një parim metrik fare të ndryshëm, në parimin e ritmit. Ritmi këtu konsiston në dy elemente kryesore: më një anë në akcent, me vendet e tij të caktuara mirë në varg dhe me rolin që lot brenda këtij, duke i dhënë këtij vargu atë lëvizje dhe gjallëri dramatike, për të cilat shquhen këto këngë; më anë tjetër konsiston, siç duket, në kuantitet, në ndërrimin (alternimin) e rrokjeve të gjata me të shkurtërat; sepse kuantiteti i rrokjeve që sot në Shqipëri, siç dihet, ka mbetur i gjallë në gegërishten, po që gjurma-gjurma e gjejmë dhe në labërishten e çamërishten në Jug, te shqiptarët e Italisë ruhet mirë dhe në të folët e përditshëm. Këndej kuptohet roli i kuantitetit në këngët e këtyre. Nga të gjitha këto elemente del se te kjo poezi kemi të bëjmë me një masë vargu jo numëronjëse, po ritmike-kuantitative. Në lidhje me ritmin nuk duhet harruar edhe një gjë tjetër dhe kjo përbën dëshminë e tretë të vjetërsisë së kësaj poezie — se këto këngë në të parë nuk kanë qenë shkruar. Ato kanë qenë përhera, dhe janë edhe sot, këngë që këndohen dhe kërcihen njëkohësisht me valle. Sadoqë këto elemente ritmike, si melodia dhe kadenca e valles, te këto këngë nuk janë studiuar sa duhet, kaq gjë dihet, që këto këndohen me melodi të rënda e të përmallshme bizantine; melodi që u afrohen atyre që kanë këngët kishtarë ortodokse që këndohen sot në Shqipëri.

Sikundër shohim, poezia shqiptare e Italisë si nga lënda, ashtu edhe nga trajta metrike e nga melodia e saj ruan gjurmë të vlefshme nga një fazë më e vjetër e poezisë së

popullit tonë. Nëpërmes të asaj ne vegojmë disi, sadoqë si nëpër t'errët, disa nga tiparet e poezisë shqiptare të mesjetës: poezi ballkanike e bizantine në përgjithësi, veçse brenda kësaj sfere prapë me një fizionomi të vetën, të ndryshme nga të fqinjëve; sepse poezi me një ton të brendshëm vetiak dhe me një masë vargu më vete.

Nuk ka dyshim se këngët e moçme, «kënkat e pleqërisë», që ravizuaam shkurt këtu, sot në një pjesë të madhe të katundeve arbëreshe më nuk dëgjohen. Krahas me ato, dhe në shumë vise në vend të atyre, kanë dalë me kohë këngë të tjera më të reja: shtresë e re që është shtruar përmbi të vjetrën, ashtu siç janë shtruar fjalët italiane përmbi fjalët shqipe, emrat italianë të familjeve përmbi emrat e moçëm të sjellë me vete prej Ballkanit. Këto këngë të reja janë krejt si këngët popullore të Italisë Jugore: kryesisht këngë të shkurtira lirike e humoristike me rimë, të pajisura shumë herë me ritornelle, imitime të *dispetti*-ve italiane etj. Këtu hyjnë dhe këngët fetare, të cilat këndohen nëpër këto koloni të kremeve, siç është p.sh. kënga e Lazrit. Është vështirë të besohet që këto këngë fetare të jenë ruajtur që nga koha e shpërnguljes. Shumica e tyre, në mos të gjitha, kanë dalë sigurisht në Itali; veçse mundet që të kenë dy-tre shekuj që kanë lindur. Këto këngë janë pjella e disa priftërve poetë, disa anonimë, zakonisht imitime të lira të këngëve fetare italiane krahinore, dhe me kohë janë bërë këngë popullore. Relativisht të reja janë gjithashtu dhe vajet si dhe llojet e tjera të këngëve.

Për sa u përket më në fund lidhjeve të posaçme të poezisë arbëreshe të Italisë me poezinë popullore të sotmen të Shqipërisë, këtu duhet pasur parasysh se fate historike të ndryshme të popullit tonë gjatë këtyre katër-pesë shekujve të fundit i kanë ndarë këto dy poezi nga njëra-jetra. Andej detit ndikimi i paprerë i rrethit italian, përkëtej detit sundimi i gjatë i turqve me islamizimin e vendit. Kuptohet se me këto zhvillime krejt të ndryshme dhe divergjente, fijet e vjetra që kanë ekzistuar në poezi në kohën e njësisë së popullit, me kohë janë këputur pothuajse fare. Megjithëkëtë disa gjurmë të paka nga kjo njësi i kanë kapërcyer shekujt, ato kanë mbetur si *membra dissecta* të gjalla gjer më sot. Kështu vallen e Garentinës dhe vallen e Konstandinit të vogël i gjejmë edhe në Shqipëri, në Veri dhe në Jug, veçse këtu shpeshherë me petk muhamedan. E para në Veri këndohet si Halil Garrija, në Jug si kënga e Dhoqinës, e dyta në Veri si Aga Ymeri, në Jug si Ymer Ago. Më interesante janë

lidhjet e veçanta krahinore, të cilat kanë të bëjnë me vendet vetë nga u shkulën së pari këta shqiptarë. Disa motive, disa vargje e fraza të poezisë së këtyre neve na dalin në Jugun tonë, në Gjirokastrë, në Himarë e gjetkë, disa pastaj i gjejmë dhe te shqiptarët e Greqisë. Kjo lidhet me burimin e për-bashkët të diasporës shqiptare në Greqi e në Itali, kryesisht nga Jugu i Shqipërisë. Të shkuarit bashkë të këtyre tri vatrave brenda truallit toskë ne e ndeshim jo vetëm në folklor, po, siç dihet, edhe në dialektet e atyre. Këtu mjafton t'i çëkim këto takime, pa mundur të hyjmë në hollësitë e tyre.

KONSTANDINI I VOGËLITH

DHE KTHIMI I ODISEUT

Një nga këngët më të përmallshme të shqiptarëve të Italisë dhe një nga pjesët më interesante të poezisë popullore ballkanike të krahasuar është kënga e Konstandinit. Konstandini i vogëlith duhet të niset, tri ditë dhëndër, në luftë. Pasi merr uratën e prindërve, ky porositi të shoqen ta presë nëntë vjet e nëntë ditë. Perënduan nëntë vjet e nëntë ditë, kjo është e lirë të martohet me tjetër. E shoqja e pret, por pasi shkojnë vitet dhe ditët, kjo vete në kishë të vëjë kurorë të re. Konstandini sheh një ëndërr të keqe dhe kthehet me vrap në vendin e tij. Ai rend në kishë dhe e gjen të shoqen tek po vë kurorë me burrë tjetër. Ai e rrëmben të shoqen nga mesi i krushqve; dhe këtu mbaron kënga e Konstandinit.

«Kjo baladë» thotë Lambertzi në veprën e tij «Pralla shqiptare» fq. 67 — «ka marrë karakter ritual ndër shqiptarët e Italisë Jugore. Këndohet në çdo martesë. Pas gostisë ngrihen prej tryezës gjithë dasmorët, burra e gra, formojnë një rreth, vënë në mes të rrethit dhëndrin me nuse, dhe duke ardhur rreth çiftit këndojnë këtë valle, siç thuhet në shqip vallja bashkë me këngën që e përcjell. Është një lavdërim poetik i besës së gruas së martuar».

Konstandini është heroi kryesor i poezisë popullore të italo-shqiptarëve. Ai është edhe sot i gjallë nëpër rrëfësat e tyre. Te Hora e t'Arbëreshvet (Piana dei Greci) në Siqeli dëftojnë edhe sot në kishën e vjetër të Shën-Gjergjit një vend të gropuar në një gur të shkallës, ku ka shkelur thundra e kalit të Konstandinit, kur ky hyri në kishë për të marrë sërisht të shoqen.

Dihet se kënga e Konstandinit të vogëlith ekziston me të njëjtin përmbajtje edhe në Shqipëri. I ndjeri prof. Giuseppe Schirò ka qenë i pari që konstatoi këtë paralelë. Në viset veriore shqiptare heroi quhet Aga Ymeri; në Lumë Imer

Aga; në Toskëri Ymer Ago; në Jug, me shqiptim të *y*-së dhe të *i*-së në *i*, Imer Ago. Në këtë emër dypjesësh emri i vërtetë është Ymer. Aga e Ago janë epiteti, i rrjedhur nga titulli social turk *aga*, titull që u jepej oficerëve duke filluar prej majorit, si dhe disa funksionarëve civilë.

Titulli aga është i lidhur ndër ne me një pasuri tokësore ose me një gjendje ekonomike përgjithësisht të mirë të atij që e mban këtë titull. Që emri Ago i Ymer Agos nuk është tjetër veçse titulli aga, kjo dëshmohet edhe nga një vers i varianteve toske, ku thuhet: «Psherëtimi Ymer Agaj»!

Afërsia që lidh Konstandinin e vogëlith me variantet e Shqipërisë është e madhe, sidomos midis varianteve italo-shqiptare dhe versioneve toske. Kjo shpjegohet nga origjina më shumë toske e italo-shqiptarëve. Kjo afërsi është aq e ngushtë, sa nuk kufizohet në disa vija paralele të përgjithshme, por shtrihet dhe në detaje. Kështu shohim gjer verse identike te kënga e Konstandinit dhe te kënga e Ymer Agos.

Ndryshime themelore pra nuk gjenden as në figurën e heroit, e as në përmbajtje të këngës. Ndryshimet janë ndryshime kronologjike dhe kulture. Në emrat Konstandin i vogëlith dhe Aga Ymeri ose Ymer Ago pasqyrohen dy epoka të ndryshme kulture dhe influenca e tyre mbi shqiptarët. Te emri Ymer me titullin Aga ne shohim influencën turke islame: gojëdhëna e vjetër vazhdon të jetojë, por emri i heroit islamizohet. Heroi vesh rrobën osmane dhe quhet Ymer Ago. Ky emër duhet të jetë pra më i ri se Konstandin i vogëlith.

Për sa i përket tashti Konstandinit të vogëlith të italo-shqiptarëve, *Lambertzi* fq. 48v. vëren që «personi i Konstandinit është një reminiscencë e *Mikròs Konstantinos*, Konstantinos o Mikròs, d.m.th. Konstandin i vogël, i këngëve popullore greke: këtë e morën pra italo-shqiptarët me vete, me kalimin e tyre prej Moresë për në Itali. Mikròs Konstantinos është i biri i Perandorit Andrenikos, i kënduar shpeshherë në këngët e Digenis Akritas. Meqenëse dhe i ati i Digenis Akritas, quhet Andrenikos dhe meqë poezia popullore greke i ngarkon Konstandinit po ato aventura si dhe heroit Digenis Akritas, qëndron afër mendsh që Konstandini i vogëlith i ynë të jetë një *akritikòn tragùdhi*, një këngë e ciklit të Digenis Akritas. Shqiptarët e Moresë, që e prunë në Itali, bënë me të vërtetë disa modernizime: p.sh. Konstandinin e bëjnë të luftojë në shërbim të Sulltanit» etj.

Në duam pra të përmbledhim shkurtazi ndryshimin midis Konstandinit dhe Ymer Agos, do të thomi që Konstandini i

italo-shqiptarëve është një emër i sferës kulturore greko-bizantine, Ymer Agoja i Shqipërisë një emër i sferës osmane. Që ka dhe paralele të tjera midis poezisë italo-shqiptare dhe greko-bizantine, shpresoj ta tregoj me një rast tjetër.

Zbuluam pra dy shtrete kronologjike të këngës: një më të vjetër grek-bizantin (Konstandini i vogëlith) dhe një më të ri turk-islamik (Aga Ymeri, Ymer Ago). Pyesim tani a mund të kënaqemi bashkë me Lambertzin, duke vënë barazimin Konstandin i vogëlith Digenis Akritas, d.m.th. duke shikuar burimin e këngës italo-shqiptare në poezinë popullore greke-bizantine të Kohës së Mesme. Pyesim mos është Konstandini i vogëlith vetëm një veshje e krishterë e një figure së vjetër të kohëve pagane, ashtu siç është Ymer Agoja rroba islame e heroit të krishterë. Pyesim pra në mund të gjejmë ndonjë formë më të vjetër të kësaj figure.

Për mua një lidhje e këngës së Konstandin—Ymer Agos me mitin e kthimit të Odiseut në Itakë më qe prej kohe i qartë. Tani së fundi shoh të *Petrota*, «Popolo, lingua e letteratura albanese» f. 134 se i ndjeri Prof. Schirò e paska bashkuar këngën e Ymer Agos me këngën greke moderne «Të njohurit», ku gruaja njeh të shoqin e kthyer nga lufta tamam nga dy shenja të trupit të tij. Këtë këngë greke Ampère e Tommaseo e patën konsideruar si një kujtim të mbetur të kthimit të Odiseut.

Homeri rrëfen në librin e 23-të të Odisesë se si Odiseu pas luftës së Trojës dhe pas peripetive të tij të shumta kthehet më së fundi në atdheun e tij, në Itakë. Midis kthimit të Odiseut dhe kthimit të Konstandin — Ymer Agos ka, besoj, mjaft pika kontakti:

1) Odiseu nisët si burrë i ri në luftë dhe lë në shtëpi grupin e tij të re e besnike Penelope — Konstandin Ymer Agoja nisët si dhëndër i ri për në luftë dhe lë të shoqen besnike në shtëpi.

2) Pasi Odiseu 20 vjet me radhë nuk kthehet, Penelopes i mblidhen rreth një tok kandidatësh duke insistuar që të martohet me njërin prej sish — Nusja e Konstandin — Ymer Agos e pret të shoqin nëntë vjet e nëntë ditë dhe së fundi e shpjen ta martojnë me një tjetër.

3) Odiseu kthehet nga lufta, në fillim i panjohur prej njerëzve të tij — Konstandin — Ymer Agoja kthehet nga lufta dhe nuk e njohin as prindërit e vet.

4) Odiseun e njeh së pari vajza e tij: kjo pas zakonisht grek i lan këmbët mikut të huaj dhe ahëre e njeh Odiseun

nga një shenjë që i kish lënë në kofshë një derr i egër në gjah. Gjithashtu Penelopeja i thotë të birit, Telemakut se: «Në qoftë se ky është me të vërtetë Odiseu, dhe kjo shtëpi e tij, ne të dy do ta njohim më mirë njëri-tjetrin. Kemi disa shenja, të fshehura për gjithë të tjerët, që ne vetëm i dimë». — Kështu e njeh e shoqja Konstandinin, dhe kur e njeh «e lotët m'iu rrukullisën sumbula, sumbula faqes kuqe, pikë, pikë gjirit bardhë». Edhe Ymer Agon e njeh e shoqja nga një «nishan» që kishte në trup.

Vërtet që ky motiv rinjohës nga shenja e trupit është një motiv i përhapur pothuaj në përrallat e gjithë popujve; e gjejmë gjer te poemi i vjetër ind Ramayana. Por kjo paralelë midis Odiseut e Konstandin — Ymer Agos është aq më e shënueshme, kur të marrim parasysh dhe pikat e tjera të kontaktit që përmendëm më sipër dhe më poshtë (1, 2, 3, 5, 6).

5) Odiseun e tallin rivalët e tij dhe s'duan t'ia lëshojnë Penelopen. Ky fillon një luftë të egër me ta dhe i mbyti gati të gjithë në gjak — Konstandini u kërkoi të shogon krushqvet në kishë. Kur këta ia refuzojnë, i drejtohet Shën-Mërisë, të mos e lërë «të bëjë maqili, të vrasij gjak e gjëri». Pra ç'vepron Odiseu, Konstandini dëshiron të evitojë. Duhet vrojtur se situacioni psikologjik është këtu i njëjtë te të dy heronjtë.

6) Më rëndësi se sa pikat e mësipërme ka ky fakt gjeografik: Lokalizimi i mitit të Odiseut në Itakë do të thotë se Odiseu është më tepër një hero i Greqisë Veriore, pra i një vendi që ka qenë në kontakt të përhershëm me fiset ilire-shqiptare. Paul Kretschmeri, në veprën e tij: «Hyrje në historinë e gjuhës greke» (Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache) f. 280 vv. është i mendimit se ata që shpurnë emrin e Odiseut në Itali qenë fiset ilire. Helbigu e kërkoi burimin e mitit të Odiseut te fiset barbare ose gjysmë barbare të Greqisë Perëndimore. Edhe Kretschmeri e pat peshuar një gjë të tillë. Ky dijetar thotë f. 281: «Odiseu kishte një orakël-te Eyrytanet që nuk ishin grekër; mbi lidhjet e tij të ngushta me tesprotët dhe mbi rolin e rëndësishëm që duket të ketë luajtur miti i tij në Epir të Brëndshëm, mbi këto ka tërhequr vërejtjen Wilamowitzi. Përralla e Flakëve është epirote, se Skëria, prej *skeròs* = continens. do të thotë «kontinent», pra është sinonim me *Epeiros*. Një qytet i Kaonisë quhej *Baiake*, emër i trajtuar ashtu si *Itake*, me *b* të huaj për greq. *ph.* (Phaiake. Pheake). Por mua bashkë me Eduard Meyerin më duket vështirë të pranoj që një nga figurat më të gjalla të mitologjisë greke të ketë buruar nga popuj bar-

barë, sidomos kur grekët vetë nuk dinë gjë për një origjinë të tillë, grekët të cilët p.sh. nuk e patën harruar kurrë origjinën trake të kultit të Dionizit».

Me këtë rast po përmendim se lufta rreth origjinës së errët të mitit të Odiseut është ndezur rishtas në vitet e fundit në një polemikë të ashpër midis Siegmund Feistit dhe të ndjerit gjermanist të Vjenës Rudolf Much, zhvilluar në të përkohshmen «Wörter und Sachen». I pari e deklaroi Odiseun shkurt një hero ilir, i dyti lëftoi për origjinën helene. — Ne, pa i dhënë fund çështjes, theksojmë vetëm këtë se, teoria e Feistit nuk na duket absurde, po të marrim parasysh zotësinë e madhe të frymës greke në të përkulur, të përvetësuar, të helenizuar, të kulteve të huaja. U përmend më sipër se kulti i Dionizit është i origjinës trake.

Për dy nga perënditë që ne sot i shohim si greke tipike, për Apollon dhe Pellas Atenën, dyshohet origjina helene. Ahere mundet që edhe Odiseu të ketë qenë i një origjine së huaj. Sidoqoftë, një lidhje e afërt e kësaj figure me fiset ilire të Epirit nuk mohohet. Një provë janë dhe paralelet që besojmë se zbuluam midis Odiseut dhe Konstandin — Ymer Agos.

Përmbi vleftën dhe përkufizimin e mitologjisë së krahasuar mendimet janë të ndryshme, për arsye se nuk ekzistojnë kufij etnikë në krahasim të miteve të përbashkëta (Kretschmer). Midis popujve më të largët ekzistojnë shpeshherë analogji spontane në përralla e legjenda. Shoh te vepra e cituar e Kretschmerit f. 85 v. se ka një gjasi të çuditshme midis mitit të Odiseut dhe të Orendelit në Gjermani; në të dy vendet një hero, i cili pas udhëtimit të gjatë me det kthehet në shtëpi, te e shoqja, që e kanë rrethuar rivalë të këqij; kthehet i panjohur dhe i veshur si lypës; vret rivalët dhe bashkohet rishtas me të shoqen.

Një paralelë më të çuditshme si me Odiseun ashtu dhe me Konstandin — Ymer Agon na e jep poezia popullore ruse: Në një *byline* (këngë e vjetër epike) djaloshi Dobrynia merr, tamam si Konstandini i vogëlith, uratën e së ëmës dhe nisat për aventura luftarake. Para se të nisat i thotë së shoqes Pamelfa Timofeevna që ta presë gjashtë vjet, pastaj pesë, e pastaj një vit; në vitin e tretë po të dojë le të martohet. E shoqja e pret dhjetë, pastaj martohet me Aleks Popoviçin. Me ta marrë vesh, Dobrynia kthehet me vrap në shtëpi. E më së pari nuk e njeh, por e njeh vetëm ahëre kur ky, si Odiseu dhe Ymer Agoja, i tregon nishanin që ka në këmbë të mëngjert. Dobrynia vete në dasmë të shoqes së vet dhe

e gjen këtë në mes të krushqvet, ashtu si Konstandin — Ymer Agoja gjen të shoqen. Dobrynia e merr sërish të shoqen nga dasma dhe i fton krushqit në një gosti, siç bën Konstandin — Ymer Agoja ynë.

Nuk është këtu vendi të thellohemi mbi këtë argument. Vetëm duam të theksojmë këtë, që poezia popullore shqiptare është aq e pasur në motive të vjetra, sa mund të hedhë dritë jo vetëm në mitologjinë e stërgjyshëvet tanë paganë, por dhe në mitologjinë e krahasuar të popujve të vjetër e të rinj të Ballkanit.

Këto radhë ishin shkruar prej kohe, kur më ranë në dorë dy artikuj, të cilët merren dhe me temën tonë.

Në artikullin e tij «Vom heutigen Stand der Illyriertforschung» (Gjendja e sotme e studimeve ilire) në Revue Internationale des études balkaniques, II-ème annés, Tome I-II (3-4) në f. 27, dijetari magjar Karl Kerényi shënon se prehistoriani i dëgjuar gjerman Carl Schuchardt shikon te Odiseu «ilirin e vërtetë»: sepse ky mbretëron mbi ishuj që janë të sferës ilire dhe dallohet «me urtësinë e me gjakun e ftohtë të tij» prej heronjve të tjerë të Iliadës: «Gjithshka (te Odiseu) është detari, gjithshka lot në Mesdheun Perëndimor, gjithshka është urtësi e jetës së përditshme, gjithshka është mënyrë jetese dhe legjendë ilire». Këtyre fjalëve të Schuchardtit Kerényi u shton dhe disa argumente filologjike në f. 28 të së përkohshmes në fjalë.

Gjithë te kjo revistë e në të njëjtin numër merret me Odiseun edhe Milan Budimir në artikullin «Vorgriechischer Ursprung der homerischen Haupthelden» (Rrjedhja paragreke e heronjve kryesorë të Homerit) f. 195-215. Nga trajtat e emrit të Laertiadit, Odiseus, dhe Odyxeus, Budimiri merr për më të vjetër trajtën Odyzeus me *ks*, si formë të Greqisë Veriperëndimore, prej nga rrjedh dhe heroji vetë. «Rrënjën — *dyx* — të Odyxeus mundim ta bashkojmë patjetër, në lidhje me karakterin krejt maritim të Laertiadit, me fjalën *epirote-daksa* det (te Hesyku), kështu që për Odiseun na jepet vetvetiu kuptimi i një apelativi «detar».

Përfundim: Dijetarë të disiplinave të ndryshme, prehistorianë, historianë e linguistë, duke iu përveshur zgjidhjes së problemit të Odiseut, secili me metodën e vet dhe ndryshe e pamvarësisht nga njëri-tjetri, kanë marrë seriozisht ndër sy origjinën ilire të heroit të Homerit. Na vjen mirë të shënojmë se poezia popullore shqiptare mund të kontribuojë edhe kjo në zgjidhjen e disa problemeve homerike.

KËNGA E LENORËS NË POEZINË SHQIPTARE

Kënga popullore që rrëfen se i vdekuri, për të vënë në vend fjalën e dhënë për së gjalli, ngrihet nga varri e vete merr të gjallën, quhet në literaturën popullore Kënga e Lenorës. Emrin kjo e ka marrë nga vjersha e famshme Lenorë e poetit gjerman Burgër (1747-1794). Mbi përhapjen e saj në këngët popullore të popujve të Ballkanit flet Karl Krumbacheri në Historinë e literaturës bizantine f. 831. Shiko edhe Talvjin, Këngë popullore të Serbvet I 295 (Jelica dhe të vëllezërit), Dozonin, Chansons populaires bulgaires 130, Leskienin dhe Brugmanin, Këngë popullore dhe përralla lituane 497, Psicharin, La ballade de Lenore en Grèce, Paris 1884., Fauriel — Müller, Këngë popullore greke II 65 dhe 96. Një studim të thellë e t'imitë mbi variantet e kësaj kënge në poezitë popullore të Ballkanit e ka kryer dijetari bullgar Shishmanov në revistën Indogermanische Forschungen 4, 412-48. Në këtë skicë të vogël të Normalistit¹⁾ do të merremi me këngën dhe variantet e ndryshme të saj në poezinë tonë popullore. Maximilian Lambertzi e ka trajtuar Këngën e Lenorës gjerë gjatë në veprën e tij themelore «Përralla shqiptare» f. 70-73. Mbasi ky dijetar, — si ç'thotë vetë, — nuk mundi e gjeti ndonjë variante të këngës në Shqipëri vetë, vrejtit e tij pra i bazon në variantet e kolonive shqiptare t'Italisë. Këto versione gjinden, te Jeronim de Rada, Rapsodie d'un poema albanese 29, e te Dhimitër Kamarda, Appendice alla grammatologia comparata sulla lingua albanese 98 vv, me dy variante. Do shtojmë tani dhe një variante të re prej Piana dei Grecit në Siqeli, të botuar prej Zef Skiroit në veprën e tij

1) Ky shkrim është botuar së pari te «Normalisti» Nr. 6/1934, Elbasan.

monumentale «Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia», 1923, f. 44-50.

Variantet italo-shqiptare që përmendëm rrëfejnë se një nënë pat nëndë djem, më i vogli u quante Kostandin, dhe një bijë me emër Garentinë, te Skiroi Doruntinë. Mbas dëshirës së Kostandinit Garentinën e martojnë larg e larg, e ai i zotohet s'ëmës se në çdo rast do ja sjellij Garentinën në shtëpi. Mirëpo në një luftë që bëhet i vdesin asaj nënë të nëndë bijtë, dhe ajo, e mbetur dhe pa bijë, shkon te varri i Kostandinit dhe i përflet këtë besën e dhënë. Natën çohet Kostandini nga gropa, vete merr të motrën dhe ja shpie s'ëmës. Ai futet prapë nën dhe. Nën' e bijë piquen, e vdesin të dyja në një përçafim të fundit nga malli dhe nga helmi.

Emri i motrës Garentina, është, sipas Lambertzit f. 71, një formë e ndryshuar e emrit të motrës në këngët greke të vëllait të vdekur, ku ajo quhet Areti (virtut), dhe Garentina është nominativi i shquar i trajtuar prej akusativit grek Aretin. Shton Lambertzi se në një version në prozë që ndodhet te Bleta Shqiptare e Thimi Mitkos f. 189, motra nuk ka emër, vëllai quhet Kostandin si ndër italo-shqiptarët.

Lambertzi vren dhe disa karakteristika të përbashkëta që kanë variantet italo-shqiptare me ato greke e bullgare; Numri i vëllezërve është nëndë (te Skiroi dymbëdhjetë). Thotë dhe G. Weigandi (Aromunët II 130) se numri nëndë lot në besimet e popujvet të Ballkanit një rol aq të madh sa dhe te gjermanët. Në variantet që njeh Lambertzi nuk është mur-taja që rrëmben vëllezërit sikurse në variantet greke thana-tikó-ja, po lufta. E ëma nuk e mallëkon të birin, as e lë djerrë varrin e tij, sikurse në variantet greke e bullgare, po përkundrazi, në ditën e të vdekurvet ajo në varrin e gjithë bijve ndez nga një qiri dhe derdh nga një vajtim, te varri i Kostandinit ndez një qiri dhe derdh dy vajtime. Në ndryshimin e gurit të varrit në një kalë dhe të hekuravet të varrit në një fre tekstet shqiptare bashkohen me shumicën e teksteve të tjera të Ballkanit.

Lambertzi përsërit në veprën e shënuar porosinë e Shishmanovit që duhet kërkuar përhapja e gojëdhënës në Shqipëri e sidomos në krahinat që piquen me viset sllave e greke. Me të vërtetë, balada jonë këndohet edhe sot në shumë anë të Shqipërisë. Në gazetën Ora e Maleve (1924) gjindet një variante nga Zagorjeja e Përmetit, në Hyllin e Dritës, në një numër që dorajdorës nuk mund ta përcaktoj, është një variante prej Veriut, si dhe në Lekën prill 1933 me emrin Alija

i Vogël. Pothuaj gjithë krahinat shqiptare e mbajnë të gjallë këtë këngë. Mbi një anketë që bëra ndër nxënësit e klasave t'epërme të Normales s'Elbasanit nxënësi Z. Dhimitri Grillo pati mirësinë e më dha një variante të këngës si këndohet në katundin e tij Vunó të Himarës:

«*Qe një mëmë,
Kish nëndë djem,
Mori nëndë nuse.
E vdiqnë të nëndë diemtë
E iknë të nëndë nuset
Qaj¹⁾ mëma djemtë:
«Ikë bushtrë e murtajë
Që më përmise nëndë djepe
E më humbe nëndë dyfeqe
E më kërreve nëndë nuse.
Mos u treç o Koço,
Martove Dhoqinëë
Lart e lart e në Misir,
Dëshëroj ta sho me sy.»
Pshoj Kost i vogëlë
Një shqelm i dha dërrasësë
E vate lart e në Misir
Tek luan Dhoqina valle.
«Miserdhe o im vëlla».
«Mirsetëgjeç o ime motrë».
«Në më erdhe për të mirë
Të nisem si arçë nuse.
Në më erdhe për të keqe
Të nisem si kallogrinjë».*

«*Nisu motrë si zu hera
E mos ajde të kërkosh të tjera».
Shkoj Kosta përpara,
Erdh' e erdhë përmes udhe:
«Shko motro përpara».
Këndon një zog xulluverdhë²⁾.
«Ecën i gjalli me të vdeknë».
Vate bija në shtëpi:*

1) *Qaj* = qante, thuhet dhe në Piana dei Greci në Siqeli.

2) *xulluverdhë* = xullufe — verdhë, xullufe: Një koco flokë në tëmblat, xhufkat e kallinjvet, Gustav Meyer Fjalor 442.

«Ape nëno derënë,
 Se jam Dhoqina e vetëmë». —
 «Ik o bushtrë e murtajë
 Që më shove nëndë dufeqe,
 Më përmise nëndë djepe
 E më kërreve nëndë nuse.»
 E tëk e me të hapurë
 E tëk e me të puthurë
 E tëk e me të plasurë.

Në këtë variante duhen bërë këto vrejte: Rrëfimi e përshkrimet janë mjaft lakonike, kënga duket të jetë e shkurtuar. Numri i djemvet është nëndë, dhe këta vdesin nga murtaja si në variantet greke dhe në një variante aromune prej Krushevo botuar te Weigandi Aromunët II 158-161. Djali quhet Koço, Kostë, emër i shkurtuar, hypokoristik i Kostandinit, emri i vajzës është Dhoqinë, e ky emër është femërorja e adjektivit grek dhókimos «i zoti, i aftë, i shquar», sikurse Garentina vjen prej greq. Aretí «virtut». Dhoqina martohet «lart e lart në Misir». Vrejme edhe këtë se, si në variantet bullgare e greke, nëna e mallëkon te varri të birin («mos u treq o Koço»), të mos tretet në dhe. — Dialogu i shkurtër midis motr' e vëllait është si në variantet italo-shqiptare e greke. Në dialogun midis nën' e bijë, në besimin e nënës që s'është e bija që trokëllet te dera, po vdekja, në përçafimin e përmallshëm nën'e bijë, variantja jonë e Himarës afrohet me ato të De Radës, Kamardës e Skiròit prej Italisë. Shpjegimi qëndron në afrimet që ka Himara me shqiptarët e Italisë në pikëpamje folklori dhe dialektore. Sëfundi është për të vretur te kjo variante e Himarës dhe afërsia me sferën e poezisë fqinje të grekëvet. Për këtë flasin murtaja e jo lufta si shkak i vdekjes së vëllezërvet, flasin emrat Kostandin e Dhoqinë, mallëkimi i Kostës së vdekur nga e ëma, dhe motivi i zogjvet që këndojnë rrugës.

Variantja e dytë që paraqesim më poshtë m'u këndua nga bariu Vad Marshi prej Berishe në Pukë:

*Nan vllazën in pa kan
 E kin pas ni motr pr mall,
 Vllau i mall ç'ja paska than
 Nan dit larg motrën m'e dhanë
 Ç'ka ka than Halili i nrmjemi:
 «Hajt mos motr e mos ki dert:*

Kur t'i mushish i muëj¹⁾ ditë e net
 Vjen Halili e m't'parn ty t'merr».

Kur jan mush i muëj dit e net
 Shikjon motra prej vilati²⁾ s'vet
 Besa besë kurrkush s'i erdh.

Po del motra po bërtet,
 Po del motra fort po kqyr.

Tek p'e shen³⁾ ni zog pr, qiell:
 «Amanet mori korbi i zi,
 Kur të shkojsh në vilatin tem,
 Thuëj Halilit hajde m'merr.
 Thuëj Halilit hadje me m'marr,
 Ku kie⁴⁾ besën si⁵⁾ ma kie dhan?»».

Ç'at-here zogu a fillue,
 Nan cop bjeshk i ka kalue,
 M'gur tuk vorri i paska çue:
 «Motra jote fjal t'ka çue,
 Motra jote ça ka than:
 «Ku e kie besën si ma kie pa dhan?»».

Iz tu Zoti te ka marr,
 Izen Zoti se i ka dhan
 Besn e Zotit mos me e lan,
 Besn e Zotit mos m'e harrue,
 Shpejt e shpejt e m'kam a çue.
 Shtrëngoij gjokun, asht fillue,
 Nan cop bjeshk i ka kalue,
 Bash tuk miku paska shkue:
 «Çou moj motr me u shtrëngue».

«Prit bre vlla i kafe me e'rdhnue».

«Jam pàgrrëshim e kafe s'due».

Kan marr rrugën e jan fillue.
 «Hajt Halil ni her me knue».

-
- 1) Diftongu geg. *ue* shqiptohet këtu si *uë*, në Kastrat midis *uo* e *ua*; në fund të versit, siç shihet, shqiptimi është *ue*.
- 2) *vilat-i*, Vadi m'a shpjegoi = gjindtë, d.m.th. njerëzit e vajzës. Fjalë turke.
- 3) *shen* = sheh.
- 4) *kie* = ke i shqiptohet pak.
- 5) *si*; përemër relativ = që, qi. Si dhe në disa muham, të Shkodrës si dhe në Malsi.

«Shuj¹⁾ moj motr zoti t'vraft,
 Se muë zani m'u ka çart».
 «Ç'ka kan zojt Halil si po fjasin²⁾
 Thon: «Qysh hec i vdekni me t'gjallin?»
 «Shuj moj motr Zog yn të vraft,
 Nuk kan zojt tjetër zanat».
 «Shka kan kullat Halil si jan vrugnue?»³⁾
 «Shuj moj motr Zoti të vraft,
 Se nân vllazën si jena kan
 Nân pal dazëm n'te kem bâ,
 Se nân nuse i kena marr,
 Treqint krushq miku⁴⁾ na i pruni,
 T'bardhen li me ta e pruni,
 E bardha li kânka kân,
 Kem⁵⁾ nân vllazën, na ka myt te tân.
 Besn e Zotit s'e kiesh lân,
 Besn e Zotit s'e kiesh harrue.
 Fillo motr n'shpi me shkue,
 N'baçe gjokun duë m'e çue».
 Kur dul motra (tha) n'shtek t'oborrit
 Na i duël nana në shkall të kullës:
 «Ti bij qyqe me kâ ke ardh?»
 Shuj moj nân, u qyqja mos kosha,
 «S'un kam ardh me Halilin tem.»
 «Aj Halil bij qyqja ka dëk,
 Sojd i mushi pjot tet vjet».
 Kan marr shkallën tu u gjit prpjet,
 Ngryka ngyka nân e bij kan dek.

Vrejtje: Emri i vëllait është Halil, ky emër është marrë sigurisht hua nga cikli i Mujit e i Halilit. Ai nuk është vëllai më i vogël, por i mesmi, «i nrmjemi».

- 1) hesht = shuk te Rossi, G. Meyer Fjalor 419. Vjen pas thirrjes *sht!*
- 2) *fl, pl; bl* bëhen *fj; pj; bj*; në Pukë Dibër, Mirditë, ndofta dhe gjetkë.
 Këtë ndrim e gjejmë dhe te shqiptarët e prov. Cosenza, Kalabri.
- 3) «pjuhnue» (Vad), d.m.th. pluhurosur.
- 4) *miku* d.m.th. ana e nuses. Fjala «mik» për anën e nuses shpjegohet nga natyra agnatike e familjes shqiptare. Shiko Jokl Li-ku. Unters. 16.
- 5) *Kem* = qemë. Grupet primarë *kl, gl*, sot të ruajtura në Çamëri, në Greqi dhe diku n'Itali, në Berishë e gjithë Kosovë *k, g, sh*, më poshtë *kosha* = qofsha, në Piana del Greci *klofsha*.

Numri i vëllezërvet është nëndë, nëndë palë dasmë bëhen dhe nëndë nuse merren. Numri nëndë përshkon gjithë këngën, nëndë ditë larg martohet motra, zogu lajmëtar kalon nëndë copë bjeshkë sa arrin te varri i Halilit, nëndë copë bjeshkë kalon dhe Halili kur vete e merr të motrës.

Vdekja e nëndë vëllezërvet shkaktohet jo nga lufta si në variantet italo-shqiptare, po nga e bardha li që e prunë të treqind krushqit e dasmës.

Një ndryshim i rëndësishëm i kësaj variante nga të tjerat shqiptare, është ky, që roli i nënës këtu humbet krejt. Jo kjo e zgjon Halilin nga gjumi i rëndë i vdekjes, por motra është ajo që i dërgon lajm të vëllait të vijë ta marrë. E lajmëtari është korbi i zi; ky merr rolin e mëmës e vete e çon Halilin nga varri.

Dialogu midis motr' e vëlla është i gjatë. Ajo i ofron këtij kafe pas zakonit, e rrugës e lut «ni her me knue», si ç'është zakon që këndojnë malsorët kur udhëtojnë këmbë a mbi kalë. Po ai refuzon e i përgjigjet se iu ka «çart zani». Këtu përsëritet motivi i zogjvet që këndojnë rrugës, ashtu si në variantet e Vunoit, të Mitkos dhe te grekët. Sëfundi motra e pyet Halilin pse muret janë «vrugne», janë mykur e pluhurosur, ashtu si e pyet motra Kostandinin në Rapsoditë e de Radës. Atëherë Halili i rrëfen gjithë të vërtetën e vdekjes të vëllezërvet.

Nuk kam në dorë ndonjë këngë serbe të Lenorës, prandaj nuk mund të them se a ka ndonjë lidhje kënga jonë e Pukës me këngët sllave. Në një kohë të afër rezervoj ta studjoj edhe një herë e më imtas Këngën e Lenorës, këtë pjesë interesante të poezisë sonë popullore.

Shënim: Emri Dhoqinë është trajta akusative e emrit Eudokja.

VATRA DHE BOTA NË POEZINË E DE RADËS*)

Duke kremtuar sot njëqindpesëdhjetëvjetorin e ditëlindjes së De Radës, kombi shqiptar përkujton me këtë jo vetëm një nga njerëzit më të lartë të elementit arbëresh të Italisë, po njëkohësisht një nga ata burrat e rrallë që kanë vënë nga një gur themeltar në ndërtesën e kulturës shqiptare.

Jeronim de Rada e ka pasuruar literaturën tonë me një botë të re, me një tufë motivesh e figurash origjinale, të cilat kanë ringjallur një nga epokat më të lavdishme të historisë së popullit shqiptar; po mbi të gjitha me një poemë si «*Milosaat*», një nga margaritarët e literaturës sonë. Ndërkaq, personaliteti i De Radës, për temperamentin e formimin e tij mendor e për disa kushte historike e sociale të veçanta, i kalon caqet e shkrimtarit. Ai përveç se poet i frymëzuar ka qenë dhe folklorist, gazetar, gjuhëtar, mësonjës, patriot në kuptimin më të lartë e më aktiv të fjalës. Shkurt, veprimtaria e tij ka diçka tërësore. Ajo përmbledhet në figurën e një apostulli të idesë nacionale, ide që gjatë shekullit XIX përshkoi si një rrymë e re popujt e robëruar të Evropës, e në mënyrë të veçantë popujt e Europës lindore e juglindore. Për të kuptuar këtë veprimtari në tërësinë komplekse të saj duhet shikuar prandaj personaliteti i poetit në hapësirë e në kohë: në mjedisin ku jetoi e u zhvillua dhe në shekullin që e leu e që e mori.

Arbëreshët e Italisë, të shkukur prej krahinash së ndryshme të Shqipërisë e të Moresë në një nga periodat më dramatike të historisë shqiptare, kryesisht për të shpëtuar nga zgjedha e osmanëve, me atë ngulm në ruajtjen e dokeve të së parëve që karakterizon popullin tonë, kanë mbajtur të gjalla gjatë shekujve mbiemrat e familjeve, besimin, kostumet, vallet e këngët e lashta, gjithë tiparet etnografike që patën sjellë shtektarët e parë në dhe të huaj; po mbi të gjitha gju-

*) Botuar së pari në vëllimin «Jeronim de Rada», 1965, f. 50-55.

hën, e cila është tek ata një toskërishte e një tipi më të vjetër. Ata edhe sot, me gjithë se gjatë kohës të asimiluar nga shumë pikëpamje, paraqesin një pjesë bote ballkanike mu në mes të jetës latine. Është e natyrshme që kjo botë ku lindën e u rritën poetët e këtyre kolonive, u mbrujt shpirtin atyre dhe që për ta gurra kryesore e frymëzimit. Kjo është vatra shqiptare, është jeta patriarkale e katundeve arbëreshe; jeta e përditshme nëpër fusha e ara, nëpër bregore e vreshta, me skenat idilike ndanë kroit. Katundin e vet këta shkrimtarë shpirtërisht e muarën me vete, edhe kur vanë e jetuan, më shkurt o më gjatë, nëpër qytetet e mëdha të Italisë.

Krahas me vendin e me traditat popullore, një faktor me rëndësi në formimin e këtyre shkrimtarëve që koha në të cilën jetuan. Nuk është një gjë e rastit që tek arbëreshët në shekujt e parë të ngulimit të tyre në atdheun e ri lindën vetëm autorë shkrimesh me përmbajtje fetare, në prozë e në poezi qoftë, si Matranga, Brankati, Kolë Filja, Variboba; dhe se Jeronim de Rada, Anton Santori, Zef Serembe, Gavril Dara, Zef Skiroi, shkrimtarë laikë e njerëz përparimtarë, rrojtën e punuan kryesisht në shekullin XIX. Ata janë pjella e këtij shekulli. Është koha kur në fushën mendore kishin depërtuar në Europë kudo parimet e iluminizmit, e në fushën politike e sociale idetë e revolucionit freng, me kërkesën e lirisë, të barazisë e të së drejtave të njeriut. Në fushë të poezisë, mbledhja e këngëve të popujve t'Europës në veprën e Herderit «*Këngët Popullore*» (1778-79) çeli rrugën e zbulimit të një poezie të re, të poezisë popullore, dhe romantizmi e bëri të vetën këtë ide. Ai zgjoi, sidomos te popujt e vegjël të kontinentit, dashurinë për gurrat e freskëta të kësaj poezie dhe me të bashkë edhe dëshirën për të mbledhur visaret e saj kudo të ishin. Kjo frymë letrare ndërkaq, te popujt sidomos të Europës juglindore, më fort se tipin e poetit romantik të mënjanuar prej botës, krijoi tipin e këngëtarit luftar, të shkrimtarit bartës e përhapës të idesë nacionale. Kështu pra në këtë trevë idealet e poezisë e të lirisë politike u shkrinë në një njësi më të ngushtë se në viset e tjera t'Europës.

De Rada bëri të vetat edhe motivet e jetës së katundit arbëresh dhe idetë e botës së jashtme e të kohës së tij. Këto elemente, jeta shqiptare dhe frymëzimet e jashtme, vatra dhe bota, u bashkuan tek ai në një njësi organike e të pandarë.

Ai e nisi karrierën e tij si folklorist. Shkoi e mblodhi nëpër katundet arbëreshe të krahinës së Kozencës këngët e

vjetra popullore, të cilat në atë kohë ruheshin në gojë të popullit, si në Kalabri, si në Siqeli e në krahina të tjera t'Italisë jugore. Shqiptarët që u shkulën për në Itali gjatë luftës epike të popullit me osmanët, nën flamurin e Skënderbeut e në kohën e parë të pushtimit të huaj, morën me vete një visar të pasur këngësh të asaj kohe, këngë heroike e lirike. Në këto poezi që botoi De Rada te «Rapsoditë» e që pjesërisht janë ruajtur të gjalla gjer më sot, ndihet një jehonë e asaj periode të mesjetës shqiptare, e cila ka hyrë në histori me emrin «*Manifestacioni shqiptar*». Në këtë më të vjetrën poezi popullore shqiptare që mund të datohet, na paraqiten format e jetës së Arbërit në epokën bizantine, e format më të reja, e disa të egërsuara, të kohës së parë turke të vendit; prandaj këto këngë janë njëkohësisht dhe një dokument i historisë shqiptare. Titulli që u dha poeti këtyre këngëve në mbledhjen që botoi, «*Rapsoditë e një poeme shqiptare*», tregon se ai mendonte që këto përbënin mbeturinat e një eposi popullor të gjallë në Shqipëri në kohë të Skënderbeut. Ky mendim nuk qe i drejtë, sikundër e vërtetoi që në atë kohë folkloristi arbëresh Dhimitër de Grazia. Po ajo që ka rëndësi, është kjo, që De Rada e jetoi këtë poezi dhe gjeti në të ushqimin e tij. Ajo formoi bazën e natyrshme të veprës së poetit. Kjo vepër në përmbajtje të saj, në stil, në gjuhë, në trajtën e brendshme, në krahasimet, në frymëzimin e saj, në përshkrimin e atmosferës ku lëvizin heronjtë, na paraqitet shumë e gjashme, shpeshherë e njëjlojtë me rapsoditë popullore, ajo duket sikur të ishte një vazhdim i këtyre rapsodive. Kjo vihet re dhe në trajtën e jashtme, në metrikë: si atje, dhe këtu gjejmë të njëjtat vargje pa rimë, masa e të cilave nuk është numerike si në poezinë italiane, po në mënyrë thjesht shqiptare, ritmike, determinuar nga mëshimi i akcentit e nga alternimi i gjatësive me shkurtësitë. Si në poezinë popullore, edhe në atë të De Radës është i shpeshtë kalimi i pandërmjemë nga tregimi në dialog, si të thuash nga poezia epike në dramatikën. Po edhe emrat e heronjve janë marrë nganjëherë prej këngës popullore, si Milo Shini e Radavani, i cili është një nga heronjtë kryesorë në punimin e dytë të poemës së «*Serafina Topisë*» që mban titullin italisht «*Uno specchio di umano transito*». Ka dhe mjaft motive, mjaft skena e episode në veprat e tij që i gjejmë më parë në rapsoditë popullore, e të cilat nuk është vendi të përmenden këtu. Ndërkaq me këto ndikime nuk do menduar se

poeti nuk bëri gjë tjetër veçse imitoi ku mundi poezinë popullore. Ai mori prej saj frymëzimin e përgjithshëm dhe shumë elemente që meritojnë të hetohen në të ardhmen, po jo pa i ngritur këto në një sferë poetike më të lartë. Poezia popullore që për të një pikënisje, nga e cila mori hovin për të krijuar një botë poetike më vete. Kjo botë është pasqyrim i kohës paraturke dhe i kohës së parë turke të Shqipërisë, gjallëruar e mbushur me figura historike e me figura të sajuara prej tij: figura nga dyert e zotërinjve feudalë (Zakaria, Duka-gjini, Topia, Arianiti e të tjerë) e të shtresave popullore të Shqipërisë mesjetare, duke marrë që prej Kotori e gjer në Artë të Prevezës. Në këto poema, paraqitja e figurave të heroinave na del shpeshherë e përsosur. De Rada është i pari poet i psikës femërore në literaturën shqiptare.

Për të rrokur veprën e këtij poeti në një mënyrë më të rësore, nuk do lënë pas dore ndërkaq dhe kjo rrethanë, që ai — sikundër na e thotë dhe vetë — gjeti burime frymëzimi edhe në literaturat klasike e në modernet. Ai, si e vuri re sëpari V. Gualtieri, u ndikua nga poezia romantike e kohës, si shumica e poetëve t'atëhershëm të Europës, e si më vonë dhe G. Dara në Siqeli. Ndërkaq te De Rada shihet një horizont letrar edhe më i gjerë. Kështu mendoj se në disa figura e motive të poemave të tij vihen re gjurmët e poemave italiane të Renaissancës, sidomos të Ariostit e të Tassos. I shumë literaturave europiane është dhe motivi i dashurisë fatkeqe të një çifti që rrjedh prej dy familjesh armike, motiv që te poeti ynë na del në figurat e Bozdar Strezit e të Serafina Topisë në Artën e kohës së Skënderbeut. Heronjtë turq Almanzore e Algazile, që dalin te «Skanderbekku i pafaan» e te ripunimi i «Serafina Topisë», me emrat e tyre na shpien në botën arabe të Spanjës mesjetare si na del te Romancero e Cidit. Emri i Aidésë që del si e motra e Skënderbeut, na kujton poemat e Byronit. Nuk mungojnë dhe reminishencat e botës klasike, si pullumbi i Anakreontit e motivi i Psikës, frymëzuar nga «Gomari i artë» i poetit Apuleius. Ideja e fatit (moira), si na çfaqet në dramën greke, sidomos te Sofokliu, depërton edhe kjo në veprat e poetit. Edhe Bibla ka lënë mbresa të thella tek ai.

Këtu ndërkaq do vënë në dukje dhe një tjetër ndikim i pavënëre gjer më sot. Për të mbushur skenat luftarake me figura burrash e grash të Orientit, që duhej të dilnin aty në lagjen e osmanëve, poeti pati idenë të merrte disa motive dhe emra nga poezia klasike e Indisë. Kështu motivi i këqyrjes së

një pikturë që paraqet Anmaria Kominiaten, nga ana e së motrës Delia dhe të bijës Adine të «Nata e Kërshëndellave», na kujton një skenë analoge të dramës «Sakuntala» të Kalidasës, ku mbreti Dushanta vren një pikturë që paraqet Sakuntalën me dy shoqet e saj. Paraqitja e ngjarjeve nëpërmes tabllosh të pikturuara na del dhe në të tjera vepra të De Radës. Emri i Vantisanës të libri i pestë i poemës «Skanderbekku i pafaan» shihet se është marrë nga Savantasena, heroina e dramës «Mrhakatika» të Dandinit, poet indas i shekullit VII të erës së re. Një tjetër emër indas është Davadasa, emri i një heroine që na del në këngën e gjashtë e të tetë të Serafina Topisë. Te drama e Dandinit, Vasantasena hypën në stivë të druve për t'u djegur së toku me fëmijët e saj, po shpëton bashkë me të shoqin. Një skenë të tillë na paraqet De Rada, te punimi i dytë i «Serafina Topisë», ku Evoda pëson këtë vdekje të tmerrshme për ahmarrje politike të popullit. Kjo skenë mund të jetë frymëzuar së andejmi. Po ajo m'anë tjetër na kujton një pamje të «Jeruzalemit të liruar» të Tassos, në të cilën virgjëresha kristiane Sofronia duhet të digjet në turrë të druve së bashku me të dashurin e saj Olindo, po ndërmjetëson Klorinda për shpëtimin e tyre. Gjurmët e poezisë inde të De Rada kanë lidhje me faktin që në gjysmën e parë të shekullit XIX, literatura inde kishte marrë një hov të madh në Europë, duke depërtuar kudo nëpërmes përktimesh në gjuhë të ndryshme.

Burimet e poezisë popullore shqiptare e të literaturës botërore e pasuruan krijimin poetik të De Radës, po kjo në qenësi mbetet pjella e frymëzimit të tij.

Nga veprat e poetit, për ne nuk ka dyshim se kryet e vendit e zë «Milosaat». Kjo poemë idilike e me frymëzim romantik, e përshkruar fund e krye me poezinë naive-arkaike të rapsodive shqiptare t'Italisë, për karakterin e ngjeshur që ka, mbetet një nga ato fort të paka vepra të literaturës shqiptare që e bëjnë këtë të përfaqësohet në literaturën botërore. Nuk mungojnë ndërkaq episode madhështore përderdhur nëpër veprat e mëpastajme të poetit, si të «Serafina Topia», të ripunimi i saj me titull të ndryshuar, të «Skanderbekku i pafaan» e në të tjera. Gjithkund në këto poema ndritin vise-vise shkëndijat e një poeti me frymëzim gjenial, arti i të cilit konsiston, në mënyrë të Rembrandtit, në një qartë-errët (clair-obscur), në ndricimin e disa pamjeve e figurave e në lënien e të tjerave në errësirë. Është një detyrë për ne t'i njohim këto vepra e me botime të ndryshme të përhapim njohjen e tyre brenda e jashtë atdheut.

PËRMBAJTJA

Parathënie	3
— Çështja e prejardhjes së ngulimeve arbëreshe të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave vetiake	9
— Shqiptarët në Itali të mesme dhe në Napoli	23
— Disa burra të shquar të arbëreshëve të Italisë	28
— Nga leksiku i dialekteve arbëreshe të Kalabrisë	35
— Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre	46
— Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë	59
— Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes	83
— Poezia popullore e arbëreshëve të Italisë	92
— Konstandini i Vogëlith dhe kthimi i Odiseut	98
— Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare	104
— Vatra dhe bota në poezinë e De Radës	111

APPENDIX

1

2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12

The following is a list of the names of the persons who have been appointed to the various offices of the State of New York, and who have taken the oaths of office and qualification, in accordance with the provisions of the Constitution and the laws of the State, from the year 1784 to the year 1884.

Çabej, E.

Në botën e arbëreshëve të Italisë. (Përmbledhje studimesh) [Red.: N. Çabej]. T., «8 Nëntori», 1987.

..... f

(B.m.): dhe

(B.v.): 949.65 (=919.83:45)(081)

+ 009 (=919.83:45)(081)

Ç 12

Tirazhi 2000 kopje

Format 60x88/16

Stash: 2204-82

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1987.